



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 694 Akti

Nr. 738 Vendimi
Tiranë, më 22.2.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 20.2.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gëzim Çopa**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e

Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 5 të nenit 3, si dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 22.12.2020, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK; Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

➤ *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë nr. *** prot., datë 27.9.2018.

- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;
- ka mosdeklarime ndër vite;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishtëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 26.1.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 26.1.2024, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 29.1.2024, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 12.2.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.2.2024).

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *email*, në datën 12.2.2024.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 20.2.2024, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

17.1 Në seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë dhe i shoqëruar nga avokatja e tij, znj. R.Z, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, pajisur me nr. licence ***.

² Raporti i AKSIK (ish-DSIK) nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. *** , datë 7.7.2023.

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 18.12.2018 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.1.2019).

18. Subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Z. Gëzim Çopa ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

19.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.4 Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësisë profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

20.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për

⁴“41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja (ish-DSIK); (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato të dhëna gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

22.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në këtë institucion, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa.

22.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca ***), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

23. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit pemishte plus 300 m² truall, me sipërfaqe totale gjithsej 5,687 m², ndodhur në fshatin Sh, Durrës. Deklaron se më parë ka qenë edhe një shtëpi banimi me sipërfaqe 90 m², prishur plotësisht për efekt amortizimi⁵. Ka deklaruar se këtë pasuri e ka përfituruar me ligjin nr. 7501, “Për tokën”, si dhe nga trashëgimia ligjore.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

23.1 Në deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.6.2005), subjekti i rivlerësimit⁶, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 25% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 12,000 m², përfituruar në vitin 1992 në bazë të ligjit nr. 7501.

23.1.1 I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁷ në lidhje me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka saktësuar se bazuar në AMTP, sipërfaqja totale e tokës bujqësore e përfituruar nga familja e tij ka qenë 12,900 m².

23.2 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (me detyrën ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI), me datë dorëzimi 19.1.2009, në seksion “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se zotëron 50% pjesë takuese të pasurisë së llojit pemishte plus truall, gjithsej me sipërfaqe 5,687

⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 11.3.2008; (ii) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 17.1.2008, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit, z. Sh.Ç; (iii) dëshmi trashëgimie ligjore nr. ***, datë 13.5.2015, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësës, znj. F. Ç.

⁶ Në atë periudhë me funksion oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁷ Referojuni procesverbaleve “Mbi shpjegimet e subjektit për deklarimin e pasurive”, të datave 5.2.2015 dhe 11.2.2015, dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.7.2023).

m², nga e cila 300 m² truall dhe 90 m² banesë, e ndërtuar në vitin 1950, aktualisht e prishur për efekt amortizimi. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: “Trashëguar nga prindërit”.

23.2.1 I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁸ në lidhje me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...Kjo pemishte + truall me sip. 5,687 m² dhe sipërfaqe trualli 300 m², në të cilën është vendosur një ndërtesë 90 m², është përfitur nga ligji nr. 7501. Në aktin e marrjes së tokës në pronësi në emër të babit janë përkatësisht sipërfaqja me emërtesë shtëpi e vjetër me sip. 1,200 m² dhe pemëtorja tek *** me sip. 2,500 m². Parcelat e shënuara në AMTP, pasi është bërë rievimi nga ZRPP Durrës, kanë rezultuar me sipërfaqe reale sipas certifikatës së pronësisë, prej 5,637 m²”.

23.3 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (si prokuror), me datë dorëzimi 27.11.2015, në seksionin “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% të pasurisë së llojit pemishte plus truall 300 m², gjithsej me sipërfaqe 5,687 m², ndodhur në Sh. Durrës. Gjithashtu ka sqaruar se më parë ka qenë edhe një shtëpi banimi me sipërfaqe 90 m², e prishur për efekt amortizimi. Ka deklaruar se kjo pasuri është trashëguar nga prindërit, duke referuar dëshminë e trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015.

23.4 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Durrës, megjithëse në hipotekë vazhdon të jetë e regjistruar edhe ndërtesa me sip. 90 m², e deklaruar nga subjekti e prishur për shkak amortizimi.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

24. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri⁹, Komisioni konstaton se:

24.1 Në datën 20.1.1997, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, të ndjerit Sh.Ç, figuron të jetë lëshuar dokumenti Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), me nr. regjistri ***, në referim të të cilit në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, familjes së shtetasit Sh.T.Ç i jepet në pronësi tokë gjithsej 12,900 m², nga të cilat 4,300 m² arë, 3,500 m² pemëtores, 1,100 m² vreshtë dhe 500 m² truall. Bazuar në këtë AMTP, ndër të tjera, evidentohet: (i) pasuria nr. ***, me vendndodhje ngastre “shtëpia e vjetër”, me sipërfaqe totale të tokës 1,200 m², nga të cilat 1,000 m² pemëtores dhe 200 m² truall; (ii) pasuria nr. ***, me vendndodhje ngastre “pemëtores tek ***”, me sipërfaqe 2,500 m² pemëtores.

24.2 Bazuar në AMTP-në nr. ***, në datën 26.1.1999 është regjistruar në emër të babait të subjektit, z. Sh.Ç, pasuria nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, me sipërfaqe totale 5,687 m², nga të cilat 300 m² truall dhe 90 m² ndërtesë¹⁰.

24.2.1 Në vijim të verifikimit të të dhënave të pasqyruara në kartelën e kësaj pasurie të paluajtshme, duket se në seksionin “Përshkrim i veçantë” është shënuar se ajo ndodhet në

⁸ Referojuni procesverbalit të datës 11.2.2015 “Mbi shpjegimet e subjektit për deklarin e pasurive”, dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.7.2023).

⁹ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) shkresa e ZQRPP-së nr. *** prot., datë 1.11.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (ndodhur në aneksin nr. ***); (iii) dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 26.7.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.7.2023); (iv) shkresa e ASHK Drejtoria Vendore Durrës nr. *** prot., datë 4.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023); (v) dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

¹⁰ Referojuni dokumentit “Kartelë e pasurisë së paluajtshme”.

pasuritë nr. ***, *** dhe ***. Rezulton se pasuritë nr. *** dhe *** referohen në AMPT-në nr. ***, datë 20.1.1997, ndërsa pasuria nr. *** nuk referohet në këtë akt.

24.3 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 14.3.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur¹¹ lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të trashëgimlënësit Sh.Ç , në favor të trashëgimtarëve të radhës së parë F.Ç e Gëzim Çopa, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta nga ½ pjesë secili në pasurinë e trashëgimlënësit.

24.4 Në datën 23.9.2003, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. F. Ç , ka nënshkruar një deklaratë noteriale¹², me anë të së cilës ka deklaruar së është dakord që si kryetar i familjes bujqësore të caktohet i biri i saj Gëzim Çopa.

24.5 Në datën 24.10.2003, nëna dhe bashkëshortja e subjektit kanë nënshkruar një deklaratë noteriale, me anë të së cilës deklarojnë se janë dakord që si kryetar i familjes bujqësore të caktohet Gëzim Çopa.

24.6 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 17.1.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur¹³ lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Sh.Ç , duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të tij bashkëshorten F.Ç dhe të birin Gëzim Çopa.

24.7 Në datën 11.3.2008, ZVRPP Durrës ka lëshuar dokumentin certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, për pasurinë e llojit pemëtoje + truall me sipërfaqe 5,687 m², nga të cilat 300 m² truall dhe 90 m² ndërtesë (nr. pasurie ***), regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij F.Ç .

24.8 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 13.5.2015, noteri publik, znj. G.B, ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore¹⁴ për shtetasen F.Ç , duke përcaktuar trashëgimtar të vetëm të saj të radhës së parë djalin Gëzim Çopa.

24.9 Duket se gjatë vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për regjistrimin e kësaj pasurie vetëm në emrin e tij¹⁵ dhe nxjerrjen e certifikatës përkatëse, por nga ana e ZVRPP-së Durrës i është kërkuar plotësimi i dokumentacionit¹⁶.

24.10 Në vijim, duket se në shkurt të vitit 2023 subjekti i është drejtuar sërish zyrës së Kadastrës Durrës për nxjerrjen e certifikatës së pasurisë vetëm në emrin e tij për pasurinë objekt vlerësimi. Në kërkesën e bërë, por edhe nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 20.2.2023¹⁷, subjekti ka referuar se e ka humbur certifikatën origjinale të pronësisë, të tërhequr pranë ZVRPP-së Durrës për pasurinë nr. ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***, duke kërkuar të lëshohet dublikata e kësaj certifikate.

24.11 Bazuar në aplikimin e bërë nga subjekti (nr. ***, datë 2.3.2023), për t'u pajisur me dublikatë të certifikatës së pronësisë dhe regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 13.5.2015, në datën 15.3.2023 Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës¹⁸ ka urdhëruar¹⁹: (i) të shpallet e pavlefshme certifikata e pronësisë me nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e lëshuar në datën 11.3.2008, në bashkëpronësi të shtetasve Gëzim dhe F.Ç ; (ii) të pajisen me certifikatë pronësie trashëgimtarët e shtetasen F.Ç për pasurinë nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, të cilët janë z. Gëzim Çopa, dhe gjithashtu të

¹¹ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 14.3.2002 (vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 29.3.2002).

¹² Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2003, redaktuar nga noteri publik, znj. M.N.

¹³ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. *** (***) , datë 17.1.2008.

¹⁴ Dokumenti noterial, dëshmi trashëgimie ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015.

¹⁵ Aplikimi i bërë nga subjekti në ZVRPP-në Durrës me nr. ***, datë 29.5.2015.

¹⁶ Shkresë e ZVRPP-së Durrës nr. *** prot., datë 8.7.2015.

¹⁷ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2023, redaktuar nga noteri publik, z. I.H.

¹⁸ Drejtoria përfaqësuar me delegim nga zv/drejtori.

¹⁹ Urdhër nr. ***, datë 15.3.2023.

hyjë në bashkëpronësi edhe znj. F.Ç , me ¼ pjesë takuese bazuar në certifikatën familjare të datës 1.8.1991.

24.11.1 Pas nxjerrjes së këtij urdhri, pasuria objekt vlerësimi është regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, duke u lëshuar edhe certifikata përkatëse e pronësisë, nga ku rezulton se subjekti zotëron ¾ pjesë takuese të kësaj pasurie, ndërsa personi i lidhur ¼ pjesë takuese të saj (pasuria e llojit pemëtores + truall, me sipërfaqe totale 5,687 m², nga e cila 300 m² truall dhe 90 m² ndërtesë).

25. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar në dosje – Komisioni çmon se deklaratimet e ndryshme në deklaratat e interesave privatë periodikë për pjesën takuese të subjektit kanë ardhur si pasojë e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, në fillim të të atit dhe në vijim të nënës së tij. Për sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

26. Zotëron 100% të pasurisë së llojit shtëpi banimi dykatëshe + papafingo, me sipërfaqe trualli 886 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 479 m², si dhe garazh me sipërfaqe 66 m². Kjo pasuri ndodhet në fshatin Sh, Njësia Administrative Rr, Durrës, ndërtuar në vitet 1994 – 1996, me vlerë **5,000,000 lekë**²⁰.

26.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: (i) trashëgiminë ligjore, duke referuar dëshminë e trashëgimisë me vendimin e gjykatës nr. ***, datë 17.1.2008 dhe dokumentin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës truall në emër të nënës së tij F.Ç , me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.1995.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

26.2 Në deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.6.2005), subjekti i rivlerësimit²¹, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të dy shtëpive banimi të ndodhura në fshatin Sh, me sipërfaqe banimi 450 m², njëra me vlerë 10,000 USD, në dukje e deklaruar si e krijuar/ndërtuar në vitin 1994, dhe tjetra me vlerë 30,000 USD, në dukje e deklaruar si e krijuar/ndërtuar në vitin 2001.

26.2.1 I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja²² lidhur me këto dy pasuri, duket se për pasurinë objekt vlerësimi subjekti referon se ka filluar ndërtimi në vitin 1991 me leje ndërtimi të cilën nuk e posedon. Deri në vitin 1993 ka kryer një pjesë të punimeve në vlerën e përgjithshme 200,000 lekë, ndërsa pas muajit janar 1995, periudhë në të cilën ka përfutuar të ardhura nga shitja e tokës bujqësore, ka rifilluar punimet dhe i ka përfunduar ato në vitin 1998. Sa i përket vlerës së shpenzuar, deklaroi se ka qenë në total rreth 4 milionë lekë.

26.3 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit²³, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit shtëpi banimi me sipërfaqe ndërtimi 432 m² dhe truall 600 m², ndodhur në fshatin Sh, Komuna Rr, Durrës, e ndërtuar vetë dhe e përfunduar në vitin 1996, e hipotekuar, me vlerë 40,000 USD. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së llojit tokë truall në vitin 1994.

²⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 8.7.2015; (ii) kontratë shitjeje trualli nr. ***/***, datë 26.1.1995; (iii) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 17.1.2008, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënës Sh.Çopa; (iii) dëshmi trashëgimie ligjore nr. ***, datë 13.5.2015, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënës F.Ç .

²¹ Në atë periudhë me funksion oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²² Referojuni dokumentit procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive, i datës 11.2.2015, dërguar në Komision nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2023.

²³ Në atë periudhë me funksion si ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI.

26.4 Në DIPP-në e vitit 2011, në një seksion të veçantë të kësaj deklarate, në lidhje me shtëpinë e banimit 3-katëshe, në fshatin Sh, Komuna Rr, Durrës, të deklaruar që në deklarimin para fillimit të detyrës, subjekti saktëson se sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 9.2.2012, sipërfaqja e parcelës ku është ndërtuar shtëpia mban nr. *** dhe është 886 m².

26.5 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit²⁴, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit shtëpi banimi dykatëshe + papafingo, me sipërfaqe truall 886 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 479 m², si dhe garazh me sipërfaqe 66 m². Kjo pasuri ndodhet në fshatin Sh, Njësia Administrative Rr, Durrës, ndërtuar në vitet 1994 – 1996, me vlerë 5,000,000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar trashëgiminë ligjore dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës truall në emër të nënës së tij F.Ç , me kontratën e shitjes datë 26.1.1995.

Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

26.6 Mungesë dokumentacioni ligjor për justifikimin e vlerës së deklaruar të ndërtimit të banesës në Sh, Durrës, prej 5,000,000 lekësh, në vitet 1994 – 1996.

26.7 Mospërputhje të sipërfaqes së truallit dhe asaj të ndërtimit, të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, 886 m² truall dhe 479 + 66 m² ndërtim, krahasuar me deklarimin para fillimit të detyrës 2009, për 600 m² truall dhe 432 m² ndërtim. Vlerat përkatëse janë deklaruar 5,000,000 lekë dhe 40,000 USD.

26.8 Në dokumentacionin e ardhur nga ZVRPP Durrës, konkretisht në kartelën e pasurisë është shënuar regjistrimi “Me leje legalizimi të vitit 2013”, për të cilën subjekti nuk është shprehur në deklaratën *Vetting*. Në deklaratën periodike/vjetore 2013 ka deklaruar shpenzimet e kryera për legalizimin e shtëpisë në Sh, Durrës.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

27. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri²⁵, Komisioni konstaton se:

27.1 Në datën 20.1.1997, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, të ndjerit Sh.Ç , figuron të jetë lëshuar AMTP-ja me nr. regjistri ***, në referim të të cilit në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, familjes së shtetasit Sh.T.Ç i jepet në pronësi tokë gjithsej 12,900 m², nga të cilat 4,300 m² arë, 3,500 m² pemëtore, 1,100 m² vreshtë dhe 500 m² truall. Bazuar në këtë AMTP, ndër të tjera, evidentohet pasuria nr. ***, me vendndodhje ngastre “****”, me sipërfaqe totale të tokës 700 m², nga të cilat 400 m² e llojit arë dhe 300 m² truall.

27.2 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 14.3.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur²⁶ lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të trashëgimlënësit Sh.Ç , në favor të trashëgimtarëve të radhës së parë F.Ç e Gëzim Çopa, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta nga ½ pjesë secili në pasurinë e trashëgimlënësit.

²⁴ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

²⁵ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) shkresa e ZQRPP-së nr. *** prot., datë 14.8.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (ndodhur në aneksin nr. ***); (iii) dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 26.7.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.7.2023); (iv) shkresa e ASHK Drejtoria Vendore Durrës nr. *** prot., datë 4.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023); (v) dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

²⁶ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 14.3.2002 (i cili ka marrë formë të prerë në datën 29.3.2002).

27.3 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 17.1.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur²⁷ lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Sh.Ç , duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të tij bashkëshorten F.Ç dhe të birin Gëzim Çopa.

27.4 Në datën 9.2.2012, në emër të subjektit Gëzim Çopa dhe nënës së tij F.Ç figuron e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, volum ***, faqe ***, me sipërfaqe totale 886 m², nga e cila 886 m² truall dhe 257 m² sipërfaqe ndërtimore (në këtë datë duket se është lëshuar edhe certifikata e pronësisë).

27.4.1 Në seksionin “Përshkrim i veçantë” të kartelës së kësaj pasurie referohet leja e legalizimit nr. ***, datë 9.4.2013, në dukje për: ndërtesën ***, kati përdhe 191 m², kati i parë 191 m² dhe kati i dytë 97 m²; ndërtesën ***, garazh, kati përdhe 66 m².

27.4.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij është lëshuar leja e legalizimit nr. ***, datë 9.4.2013, për objektin godinë banimi 3 kate + garazh 1 kat.

27.4.3 Në vijim të hetimit, Komisioni i kërkoj Drejtorisë Vendore të ASHK-së Durrës²⁸ referencën e plotë të pasurisë objekt vlerësimi. Kjo Drejtori²⁹ ka dërguar vetëm kopje të kartelës së kësaj pasurie, duke informuar se kanë “Referencë në mungesë”.

27.4.4 Por, gjithsesi, referuar dokumentacionit shkresor të administruar në dosjen e hetimit, si dhe bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti, duket se pasuria objekt vlerësimi/ose të paktën një pjesë e saj fillimisht është përfituar nëpërmjet AMTP-së nr. ***, datë 20.1.1997, lëshuar në emër të babait të subjekti, në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore.

27.5 Në datën 7.5.2013, në emër të subjektit dhe nënës së tij (si bashkëpronarë) është lëshuar dokumenti certifikatë pronësie nr. ***, për pasurinë nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit truall + ndërtesë, me sipërfaqe totale 886 m², truall 886 m² dhe sipërfaqe ndërtimore *** m².

27.5.1 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar shpenzime për legalizimin e shtëpisë në Sh, P, Durrës, në shumën 120,000 lekë.

27.6 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 13.5.2015, noteri publik, znj. G.B , ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore³⁰ për shtetasen F.Ç , duke përcaktuar trashëgimtar të vetëm të saj të radhës së parë djalin Gëzim Çopa.

27.7 Në datën 8.7.2015, në emër të subjektit është lëshuar dokumenti certifikatë pronësie nr. ***, për pasurinë objekt vlerësimi.

27.8 I pyetur nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri³¹, për fazat e ndërtimit të saj dhe burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për kryerjen e investimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se ndërtimi ka filluar në verën e vitit 1993 dhe deri në janar të vitit 1995 kanë qenë të përfunduara vetëm themelet e tri dhomave, një kuzhinë + aneks, mbuluar me soletë, prej 130 m². Nga kjo sipërfaqe ka qenë e përfunduar me kushte banimi një dhomë, një kuzhinë dhe tualeti. Duke filluar nga janari i vitit 1995, kanë vijuar punimet dhe kanë përfunduar në vitin 1996. Deri në vitin 1995 deklaroi se punimet për këtë objekt kanë qenë në vlerën 100,000 lekë, me burim nga paga e tij si ekonomist dhe si drejtues i pushtetit lokal në ish-Komunën Rr.

²⁷ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. *** (***) , datë 17.1.2008.

²⁸ Shkresë e Komisionit nr. *** prot., datë 4.10.2023.

²⁹ Shkresë e ASHK Drejtorisë Vendore Durrës nr. *** prot., datë 4.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023).

³⁰ Dokumenti noterial dëshmi trashëgimie ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015.

³¹ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ***, dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

Pjesa tjetër e punimeve pas janarit 1995 është mbuluar me të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës së nënës.

27.9 Komisioni konstaton se, referuar dokumentit leje legalizimi nr. ***, datë 9.4.2013, subjekti ka depozituar kërkesën për legalizimin e pasurisë objekt vlerësimi në datën 20.9.2006.

28. Sa më sipër, duket se subjekti ka deklaruar të dhëna kontradiktore lidhur me kohën e fillimit dhe mbarimit të ndërtimit të pasurisë objekt vlerësimi, si dhe mbi vlerën e saj.

29. Komisioni kreu verifikime në geoportalin “ASIG”, me qëllim evidentimin e fazave të ndërtimit të kësaj pasurie. Nga një foto e vitit 1994, duket se evidentohet gjurma e kësaj ndërtese. Gjithashtu, gjenden pamje të vitit 1999, nga ku duket sikur ka qenë e vendosur çatia mbi këtë objekt, ndërsa, nga pamjet e përfituara nga “Google Earth Pro”, duket qartë pjesa e çatisë së këtij objekti. Po ashtu, sipas informacionit të përfituar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal³² duket se për këtë pasuri ka pasur kontratë të lidhur me operatorin e furnizimit me energji elektrike, të paktën nga data 28.12.1998.

30. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se, në datën 26.1.1995, nëna e subjektit, znj. F.Ç , ka shitur³³ pasurinë e llojit truall me sipërfaqe 1,200 m², pjesë e truallit prej 5,000 m² në pronësi të saj, të ndodhur në Sh, Durrës (përfituar si trashëgimtare me vendim të KKP-së Durrës), për vlerën 5,175,000 lekë.

31. Nga ana tjetër, megjithëse në mungesë të të dhënave të sakta për fazat e investimit të kryer mbi këtë pasuri, por referuar vetëdeklarimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, nga ku duket se para shityes së tokës nga nëna kjo ndërtesë ka qenë e përfunduar të paktën për 130 m² ndërtim, pasi i ishte hedhur soleta, duket se të ardhurat e tij për periudhën 1992 – janar 1995 në total janë në shumën prej rreth 200,000 lekësh³⁴, gjithsesi nuk kanë qenë të mjaftueshme për kryerjen e këtij investimi dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera familjare të tij.

32. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 9.12.1996, “Për miratimin e vleftave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vleftës së koeficientit “K”, duket se kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 1995 për qytetin e Durrësit është në vlerën 13,849 lekë/m² ndërtim. Në kushtet kur duket se ndërtimi i këtij objekti ka filluar para vitit 1995, në qasje objektive paraprakisht Komisioni vlerësoi si kosto mesatare të ndërtimit të këtij objekti për këto vite (deri në janar 1995) vlerën 10,000 lekë/m². Gjithashtu, në mungesë të të dhënave të sakta për gjendjen e kësaj godine/investimin e kryer mbi këtë pasuri deri në janar të vitit 1995, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, minimalisht u vlerësua se ajo ka qenë e ndërtuar pjesërisht në një kat të saj, përshtatur për banim dhe mbuluar me soletë për 130 m².

32.1 Pra, për sipërfaqen e ndërtuar prej 130 m² duket se investimi i kryer deri në janar të vitit 1995 vlerësohet në shumën 1,300,000 lekë (sipërfaqe totale të ndërtimit për banim prej 130 m² * kosto mesatare e ndërtimit 10,000 lekë/m² = 1,300,000 lekë).

33. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimin e vlerësuar si të kryer mbi këtë pasuri deri në janar të vitit 1995.

34. Sa i përket pjesës tjetër të godinës me sipërfaqe 415 m², duket se mund të jetë e përfunduar deri në fund të vitit 1998. Bazuar në vendimet e Entit Kombëtar të Banesave (EKB) për vitet 1996 e 1999³⁵, duket se kostoja mesatare e ndërtimit për këto vite për objekte në qytetin e

³² Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.2.2021).

³³ Kontratë shitjeje trualli nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.1995, redaktuar nga noteri publik, z. A.T .

³⁴ Referojuni dokumentit vërtetim për bazën e vlerësueshme, lëshuar nga DRSSH Durrës, ndodhur aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵ (i) Vendim nr. 815, datë 9.12.1996, “Për miratimin e vleftave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vleftës së koeficientit “K”; (ii) vendim nr. 13, datë 5.1.1998, “Për miratimin e kosto mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të

Durrësit është në vlerën 20,436 lekë/m². Marrë për bazë këtë kosto mesatare ndërtimi, duket se vlera e ndërtimit e pjesës tjetër të pasurisë objekt vlerësimi paraqitet në shumën 8,480,940 lekë (sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 415 m² * kosto mesatare e ndërtimit 20,436 lekë = 8,480,940 lekë).

34.1 Krahas të ardhurave të përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme (në total shuma 5,175,000 lekë), për periudhën shkurt 1995 – dhjetor 1998, rezulton se subjekti ka përfituar të ardhura nga paga në total shumën prej rreth 700,000 lekësh. Nuk evidentohen të ardhura të tjera të personit të lidhur dhe/apo prindërve të tij nga pagat apo pensionet për këtë periudhë. Vlen të përmendet këtu se nga nëntori i vitit 1998 subjekti pretendon të ardhura qiraje nga ky objekt, por duket se nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura të pretenduara.

35. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimin e vlerësuar si të kryer mbi këtë pasuri për periudhën shkurt 1995 – 31.12.1998.

36. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke i kërkuar të japë shpjegime dhe të depozitojë prova të reja të mundshme mbi mospërputhjet e evidentuara dhe konstatimet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar plotësisht investimin e kryer në ndërtimin e pasurisë objekt vlerësimi, shtëpisë së banimit 2 kate + papafingo + garazh, të ndodhur në fshatin Sh, Njësia Administrative Rr, Durrës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

37. Me anë të prapësimeve të depozituara dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij, si dhe depozitoi prova të reja shpesh mbi gjetjet/konstatimet e bëra nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri, duke parashtruar sa më poshtë vijon:

37.1 *Së pari*, referon se kjo pasuri vjen si rrjedhojë e trashëgimisë, e krijuar kryesisht nga të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës truall nga nëna e tij F.Ç , sipas kontratës së shitjes datë 26.1.1995.

37.2 *Së dyti*, sjell në vëmendje se kjo pasuri është krijuar para periudhës së rivlerësimit, duke evidentuar sërish faktin se është një pasuri që vjen për shkak të ligjit, duke qenë se ai ishte trashëgimtar i vetëm i prindërve të tij.

37.3 *Së treti*, kur ka deklaruar se ndërtimi i kësaj banese ka filluar në vitin 1991, ka pasur parasysh faktin se lejet e truallit nga Këshilli i Bashkuar Rr (duke evidentuar faktin se në atë kohë në zonat rurale jepej vetëm leje sheshi, pra nuk kishte leje ndërtimi), për një sërë ndërtimesh në këtë zonë, janë miratuar në mbledhjen e këtij Këshilli në shtator të vitit 1991. Deklaron se në atë kohë familja e tij ka filluar punën për sistemimin e sheshit ku do të kryhej ndërtimi dhe për grumbullimin e materialeve të rezistueshme, si gurët për themelet, tullat për ndërtim, gëlqerja etj. Referon se ka deklaruar e shpjeguar se ndërtimin e kësaj banese e ka filluar dhe e ka ndjekur deri në përfundimin e saj babai i tij Sh.Ç . Kështu, subjekti i qëndron shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke konfirmuar se deri në janar të vitit 1995 kanë qenë ndërtuar themelet e tri dhomave, një kuzhinë plus aneks dhe një tualet mbrapa shtëpisë, dhe se ky ndërtim ka qenë i mbuluar me soletë dhe ka zënë një sipërfaqe rreth 130 m².

37.4 *Së katërti*, kundërshton konstatimin e Komisionit që ndërtimi i katit përdhe të kësaj banese deri në janar të vitit 1995 të vlerësohet në shumën 1,300,000 lekë (sipërfaqja totale e ndërtimit për banim prej 130 m²), me kosto mesatare ndërtimi 10,000 lekë/m², për faktin se, ashtu sikurse

koeficientit “K”; (iii) vendim nr. 214, datë 28.4.1999, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banësive dhe të koeficientit “K” (referon kostot për vitin 1998).

e ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ, vlera e një tulle (material ndërtimi) ka qenë rreth 4 lekë për copë dhe kuintali i çimentos ka qenë rreth 100 lekë. Në vijim, ka argumentuar se ndërtimet në zonat rurale në atë kohë bëheshin në pjesën më të madhe të tyre me kontributin (ndihmë) e ndërtuesve/ustallarëve, punonjës në ish-kooperativat bujqësore të zonës dhe se me këtë formë ndërtimi, me kontribut (ndihmë), babai i tij ka përfunduar pothuaj të gjithë ndërtimin e sipërfaqes prej 130 m².

37.5 *Së fundmi*, pasi referon edhe një herë se në janar të vitit 1995 janë përfituar të ardhurat nga shitja e tokës truall, trashëguar nga nëna e tij – shpjegon se miku i babait, arkitekti i njohur H.K, pa shpërblim, ka bërë projektin e shtëpisë dhe më pas ka vazhduar ndërtimi sipas këtij projekti. Subjekti deklaron se banesa ka qenë e banueshme në fund të vitit 1996³⁶, duke pretenduar se nuk është i saktë konstatimi i Komisionit se: *“..Sa i përket pjesës tjetër të godinës me sipërfaqe prej 415 m², duket se mund të jetë përfunduar deri në fund të vitit 1998”*. Në këtë kontekst, subjekti kërkon që të përlllogaritet ndërtimi i kësaj pjese të objektit me koston mesatare të ndërtimit, që i përket viteve 1995 – 1996. Gjithashtu, në përlllogaritjen e koston së ndërtimit kërkon që të zbritet TVSH-ja (tatimi mbi vlerën e shtuar) 20%, minimumi 10% si fitim dhe shpenzime të përgjithshme rreth 10%, pasi referon se ndërtimi i kësaj banese nuk është kryer me shoqëri ndërtimi dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur personel për mbikëqyrjen e punimeve.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe ligjit të zbatueshëm

38. Sa i përket pretendimit të subjektit se kjo pasuri është përfituar për shkak të ligjit si trashëgimtar i vetëm i prindërve të tij, Komisioni çmon se nuk jemi në rastin klasik të përfitimit të një pasurie nga trashëgimia ligjore. Komisioni vlerëson se kemi të bëjmë me një pasuri të krijuar në tërësi nga familja Çopa, pjesë e së cilës ka qenë edhe vetë subjekti i rivlerësimit, megjithëse duket se si burim kryesor në ndërtimin e saj kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit prej shitjes së tokës truall në janar të vitit 1995.

38.1 Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se pavarësisht se kjo pasuri është krijuar përpara fillimit të detyrës, ajo duhet të jetë objekt verifikimi në kuadër të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë çmohet se nëpërmjet procesit të rivlerësimit shqyrtohet edhe e shkuara e subjekteve të rivlerësimit.

38.2 Në vijim të arsyetimit, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit është analizë edhe e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe për këtë shkak institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin në të shkuarën për të cilin është krijuar kjo pasuri dhe rivlerësimi *Vetting* mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksionet publike.

38.3 Në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ka arritur në konkluzionin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.

38.4 Në këtë këndvështrim, për efekt të këtij procesi, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ka pasur detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe të mos fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij dhe organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të

³⁶ Në mbështetje të prapësimeve të tij ka depozituar si prova të reja disa foto familjare dhe foto të tjera të referuara si të bëra në ambientet e brendshme dhe të jashtme të kësaj godine, të pretenduara si të realizuara në momente të ndryshme, që i përkasin periudhës 1993 – 1997.

justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

38.5 Komisioni vëren se, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe nëpërmjet parashtrimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar në tërësi shpjegimeve të dhëna më parë mbi mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, duke argumentuar dhe depozituar disa prova të reja mbështetëse në funksion të vlerësimit përfundimtar mbi periudhën e ndërtimit dhe përfundimit të këtij objekti, si dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

38.6 Sa i përket periudhës së investimit të kryer për këtë pasuri, në mungesë të evidencave të sakta dhe të pakundërshtueshme, si dhe bazuar në *indiciet* dhe provat indirekte të paraqitura nga subjekti lidhur me ndërtimin e këtij objekti, trupi gjykues çmoi të pranojë pretendimet e paraqitura, duke vlerësuar përfundimisht se ndërtimi i këtij objekti është kryer përgjatë viteve 1992 – 1996. Në këtë përfundim, krahas rrethanave të evidentuara më sipër, trupi gjykues u bazua edhe në AMTP-në e datës 20.1.1997 ku, ndër të tjera, në ndarjen e tokës bujqësore që ka përfituar në tërësi familja Çopa, tokës ku bën pjesë kjo godinë i referohet me vendndodhje ngastre “***”. Pra, duket se në janar të vitit 1997 familja Çopa ka pasur të ndërtuar dhe të banueshme pasurinë objekt vlerësimi.

38.7 Në lidhje me fazat e investimit, në konsideratë të periudhës së largët gjatë së cilës është ndërtuar ky objekt, disa vite para fillimit të deklarimit të interesave privatë prej funksionarëve publikë dhe rreth 20 vite para fillimit të ushtrimit të funksionit të prokurorit nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe të faktit se të dy prindërit e tij kanë ndërruar jetë – kjo vlerësuar si rrethanë e cila pamundëson deklarimin dhe provueshmërinë e ndonjë burimi tjetër nga ana e tyre si bashkinvestorë (të supozuar në padijen nga subjekti), trupi gjykues përfundimisht çmoi të kryhet një analizë e përgjithshme e kësaj pasurie, duke mos e ndarë në periudha ndërtimin e saj, por duke vlerësuar në tërësi koston totale të ndërtimit të të gjithë objektit dhe të ardhurat e subjektit e familjarëve të tij për periudhën 1992 – 1996, si burim i mundshëm i krijimit të kësaj pasurie.

38.8 Në lidhje me koston e ndërtimit të këtij objekti, në kushtet kur u pranua se është ndërtuar përgjatë viteve 1992 – 1996, në vlerësim përfundimtar Komisioni iu referua Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 9.12.1996, “Për miratimin e vleftave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vleftës së koeficientit “K”, ku duket se kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 1995 për qytetin e Durrësit është në vlerën 13,849 lekë/m² ndërtim, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 5.1.1998, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K”, ku duket se kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 1996 për qytetin e Durrësit është në vlerën 16,437 lekë/m² ndërtim. Bazuar në këto dy vendime, si dhe në konsideratë të faktit nga ku duket se investimi kryesor mbi këtë pasuri është kryer në vitet 1995 – 1996, u përlllogarit kostoja mesatare e ndërtimit për metër katror, në vlerën 15,143 lekë.

38.8.1 Marrë për bazë këtë kosto mesatare ndërtimi, duket se vlera e ndërtimit të pasurisë objekt vlerësimi paraqitet në shumën 8,252,935 lekë (sipërfaqe totale e ndërtimit për banim prej 545 m² * kosto mesatare e ndërtimit 15,143 lekë = 8,252,935 lekë).

38.8.2 Bazuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”, Komisioni konstaton se si elemente të strukturës së koston së punimeve të ndërtimit përfshihen 3 kategori: shpenzimet e drejtpërdrejta; shpenzimet e përgjithshme; fitimi dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).

38.8.3 Në vijim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, Komisioni vërejti se ai kërkon që në vlerësimin final të vlerës së këtij objekti të zbritet TVSH-ja 20%, fitimi në minimum 10% dhe shpenzime të tjera të përgjithshme në masën 5%, për sa kohë ky ndërtim nuk është kryer nga shoqëri ndërtimore.

38.9 Në analizë të kuadrit ligjor mbi sistemin fiskal të aplikueshëm për periudhën gjatë së cilës është kryer ky ndërtim, Komisioni vëren se:

38.9.1 Referuar nenit 4 të ligjit nr. 7676, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi qarkullimin” (aktualisht i shfuqizuar), tatimi mbi qarkullimin llogaritet 20% për bashkësitë ekonomike dhe për degët e tjera ku taten produktet që shiten jashtë tyre, dhe 15% për të gjitha subjektet e tjera.

38.9.2 Në nenin 30 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (aktualisht i shfuqizuar), parashikohet se TVSH-ja zbatohet në masën 12.5%, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe. Ndërsa në nenin 60 të këtij ligji, përcaktohet se zbatimi i TVSH-së dhe zëvendësimi i tatimit mbi qarkullimin fillon tremujorin e katërt të vitit 1995. Pra, duket se në tre tremujorët e parë të vitit 1995 tatimi mbi qarkullimin “TVSH” ka qenë në masën 20%.

38.10 Mbështetur në të gjitha aktet dhe deklaratimet e administruara gjatë hetimit administrativ, në kushtet kur duket se ky objekt është i ndërtuar në mënyrë informale – pra jo nga subjekte të licencuara dhe të regjistruara në organin tatimor, dhe për më tepër sipas subjektit kryesisht me punë vullnetare të familjarëve dhe miqve të familjes, trupi gjykues çmoi t’i zbrisë vlerës së mësipërme minimalisht shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSH-në (tatim mbi vlerën e shtuar) + fitim + fond rezervë³⁷, vlera këto të cilat vlerësohen se janë të përfshira në përlllogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për EKB-në.

38.11 Bazuar në kuadrin ligjor të kohës, si dhe në një qasje objektive dhe proporcionale, Komisioni vlerëson se vlera mesatare e TVSH-së për periudhën e ndërtimit të këtij objekti ka qenë rreth 17%, rrethanë kjo sigurisht e vlerësuar në kushtet kur pranohet se faza më intensive e ndërtimit të këtij objekti ka qenë në periudhën që i përket viteve 1995 – 1996. Sa i përket normës së fitimit, Komisioni e vlerëson në masën 10%, ndërsa fondin rezervë në masën 5%.

38.12 Në këto rrethana, duke i zbritur vlerës prej 8,252,935 lekësh shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSH-në + fitimin + fondin rezervë, pra 32% të saj, vlera e ndërtimit të këtij objekti shkon në shumën prej rreth 5.6 milionë lekësh (68% e vlerës p 8,252,935 lekë). Vlen të evidentohet këtu se, krahas qasjes garantiste të mbajtur mbi periudhën e ndërtimit të këtij objekti, në përcaktimin e çmimit final për metër katror/ndërtimit të këtij objekti nuk cenohet çmimi prej 10,000 lekë/m², i vlerësuar paraprakisht me rezultatet e hetimit për periudhën 1992 – 1994, pasi gjithsesi çmimi mesatar final i përcaktuar për ndërtimin e këtij objekti është vlerësuar në shumën prej rreth 10,300 lekë/m² ndërtim.

38.13 Gjithashtu, Komisioni vëren se kjo shumë e vlerësuar është e përafërt me vlerën e kësaj pasurie të deklaruar nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në këtë kontekst, duke marrë në konsideratë edhe kohën e gjatë të kaluar nga ndërtimi i këtij objekti te evidentimi i të dhënave të kësaj pasurie: (i) në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë; (ii) në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI; (iii) në deklaratën *Vetting*; si dhe (iv) me shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ të kryer – deklaratimet e pasakta apo kontradiktore të konstatuara si më sipër nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë, apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt.

38.14 Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së familjes Çopa për investimin e kryer në ndërtimin e pasurisë objekt vlerësimi, për periudhën 1992 – 1996, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

³⁷ Referojuni paragrafit nr. 37 të vendimit të Kolegjit të Apelimit nr. 15/2019 (JR).

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1992 – 1996	Vlerat në lekë
A) Pasuri	5 611 996
Pasuria e llojit tokë truall + ndërtesë, ndodhur në Sh, Durrës	5 611 996
Ndryshim likuiditeti	0
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	5 611 996
D) Të ardhura	5 672 330
Të ardhura nga paga e subjektit	497 330
Të ardhura nga shitja e pasurisë së llojit tokë truall, datë 26.1.1995	5 175 000
E) Shpenzime	328 238
Shpenzime jetike	328 238
Balanca e fondeve (D-C-E)	-267 904

39. Sa më sipër, Komisioni konstaton se familja Çopa ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar plotësisht vlerën e vlerësuar si të investuar për ndërtimin e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, por se, në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit³⁸ nga trupi gjyqësor, u konkludua se kjo balancë negative fondesh nuk është e tillë për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

40. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore, me sipërfaqe totale 3,682 m², nga e cila 300 m² truall dhe 56 m² ndërtesë, ndodhur në fshatin Sh, Durrës. Deklaron se toka është blerë në vitin 2002 me anë të kontratës së shitblerjes nr. * rep., nr. *** kol., datë 14.11.2002, me vlerë 480,000 lekë³⁹.**

40.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga qiraja e banesës, lëshuar për shoqërinë ndërkombëtare “**** ” në vitet 1998 – 2003.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

40.2 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit⁴⁰, ndër të tjera, ka deklaruar të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi vlerën e saj dhe burimin e krijimit, sikurse i ka referuar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Rezulton se kjo pasuri me të dhënat e saj, vlerën dhe burimin e krijimit, është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit⁴¹ edhe në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015).

40.2.1 Komisioni konstaton se kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 30.6.2005⁴².

40.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Durrës.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

41. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e

³⁸ Referojuni qëndrimit të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin nr. 38/2021 (JR).

³⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, datë lëshimi 8.1.2003; (ii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.11.2002; (iii) prokurë e posaçme nr. ***, datë 28.2.2002.

⁴⁰ Në atë periudhë me funksion ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI.

⁴¹ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁴² Në atë periudhë me funksion oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

deklaratës Vetting, si dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri⁴³, konfirmohet se në datën 14.11.2002 subjekti i rivlerësimit ka blerë⁴⁴ pasurinë e llojit pemishte + truall + ndërtesë, me sipërfaqe gjithsej 3,682 m², nga të cilat 300 m² truall, 56 m² ndërtesë dykatëshe e përbërë nga dy dhoma, dy kuzhina, dy korridore dhe ambiente ndihmëse dhe pjesa tjetër që mbetet prej 3,326 m² është pemishte, me nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e ndodhur në Sh , Durrës, për çmimin 480,000 lekë. Referuar kartelës së kësaj pasurie, duket se ajo është regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit të rivlerësimit, në datën 8.1.2003.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie

42. Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia e shtëpisë 3-katëshe në Sh , Durrës dhe prej punësimit nga subjekti/kompania “**** ”, për periudhën nëntor 1998 – tetor 2003, në total në shumën 155,800 USD.

42.1 Në mbështetje të deklarimeve të tij bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar⁴⁵, si dhe gjatë hetimit administrativ, subjekti ka depozituar dokumentet si vijon: (i) kontratë qiraje, lidhur në datën 12.3.2000 (shkresë e thjeshtë) në gjuhë të huaj (italiane), e cila duket se referon marrëdhënien e qiradhënies mes nënës së subjektit dhe shoqërisë “****” për periudhën 20.3.2000 – 31.12.2000, për vlerën 3,200 USD/muaj; (ii) kontratë qiraje (shkresë e thjeshtë) në gjuhë të huaj (italiane), e cila duket se referon marrëdhënien e qiradhënies mes nënës së subjektit dhe shoqërisë “**** ” për periudhën 1.1.2001 – 31.12.2001, për vlerën 3,200 USD/muaj, ku përfshihet pagesa për punën *part-time* për subjektin e rivlerësimit si ekonomist; (iii) kontratë qiraje (shkresë e thjeshtë) në gjuhë të huaj (italiane), e cila duket se referon marrëdhënien e qiradhënies mes nënës së subjektit dhe shoqërisë “**** ” për periudhën 1.1.2002 – 31.12.2002, për vlerën 3,200 USD/muaj, ku përfshihet pagesa për punën *part-time* për subjektin e rivlerësimit si ekonomist; (iv) kontratë qiraje (shkresë e thjeshtë) në gjuhë të huaj (italiane), e cila duket se referon marrëdhënien e qiradhënies mes nënës së subjektit dhe shoqërisë “****” për periudhën 1.1.2003 – 31.10.2003, për vlerën 3,200 USD/muaj, ku përfshihet pagesa për punën *part-time* për subjektin e rivlerësimit si ekonomist; (v) listë personeli i “**** Zyra”, në të cilin me numër rendor 3 duket se paraqitet emri i subjektit me titullin “****”; (vi) listë personeli i **** , mensa **** , me 22 punonjës; (vii) listë personeli i **** , mensa **** , me 30 punonjës.

42.2 Pasi Komisioni i kërkoi të japë detaje mbi marrëdhënien e tij dhe familjes së tij me shoqërinë “**** ”, si dhe të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor dhe të provojë pagesën e tatimit mbi këto të ardhura të pretenduara, subjekti deklaroi se nuk disponon kontratat e qirasë për periudhën nëntor 1998 – mars 2000. Sa i përket pagesës së tatimit, ai deklaroi se nëna e tij ka qenë e kujdesshme dhe se duhet të jetë paguar ky detyrim. Për më tepër, referon se “**** ” si shoqëri e huaj ka pasur parasysh këto detyrime kundrejt shtetit në momentin që ka lidhur marrëdhënie kontraktore në Shqipëri⁴⁶.

⁴³ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) shkresa e ZQRPP-së nr. *** prot., datë 14.8.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (ndodhur aneksin nr. ***); (iii) dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 26.7.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.7.2023); (iv) shkresa e ASHK Drejtoria Vendore Durrës nr. *** prot., datë 4.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023); (v) dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

⁴⁴ Kontratë shitblerjeje – pemishte + truall + ndërtesë, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2002, redaktuar nga noteri publik, z. I.H.

⁴⁵ Dokumentacion i ndodhur në aneksin nr. *** , në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁶ I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja, subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se: “...Nga muaji nëntor i vitit 1998 deri në muajin tetor 2003, shtëpinë e banimit 3-katëshe prindërit e tij ia kanë dhënë me qira shoqërisë “****”. Shoqëria “****” (http://www.***.com/) është një shoqëri ndërkombëtare, aktualisht me seli në Monako, që ofron mbështetje të organizatave ndërkombëtare, në fushën e infrastrukturës, mbështetjes inxhinierike, furnizimit me ushqim dhe mallra, ofrimin e shërbimeve të kateringut dhe të shërbimeve të tjera logjistike të lidhura. Ka sqaruar se me fillimin

42.3 Duket se pas kërkesave të bëra nga subjekti për informacion dhe dokumentacion në lidhje me pagesën e tatimit mbi qiranë për marrëdhënien kontraktore të nënës së tij F.Ç me shoqërinë “***”, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës⁴⁷ ka paraqitur një interpretim të përgjithshëm, duke mos pasqyruar të dhëna konkrete për marrëdhënien e sipërcituar, qoftë edhe të faktit nëse kjo shoqëri ka qenë e regjistruar si tatimpaguese.

43. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion të plotë justifikues ligjor marrëdhënien e qiradhënies me shoqërinë “*** ” për të gjithë periudhën e referuar, si dhe pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga kjo marrëdhënie dhe, për rrjedhojë, duket se nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

43.1 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës në funksion të provueshmërisë së kësaj marrëdhënie qiraje, si dhe të pagesës së detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e pretenduara.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

44. Me anë të prapësimeve të depozituara dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij, si dhe depozitoi prova të reja shtesë mbi konstatimin e bërë nga Komisioni në lidhje me të ardhurat e pretenduara me burim qiradhënien e banesës, duke parashtruar sa më poshtë vijon:

44.1 *Së pari*, referon se marrëdhënia e qiradhënies është krijuar mes shoqërisë “*** ” dhe prindërve të tij, pasi ai vetë nuk ka qenë pjesë e saj dhe as nuk ka nënshkruar kontratat e qirasë me këtë shoqëri në mënyrë që të ngarkohej me detyrimin për pagesën e tatimit.

44.2 *Së dyti*, pretendon se këto të ardhura duhet të përfshihen dhe të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, për sa kohë disponohen dokumentacione të plota shkresore, sikurse janë kontratat e qirasë, që provojnë pikërisht përfitimin e këtyre të ardhurave nga qiraja.

44.3 *Së treti*, lidhur me formën juridike që ka pasur shoqëria “*** ” gjatë operimit të aktivitetit të saj në Shqipëri, nga informacionet që ka marrë shpjegon se kjo shoqëri kishte lidhur një marrëveshje me shoqërinë “*****” sh.p.k., me seli në Durrës, për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve shqiptarë në këtë shoqëri. Pra, referon se shoqëria “*** ” ka operuar në Shqipëri nëpërmjet marrëdhënies së bashkëpunimit me shoqërinë “*****” sh.p.k., ku edhe kanë qenë të regjistruar punonjësit që punonin pranë shoqërisë “*** ”.

44.3.1 Në vijim të prapësimeve të tij, evidenton faktin se me kërkesën e tij shoqëria “*****” sh.p.k. i vuri në dispozicion aktet: (i) marrëveshje të shoqërisë “*** ” me shoqërinë “*****” sh.p.k., për pagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve shqiptarë që punonin në shoqërinë “*** ”; (ii) kontratë qiraje të shtëpisë së prindërve të tij me shoqërinë “*** ” për vitin 2001; (iii) listat e personelit të shoqërisë “*** ” në mensa Vlorë, G dhe *** Italia; (iv) tre fletë, fotokopje të listëpagesave, të përgatitura nga shoqëria “*****” sh.p.k., mbi bazën e listave të personelit të dërguara nga shoqëria “*** ”, vetëm për qëllimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore⁴⁸.

*e luftës në Kosovë, shoqëria “***” ka realizuar furnizimin me ushqime dhe gatimin për forcat e NATO-s, që ishin të instaluar në ambientet e ish-Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Mbrojtjes.*

⁴⁷ Shkresë e DRT-së Durrës nr. *** prot., datë 21.11.2023, depozituar nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. ***.

⁴⁸ Këto dokumente i janë vënë në dispozicion subjektit në datën 7.2.2024, me shkresë përcjellëse nga shoqëria “*****” sh.p.k., pas kërkesës së bërë nga subjekti, e cila mban datën 30.1.2024.

44.3.2 Gjithashtu, vërehet se subjekti ka depozituar si provë të re shkresën nr. *** prot., datë 2.2.2024, të DRSSH-së Durrës, nëpërmjet së cilës referon se i janë vënë në dispozicion listëpagesat e subjektit “****” sh.p.k., për vitet 2001, 2002 dhe 2003, sipas listave të dërguara kësaj shoqërie nga “****”.

44.4 *Së katërtri*, duke qenë se nga momenti i ekzistencës së kësaj marrëdhënieje qiraje dhe operimit të kësaj shoqërie në Shqipëri dhe deri kur është përpiluar deklarata *Vetting* ka kaluar një periudhë kohore prej më shumë se 20 vjet, për shkak të ndërrimit të jetës së prindërve të tij, subjekti pretendon se është në pamundësi objektive për paraqitjen e dokumenteve provuese lidhur me pagimin e tatimit. Kjo, për shkak të kohës relativisht të gjatë prej 20 vitesh, si dhe faktit që detyrimin për pagimin e detyrimeve nuk e ka pasur ati vetë, por nëna e tij, dhe se për faktin se ajo nuk jeton më, nuk është në gjendje të verifikojë nëse këto detyrime tatimore që buronin nga marrëdhënia e qirasë janë paguar apo jo. Pra, ai pretendon se gjendet në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, duke evidentuar faktin se megjithëse ka bërë kërkesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, nuk ka marrë një përgjigje mbi pagesën ose jo të detyrimeve tatimore nga marrëdhënia e qiradhënies mes nënës së tij dhe shoqërisë “****”.

44.4.1 Në vijim të prapësimeve, për sa i përket pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga qiraja, sikurse ka shpjeguar edhe gjatë hetimit administrativ, në dijeninë e tij, nëna me gjithë moshën e saj ka qenë gjithmonë e kujdesshme dhe duhet t’i ketë paguar këto detyrime, duke marrë parasysh edhe faktin që shoqëria “****”, si shoqëri e huaj, i ka pasur parasysh edhe këto detyrime kundrejt shtetit në momentin që ka lidhur marrëdhënie kontraktore në Shqipëri, por se për shkak të kohës së kaluar institucionet shtetërore nuk kanë ruajtur asnjë gjurmë të pagimit të këtyre detyrimeve nga ana e nënës së tij.

44.5 *Së fundi*, pasi ka analizuar kuadrin ligjor të kohës mbi përcaktimet e bëra për pagesën e detyrimit tatimor për të ardhurat nga qiraja për periudhën që ka ekzistuar marrëdhënia në fjalë, argumenton se për një periudhë detyrimi për vetëdeklarimin e të ardhurave nga qiratë dhe pagesën e tatimit ka rënë mbi qiradhënësit – individ dhe për një periudhë tjetër ka qenë detyrim i qiramarrësit – ndërmarje, në rastin konkret shoqërisë “****”, që në rolin e agjentit tatimor të përllogariste, mbante në burim dhe ta derdhte atë në llogari të shtetit.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe ligjit të zbatueshëm

45. Nga analizimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, për të ardhurat e siguruara nga qiraja e banesës në pronësi të familjes Çopa me shoqërinë “****” dhe punësimin e subjektit në këtë shoqëri, rezultojnë faktet si më poshtë:

45.1 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia e shtëpisë 3-katëshe në Sh , Durrës, shoqërisë “****”, si dhe punësimi i tij në këtë kompani për periudhën nëntor 1998 – tetor 2003, në total në shumën 155,800 USD.

45.2 Në deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.6.2005), në seksionin e të ardhurave subjekti i rivlerësimit⁴⁹, ndër të tjera, ka deklaruar: “*Qira nga shtëpia për vitet 2000 – 2004, vlera 3,000 USD në muaj. Qira vjetore 36,000 USD. Paguar firma *****”.

45.3 Në sqarimet e dhëna më parë në ILDKPKI nëpërmjet procesverbaleve “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”⁵⁰, të datave 5.2.2015 dhe 11.2.2015, lidhur me këto të ardhura – pasi i ka evidentuar edhe si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi – ndër të tjera, në vijimësi të përgjigjeve të dhëna, ka deklaruar se: (i) nga puna e tij part-time te shoqëria ndërkombëtare “****”, e cila kishte fituar tenderin për furnizimin e forcave të NATO-s në P, Rr, Durrës, për periudhën qershor 1999 – dhjetor 2003, ka fituar afro 2,000 USD në muaj; (ii)

⁴⁹ Në atë periudhë me funksion oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵⁰ Procesverbale të dërguara nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.3.2023).

*burimi i të ardhurave të prindërve ka qenë... edhe nga dhënia me qira e një pjese të banesës për afro 3 vjet, me rreth 1,000 USD në muaj... kontrata ka qenë në emër të prindërve. Përveç shtëpisë së tij, shoqëria “*** ” mori me qira edhe banesat e komshinjve të tij, z. H.B dhe z. Z.D... Në pagesën e qirasë mujore hynte edhe pagesa nga puna e tij në këtë shoqëri, ku 1,000 USD qiraja + 2,000 USD paga e tij, afro 3,000 USD në muaj nga shoqëria “*** ”⁵¹.*

45.4 Nga ana tjetër, Komisioni konstaton se në momentin e deklarimit të parë të bërë nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI (në datën 30.6.2005), rezulton se ai kishte në emër të tij dy llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank, përkatësisht njëra me vlerë 4,200,000 lekë dhe tjetra me vlerë 32,000 USD. I pyetur nga ILDKPKI-ja mbi këto llogari, ndër të tjera, deklaroi se si burim krijimi i tyre kanë qenë edhe të ardhurat e përfituara prej tij dhe familjes nga marrëdhënia me shoqërinë “*** ”, duke referuar se shuma e gjendjes së llogarisë në lekë i përkiste nënës F.Ç , por se është depozituar në emër të tij.

45.5 Referuar marrëveshjeve të qirasë të depozituara nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, si dhe gjatë hetimit administrativ, evidentohen të dhëna mbi marrëdhënien e qiradhënies mes nënës së subjektit dhe shoqërisë “*** ”, si dhe të dhëna të punësimit të subjektit te kjo shoqëri, të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 2

Nr.	Data e lidhjes së kontratës	Periudha	Përfshihet puna e subjektit	Vlera e qirasë + punës/në muaj	Totali
1.	12.3.2000	20.3.2000 – 31.12.2000	Jo	3,200 \$	29,867 \$
2.	Nuk ka	1.1.2001 – 31.12.2001	Po	3,200 \$	38,400 \$
3.	Nuk ka	1.1.2002 – 31.12.2002	Po	3,200 \$	38,400 \$
4.	Nuk ka	1.1.2003 – 31.10.2003	Po	3,200 \$	32,000 \$
Totali					138,667 \$

46. Komisioni vëren se, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar dokumentin me titull “Kontratë konsulence e stafit” të lidhur mes shoqërisë “***” dhe shoqërisë “***”, nëpërmjet së cilës krijohet një marrëdhënie konsulence për menaxhimin e personelit.

46.1 Kështu, sipas kushteve të marrëveshjes, shoqëria “***” do të marrë si staf të gjithë punonjësit e shoqërisë “*** ”, të angazhuar me shërbime furnizimi dhe prokurimi me kontingjentin I A – N, që operon në territorin shqiptar. Më konkretisht, në këtë marrëveshje përcaktohet se shoqëria “***” do të marrë në ngarkim të gjithë stafin e punësuar, aktualisht në varësi të shoqërisë “*** - Durrës”, si dhe për çdo punonjës tjetër, në emër të të cilit do të sigurojë përmbushjen e të gjitha detyrimeve që lidhen me ligjet e punës dhe të sigurimeve shoqërore në fuqi në shtetin shqiptar. Shoqëria “***” do të paguajë të gjitha detyrimet e mësipërme të sigurimeve shoqërore, të cilat do të përgatiten çdo muaj nga shoqëria “***”. Shoqëria “***” garanton që të gjithë punonjësit e shoqërisë “***- Durrës” do të jenë të mbuluar dhe të siguruar sipas rregulloreve të sigurimeve shoqërore në fuqi në Shqipëri dhe merr përgjegjësi të plotë për këtë. Për këtë lloj të konsulencës, shoqëria “*** Durrës” do t’i paguajë shoqërisë “***” një shumë konsulence prej 1,000 USD në muaj. Kjo shumë do të paguhet me faturë të rregullt, me emërtimin “konsulencë”. Shuma do të mbetet fikse deri në 31 dhjetor 2001.

⁵¹ Ka depozituar një kopje kontrate qiraje mes shoqërisë “***” dhe nënës së tij F.Ç , për muajt mars – dhjetor të vitit 2000.

46.2 Sikurse u evidentua edhe më sipër, në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar listëpagesat e shoqërisë “****” sh.p.k. për vitet 2001, 2002 dhe 2003, të konfirmuara nga DRSSH Durrës.

46.3 Nga ana e Komisionit u krahasuan gjashtë lista personeli të shoqërisë “****”, tri prej të cilave të depozituara nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe tri të tjera me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit në raport me listëpagesat e konfirmuara të shoqërisë “****” për vitet 2001 – 2003.

46.3.1 Kështu, pas verifikimit të listës personelit të shoqërisë “**** Zyra”, në të cilin me numër rendor 3 paraqitet emri i subjektit të rivlerësimit me titullin “Economista”, rezulton se të tre shtetasit e pasqyruar në këtë listë në vazhdimësi për vitet 2001 – 2003 figurojnë si punonjës të deklaruar të shoqërisë “****”, për të cilët janë mbajtur dhe paguar detyrimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Gjithashtu, pas verifikimit të listave të personelit: (i) *** , mensa T; (ii) *** , mensa P; (iii) *** , mensa Vlorë; (iv) *** , mensa G; (v) *** , mensa *** – konfirmohet se shtetas të përfshirë në këto lista figurojnë si punonjës të deklaruar të shoqërisë “****”, për të cilët janë mbajtur dhe paguar detyrimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, për periudha të ndryshme që i përkasin viteve 2001 – 2003.

46.4 Gjithashtu, Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, në mbështetje të shpjegimeve të dhëna, subjekti ka depozituar si prova të reja edhe dy deklarata noteriale të shtetasve H.I dhe J.H .

46.4.1 Referuar deklaratës noteriale të shtetasit H.I⁵², ndër të tjera, rezulton se ky shtetas ka deklaruar se: *“...është komshi, me shtëpitë ngjitur me z. Gëzim Çopa, dhe se për periudhën janar 1999 deri në fund të vitit 2003 ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “****”, e cila e ushtronte aktivitetin e saj në P, Durrës dhe që merrej me kryerjen e shërbimeve të ndryshme në bashkëpunim me ****, në shërbim të forcave të NATO-s, që gjendeshin në Shqipëri e Kosovë. Në kohën kur ka filluar punë pranë kësaj shoqërie, kujton që punonjësit e kësaj shoqërie kishin vendosur në dhomën papafingo në shtëpinë e prindërve të z. Gëzim Çopa pajisjet e tyre të punës si kompjuterë etj. dhe banonin me qira tek kjo shtëpi. Në periudhën qershor 1999 – korrik 2003, shoqëria “****” mori me qira edhe shtëpinë e tij dhe të komshiut të tyre Z.D. Ai i kishte lënë me qira kësaj shoqërie ambientet që ndodhen në katin e parë të shtëpisë ku ishin tri dhoma dhe dy banjo, me vlerën 500 USD në muaj. Nuk e di vlerën e qirasë që kjo shoqëri i paguante prindërve të Gëzimit dhe komshiut të tyre Z.D. Kujton që prindërit e Gëzimit kishin lënë me qira të gjithë shtëpinë, edhe katin përdhe, dhe se Gëzimi kishte një ambient banimi, nuk kujton se sa, që qëndronte për vete dhe i shërbente për nevoja të ndryshme punonjësve të “****”... Tek shtëpia e tij punonjësit e “****” kanë qëndruar deri në korrik të vitit 2003, ndërsa nga shtëpia e prindërve të Gëzimit ato janë larguar të fundit, diku nga fundi i vitit 2003.”*

46.4.2 Ndërsa, referuar deklaratës noteriale të shtetasit J.H⁵³, ndër të tjera, rezulton se ky shtetas ka deklaruar se *ka punuar pranë shoqërisë “****” Durrës, si “asisten menager”. Punën pranë kësaj shoqërie e ka filluar në muajin mars të vitit 1999 dhe ka punuar pranë kësaj shoqërie deri në vitin 2007. Deri nga fundi i vitit 2003, kjo shoqëri ka qëndruar në Shqipëri në P, Durrës dhe ishte angazhuar me shërbime të furnizimit dhe kontraktimit me kontingjentin I A – N, që operonte në territorin shqiptar. Kur ka filluar punë, shoqëria “****” Durrës ishte vendosur në shtëpinë e bashkëshortëve Sh e F.Ç , që gjendet në fshatin Sh , Njësia Administrative Rr , Durrës. Fillimisht kjo shoqëri kishte marrë me qira katin e parë dhe papafingon në këtë shtëpi. Kujton që, për këto ambiente, fillimisht kjo shoqëri i paguante kësaj familjeje shumën 1,000 USD/muaj. Më pas, diku nga fillimi i vitit 2000, me shtimin e personelit të saj, kjo shoqëri mori me qira të gjithë banesën e familjes Çopa, ku di që është përpiluar kontratë e rregullt qiraje*

⁵² Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. O.Sh .

⁵³ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. O.Sh .

për këtë vit e në vazhdim. Kjo shoqëri më pas mori me qira edhe banesën e z. H.I dhe banesën e z. Z.D... Qiraja e banesës së familjes Çopa në këtë kohë, me marrëveshjen e palëve, pra nga fillimi i vitit 2000, u bë nga 1,000 USD në 3,200 USD në muaj dhe kjo qira në këtë shumë ka vazhduar derisa “*** ” Durrës, u largua nga banesa e familjes Çopa, diku nga fundi i vitit 2003, kohë kur kjo shoqëri u largua nga Shqipëria dhe vazhdoi aktivitetin në Kosovë.

46.5 Pas kontrollit të bërë në internet nëpërmjet motorit të kërkimit Google, Komisioni evidentoi faqen e web-it të kompanisë ndërkombëtare “*** ”⁵⁴, nga ku duket se në përshkrimin e përgjithshëm të aktivitetit të kësaj shoqërie referohet se: “*** është një kompani e njohur ndërkombëtarisht, që ofron zgjidhje të shpejta, realiste dhe efektive për klientët në rrethana të vështira që ngrihen në lokacione ekstreme gjeografike, situata të paqëndrueshme politike dhe vende me mungesë të infrastrukturës adekuate në mbarë botën... Ofrojnë zgjidhje logjistike të shpejta dhe efikase, shërbime kampesh, projekte ndërtimi kampesh dhe shërbime të menaxhimit të rrezikut dhe sigurisë, në mbështetje të agjencive qeveritare, organizatave ndër dhe joqeveritare, sektorëve të Energjisë dhe Biznesit e Industrisë”⁵⁵.

46.6 Po ashtu, pas verifikimit të disa fotografive, të cilat duket se tregojnë pamje të jashtme dhe të brendshme të banesës së subjektit të rivlerësimit, e cila referohet se ka qenë e dhënë me qira⁵⁶, në një nga muret e brendshme të ambienteve të kësaj banese vërehet se ndodhet një dokument që i përket shoqërisë “*** ”, me titull “Quality System Certificate”, me datë lëshimi 12.3.2002.

47. Komisioni, në vlerësim të situatës së mësipërme, mori fillimisht në analizë vërtetësinë e marrëdhënies mes familjes Çopa dhe shoqërisë “*** ” e, në këtë kuptim, të faktit nëse të ardhurat e pretenduara janë krijuar nga burime të ligjshme në kuptimin që ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” jep për to.

47.1 Kështu, Komisioni konstaton se marrëdhënia juridike që i ka siguruar këto të ardhura dhe shuma përkatëse është përshkruar në deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.6.2005) e cila, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerën e provës në këtë proces. Ky deklaram i subjektit të rivlerësimit në këtë deklaratë periodike duket të jetë i ngjashëm edhe me deklaramin e bërë në deklaratën e pasurisë *Vetting*.

47.2 Pra, trupi gjykues vëren se ky burim të ardhurash është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit që në deklaramin fillestar të pasurisë, si dhe nëpërmjet shpjegimeve drejtuar ILDKPKI-së në datat 5.2.2015 dhe 11.2.2015, duke shuar çdo dyshim për abuzim nga subjekti me burimin e të ardhurave vetëm në funksion të deklaramit *Vetting*. Pra, nuk jemi përpara rastit kur këto të ardhura deklarohen rishtas vetëm në deklaratën *Vetting* për qëllime të procesit të rivlerësimit.

47.3 Trupi gjykues çmon se ekzistojnë *indicie*/të dhëna/prova të mjaftueshme, të cilat të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur marrëdhënie financiare me shoqërinë “*** ” dhe se kanë përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie. Si një e dhënë e rëndësishme që tregon përfitimin e këtyre të ardhurave vlerësohet disponimi i një pjese prej tyre në sistemin bankar nga subjekti i rivlerësimit përpara deklaramit fillestar të pasurive të bërë në ILDKPKI në vitin 2005.

⁵⁴ https://www.***.com

⁵⁵ Referuar informacionit të përfituar nga faqja e web-it të “***”, duket se kjo kompani e ushtron aktivitetin e saj prej vitit 1955.

⁵⁶ Foto të depozituara nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

47.4 Në këtë kontekst, Komisioni vlerëson se, bazuar në nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile, shkresat e nënshkruara mes shoqërisë “*** ” dhe nënës së subjektit, znj. F.Ç (marrëveshjet për qira), marrin fuqi provuese për efekt të këtij procesi – për sa kohë ato gjejnë mbështetje dhe harmonizohen me të dhënat e provat e grumbulluara nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ, si: (i) deklaratimet e bëra nga subjekti në ILDKPKI dhe provat e tjera shkresore të depozituara prej tij; (ii) informacionin dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion subjektit nga shoqëria “***”, përfshirë këtu edhe informacionin e disponuar nga DRSSH Durrës; (iii) informacionin e përfituar nga burimet e hapura; (iv) deklaratimet e dhëna nga shtetasit H.I dhe J.H .

47.5 Në vijim të arsytimit, Komisioni evidenton faktin se të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia me shoqërinë “*** ” përfshihen si të ardhura të përfituara nga një burim i ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a” dhe “gj” të nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

47.6 Pra, nisur edhe nga ekzistenca e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimin fillestar të pasurisë për këtë burim të ardhurash, kohës së largët gjatë së cilës janë përfituar këto të ardhura, të cilat nuk lidhen me ushtrimin e detyrës, faktin që është nëna e subjektit që ka lidhur kontratën e qirasë dhe sot ka ndërruar jetë, si dhe faktit se subjekti rezulton të jetë trashëgimtari i vetëm i pasurisë, Komisioni përfundimisht vlerësoi të pranojë se subjekti dhe familjarët e tij kanë përfituar të ardhura nga marrëdhënia me kompaninë ndërkombëtare “*** ”, për periudhën mars 2000 – tetor 2003, sipas marrëveshjeve të qirasë të administruara në dosje.

47.7 Nën dritën e këtyre fakteve, bazuar në analizën dhe arsytimin logjik të kryer si më sipër, evidentimin e vlerave monetare të konsiderueshme në disponim të subjektit të rivlerësimit dhe gjendjen e trupëzuar/materializuar të tyre në sistemin bankar – të vetëdeklaruara me burim kryesor nga marrëdhënia financiare me shoqërinë “*** ”, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

47.8 Gjithsesi, duket se një e ardhur, që të konsiderohet si e ligjshme për efekt të këtij procesi sipas dispozitave të mësipërme, kërkon që të plotësohen në mënyrë kumulative elementet që dëshmojnë gjurmë të përfitimit të saj në kohën e përfitimit, se është e ardhur e siguruar nga burime të ligjshme (nga ato të parashikuara nga legjisllacioni për tatimin mbi të ardhurat) dhe se janë paguar detyrimet tatimore për të.

47.8.1 Kështu, sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, kushtet mbi bazën që do të duhet të bëhet ky vlerësim janë: (i) provueshmëria e burimit të krijimit të të ardhurave, provueshmëria e cila në rastin në fjalë konsiderohet e plotë prej këtij trupi gjykues; (ii) pagesa e detyrimeve tatimore, duke evidentuar edhe rastin e pagesës me vonesë të tatimit – i lidhur kryesisht me rrethanat kur të ardhurat janë përfituar nga persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit⁵⁷.

47.9 Në shqyrtim të situatës, sipas së cilës mbetet e paprovuar pagesa e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, Komisioni vlerësoi ta analizojë atë në raport me rrethanat dhe/apo çështjet si vijon: (i) kush e kishte detyrimin për pagesën e tatimit, pra nëse mospagesa e tatimit ka qenë për faj ose jo të subjektit; (ii) mundësinë e sigurimit të informacionit të plotë nga organi tatimor në lidhje me marrëdhënien financiare të tij dhe familjarëve me shoqërinë “*** ”; (iii) nëse subjekti apo personat e lidhur/të tjerë të lidhur kanë qenë në kushte keqbesimi, në kufijtë e kryerjes së veprës penale, në lidhje me mospagimin e detyrimeve tatimore; (iv) mundësinë e pagesës me vonesë të detyrimit tatimor përkatës nga përftimi i këtyre të ardhurave.

⁵⁷ Shihni vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 15/2021 (JR) dhe nr. 26/2023 (JR).

47.9.1 Komisioni vëren se marrëdhënia e subjektit dhe familjes së tij me shoqërinë “**** ” është një marrëdhënie juridike komplekse, e cila përfshin në vetvete punësim dhe qiradhënie objekti, në dukje vlerësuar si një marrëdhënie e përgjithshme shërbimi në funksion të aktivitetit të kësaj shoqërie. Nga ana tjetër, referuar akteve të administruara në dosje, duket se kompania ndërkombëtare “**** ” nuk ka pasur degë të regjistruara në organet tatimore shqiptare, por gjithsesi rezulton se në lidhje me punësimet e kryera prej saj ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë “****” sh.p.k., e cila ka marrë përsipër deklarin e këtyre punonjësve në organet përkatëse.

47.9.2 Referuar akteve të administruara në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni të plotë se pavarësisht se paguhej nga shoqëria “**** ”, deklarohej si punonjës i shoqërisë “****” sh.p.k. Në këtë përfundim, Komisioni u bazua në rrethanën e verifikuar, nga ku rezulton se në listat e personelit të shoqërisë “**** ” ai referohej me titullin “Economista”. Pra, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni të plotë për këtë marrëveshje dhe për listat që duhet t’i dorëzoheshin shoqërisë “****”, për efekt të deklarin të punonjësve pranë organeve kompetente. Sikurse u evidentua edhe më sipër, në kontratën e konsulencës parashikohej se shoqëria “****” sh.p.k. do të përmbushte të gjitha detyrimet që lidheshin me ligjet e punës dhe sigurimeve shoqërore në fuqi në shtetin shqiptar.

47.9.3 Nga verifikimi i listëpagesave të depozituara nga shoqëria “****” sh.p.k. për vitet 2001 – 2003, rezulton se të gjithë punonjësit e saj – ku përfshihen edhe punonjësit e shoqërisë “**** ” – janë deklaruar me pagë bruto nën pragun e pagës prej mbi 10,000 lekësh, mbi të cilën referuar dispozitave në fuqi për kohën, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, fillonte aplikimi i tatimit mbi të ardhurat personale nga puna (TAP).

47.9.4 Nga ana tjetër, vërehet se listat e dërguara nga “**** ” tek “****” sh.p.k. janë vetëm lista emërore të cilat nuk pasqyrojnë të dhëna të pagës së punonjësve të saj. Në kushtet kur rezulton se këto lista janë dërguar të tilla, duket se në realitet marrëveshja ka qenë vetëm sa për të mundësuar deklarin e këtyre punonjësve në organet përkatëse, për efekt sigurimesh shoqërore dhe shëndetësore, por duke shmangur pasqyrimin real të të ardhurave që ata përfitonin nga puna e kryer.

47.9.5 Këto rrethana tregojnë që nuk provohet plotësisht dhe tej çdo dyshimi të arsyeshëm dijenia e subjektit në atë periudhë mbi mosdeklarin real të pagës së tij nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe, për rrjedhojë, mbajtja dhe pagesa e TAP. Pra, duket se subjekti i rivlerësimit është mjaftuar me dijeninë e tij se ishte punonjës i deklaruar në organet kompetente e, për rrjedhojë, duke marrë të mirëqenë se të ardhurat nga puna e tij në atë periudhë i janë nënshtruar plotësisht legjislacionit të sigurimeve shoqërore dhe atij fiskal. Në vlerësimin e kësaj shtate duhet të mbahet parasysh edhe realiteti social-ekonomik i kohës, si dhe fakti se subjekti i rivlerësimit ishte në marrëdhënie pune/bashkëpunimi me një kompani ndërkombëtare me reputacion, e cila operonte që prej vitit 1955, ku në Shqipëri ofronte shërbimet e saj për kontingjentin e NATO-s.

47.9.6 Në vijim të arsyetimit, Komisioni arrin në përfundimin se mospagimi i tatimit mbi të ardhurat personale për të ardhurat e përfituara nga paga e subjektit si punonjës i shoqërisë “****” mbi shumën e referuar si të përfituar nga kjo marrëdhënie, nuk ka ardhur për faj të subjektit e, për rrjedhojë, duhet të kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Në arritjen e këtij përfundimi, përpos faktit se, referuar legjislacionit fiskal, detyrimin për mbajtjen, deklarin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale të punonjësve e kishte punëmarrësi (në këtë rast “**** ” nëpërmjet shoqërisë “****”), trupi gjykues u bazua edhe në bindjen e krijuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në kushte keqbesimi në raport me detyrimet tatimore që rridhnin nga marrëdhënia e tij me shoqërinë “**** ”.

47.10 Sa i përket marrëdhënies së qiradhënies dhe pagesës së detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, Komisioni vëren se në rastin kur kemi të bëjmë me një qiradhënës individ dhe qiramarrës subjekt tregtar të regjistruar në organin tatimor, sipas legjislacionit fiskal shqiptar

parimi i përgjithshëm është që subjekti tregtar (tatimpaguesi) në rolin e agentit tatimor ka detyrimin për mbajtjen, deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi qiranë, kur në kontratë nuk përcaktohet ndryshe.

47.10.1 Por, gjithsesi, në këtë rast nuk rezulton që shoqëria “**** ” të ketë qenë subjekt i regjistruar në organet tatimore shqiptare. Pra, duke mos qenë person fizik apo juridik rezident tregtar në shtetin shqiptar, nuk mund merrte rolin e agentit për mbajtjen, deklarimin dhe pagesën e tatimeve.

47.10.2 Në këto rrethana, Komisioni arrin në përfundimin se detyrimin për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja për të gjithë periudhën e ka pasur nëna e subjektit të rivlerësimit, si personi që ka nënshkruar marrëveshjet e qirasë me shoqërinë “**** ” e, për rrjedhojë, ka përfutuar të ardhura nga kjo marrëdhënie.

47.10.3 Por, nga ana tjetër në kushtet kur nga ky trup gjykues u pranua plotësisht provueshmëria e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, në vlerësim të faktit se mosprovueshmëria e pagimit të detyrimeve tatimore i përket nënës së subjektit, dhe duket se subjekti nuk ka dijeni apo një sjellje bashkëpunuese në këtë drejtim, duke vlerësuar përpjekjet e bëra në drejtim të sigurimit të informacionit mbi pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, si dhe në rrethanat kur duket i pamundur plotësimi i kushtit të pagesës së këtyre detyrimeve tatimore me vonesë, kjo përpos faktit të kohës së gjatë të kaluar nga përfitimi i këtyre të ardhurave, edhe për shkak se nëna e subjektit ka ndërruar jetë prej rreth 11 vitesh e, për rrjedhojë, subjekti si përfitues në vazhdim i këtyre të ardhurave apo i pasurive që rrjedhin nga ato nuk legjitimohet për kryerjen e këtyre pagesave, pranohet se këto të ardhura e kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016⁵⁸.

47.11 Vlen të evidentohet këtu se familja e subjektit duket se ka funksionuar si një ekonomi e përbashkët, në kushtet kur ai është djalë i vetëm dhe ka banuar në vazhdimësi me prindërit e tij. Në këtë kontekst, nga ana e trupit gjykues pranohet se të ardhurat e përfituara nga nëna e tij (familja) nga marrëdhënia e qirasë me shoqërinë “**** ” janë disponuar edhe nga subjekti i rivlerësimit dhe do të vlerësohen se janë vënë në dispozicion të ekonomisë familjare, duke u përdorur prej tij për kryerjen investimeve, krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve të tjera të familjes Çopa. Sjellim në vëmendje këtu se babai i subjektit ka ndërruar jetë në vitin 2001, ndërsa nëna e subjektit në vitin 2013.

48. Për sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht pagesën e kryer për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

49. Zotëron 100% të pasurisë të llojit tokë pyll, me sipërfaqe totale 28,104 m², ndodhur në Njësinë Administrative G, Bashkia Kavajë, për të cilën është lëshuar certifikata e pronësisë datë 17.5.2010, sipas vendimit të KKKP-së⁵⁹.

49.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar trashëgiminë ligjore sipas: (i) vendimit nr. ***, datë 17.1.2008; (ii) dokumentit noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015.

⁵⁸ Referojuni qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimet nr. 14/2021 (JR), nr. 15/2021 (JR), nr. 6/2022 (JR) dhe nr. 26/2023 (JR).

⁵⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 17.5.2010; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 17.5.2010; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 17.5.2010; (iv) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 17.5.2010; (v) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 17.5.2010; (vi) hartë treguese të regjistrimit; (vii) vendim nr. ***, datë 17.1.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës – për lëshimin e trashëgimisë ligjore; (viii) dokumentin noterial dëshmi trashëgimie ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

49.2 Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar se zotëron 50% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë truall në G, me sipërfaqe 28,104 m², sipas vendimit të Agjencisë së KKP-së, me certifikatë për vërtetim pronësie datë 17.5.2010.

49.3 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë truall me sipërfaqe 28,104 m², ndodhur në Komunën G Kavajë (vendimi i KKKP-së Tiranë; certifikatë pronësie datë 17.5.2010). Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: “Trashëguar nga babai Sh.Ç . Dëshmi trashëgimie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015”.

49.4 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Kavajë.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

50. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Kavajë, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Verfing*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:

50.1 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, në cilësinë e trashëgimtarit dhe përfaqësuesit me prokurë të trashëgimtarëve të ish-pronarit, z. Sh.Ç⁶⁰, Zyra Rajonale e Qarkut Tiranë e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, bazuar në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, i ndryshuar, në datën 26.6.2009 ka vendosur⁶¹:

50.1.1 *T’i njihet e drejta e pronësisë, për pronën me sipërfaqe 47,880 m², e ndarë në dy parcela:* (i) parcela me sipërfaqe 18,880 m², në fshatin S, Komuna G, Kavajë, me këto kufij: V. A.C, J. Rrugë, L. Rrugë, P. M.C; (ii) parcela me sipërfaqe 29,000 m², e ndodhur në fshatin G, Kavajë, me këto kufij: V. Y.C, J. D.C, L. D.A, P. Shtet, trashëgimtarëve të ish-pronarit, z. Sh.Ç , të përcaktuar në vendimin nr. *** , datë 17.1.2008 (dëshmi trashëgimie), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

50.1.2 *Kthimin e pronës me sipërfaqe 29,000 m², e ndodhur në fshatin G, Kavajë, në zonën kadastrale *** , në zërin kadastral pyll, me numra pasurie *** , *** , *** , *** , *** dhe *** , me kufij: V. Y.C, J. D.C, L. D.A, P. Shtet, trashëgimtarëve të ish-pronarit, z. Sh.Ç .*

50.1.3 *T’i njihet e drejta e kompensimit në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji trashëgimtarëve të ish-pronarit, z. Sh.Ç , për sipërfaqen e tokës bujqësore prej 14,280 m², brenda sipërfaqes së njohur prej 18,880 m², tokë bujqësore, në fshatin S, zona kadastrale *** , me këto kufij: V. A.C, J. Rrugë, P. M.C, trashëgimtarëve të ish-pronarit, z. Sh.Ç .*

50.2 Në vijim, subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë kërkuar në gjykatë lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv, vendimin nr. *** , datë 26.6.2009, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në datën 4.2.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur: “Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv, vendimin nr. *** , datë 26.6.2009, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

50.3 Në datën 17.3.2010, Zyra Përmbartimore Kavajë i është drejtuar ZVRPP-së Kavajë me “Lajmërim për ekzekutim vullnetar”⁶², duke urdhëruar: (i) njohjen e të drejtës së pronësisë, kthimin e pronës dhe të drejtën e kompensimit për trashëgimtarët ligjor të ish-pronarit Sh.Ç , sipas vendimit nr. *** , datë 26.6.2009, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

⁶⁰ Dokumenti noterial prokurë e posaçme nr. **** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2008, redaktuar nga noteri publik, znj. G.B.

⁶¹ Vendim nr. *** , datë 26.6.2009, i AKKP – Zyra Rajonale Tiranë, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2009.

⁶² Dokumenti lajmërim për ekzekutim vullnetar nr. *** prot., datë 17.3.2010.

(referuar si më sipër); (ii) ZVRPP Kavajë të kryejë veprimet përkatëse për ekzekutimin e vendimit të mësipërm.

50.4 Duket se, bazuar në vendimin e gjykatës të kthyer në titull ekzekutiv, në datën 17.5.2010⁶³, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij janë regjistruar pasuritë: (i) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit pyll, me sipërfaqe 5,793 m², ndodhur në G, Kavajë; (ii) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit pyll, me sipërfaqe 3,160 m², ndodhur në G, Kavajë; (iii) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit pyll, me sipërfaqe 2,732 m², ndodhur në G, Kavajë; (iv) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit pyll, me sipërfaqe 2,807 m², ndodhur në G, Kavajë; (v) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit pyll, me sipërfaqe 1,3612 m², ndodhur në G, Kavajë. Sipërfaqja totale e këtyre pasurive është 28,104 m².

50.5 Nga ana tjetër, duket se pas regjistrimit të këtyre pasurive ZVRPP Kavajë i është drejtuar⁶⁴ AKKP-së me kërkesën për “Konfirmim dhe vlerësim ligjshmërie” ku, pasi e informon se z. Gëzim Çopa ka aplikuar për regjistrimin e vendimit nr. ***, datë 26.6.2009, të ZRKKP-së të Qarkut Tiranë, ka kërkuar nëse është ankimuar ky vendim në AKKP-në Tiranë, pra nëse ai përbën titull ekzekutiv.

50.6 Kështu, në vijim të verifikimit të materialeve shkresore, pjesë e dosjes së kësaj pasurie, rezulton se ndaj vendimit të AKKP-së, Zyra Rajonale e Qarkut Tiranë, datë 26.6.2009, është ankimuar pranë ish-Zyrës Qendrore të AKKP-së nga Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Tiranë, për të cilën është hapur dosja ankimore nr. ***, datë 17.9.2009. Por, për shkak se në seancën gjyqësore të datës 2.3.2011, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka vendosur të urdhërojë pezullimin e ligjit nr. 10308, datë 22.7.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, në datën 20.9.2011, AKKP-së ka vendosur: “Pezullimin e procedimit administrativ⁶⁵ për dosjen ankimore nr. ***, datë 17.9.2009, që i përket subjektit të shpronësuar Sh.Ç , deri në përfundimin e çështjes gjyqësore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 10308, datë 22.7.2010, nga ana e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Me këtë vendim është njoftuar ZVRPP Kavajë⁶⁶.

50.7 Siç u evidentua edhe më sipër, pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 13.5.2015, noteri publik, znj. G.B , ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore⁶⁷ për shtetasen F.Ç , duke përcaktuar trashëgimtar të vetëm të saj të radhës së parë djalin Gëzim Çopa.

50.8 Duket se, bazuar në këtë dëshmi trashëgimie ligjore, pasuritë e sipërcituara të llojit pyll, në total me sipërfaqe 28,104 m², në datën 28.9.2017 janë regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

51. Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

52. Zotëron 75% të pasurisë së llojit tokë arë, me sipërfaqe totale 2,007 m², ndodhur në fshatin Sh , Durrës. Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është përfituar nëpërmjet këmbimit (kontratë këmbimi datë 10.12.2007) me tokë të përfituar më parë prej tij nga ligji nr. 7501, “Për tokën” dhe trashëgimia ligjore⁶⁸.

⁶³ Referuar dokumenteve kartela e pasurisë, si dhe certifikatave për vërtetim pronësie nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, me datë lëshimi 17.5.2010 (pjesë të dosjes).

⁶⁴ Shkresë e ZVRPP-së Kavajë nr. **** prot., datë 29.7.2011.

⁶⁵ Vendim i AKKP-së nr. ***, datë 20.9.2011 (protokolluar me nr. *** prot., datë 20.9.2011), përcjellë në ZVRPP-në Kavajë me shkresën e AKKP-së nr. *** prot., datë 20.9.2011.

⁶⁶ Nuk ka të dhëna/informacione të tjera për ecurinë e këtij procedimi administrativ.

⁶⁷ Dokumenti noterial dëshmi trashëgimie ligjore nr. *** rep., nr. **** kol., datë 13.5.2015.

⁶⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 13.12.2007; (ii) kontratë këmbimi pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 10.12.2007.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

52.1 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit⁶⁹, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% të pasurisë së llojit tokë arë dhe pemëtoje, me sipërfaqe 2,007 m², ndodhur në fshatin Sh, Komuna Rr, Durrës, përfituar me kontratë këmbim pasurie në vitin 2007. Rezulton se kjo pasuri me të dhënat e saj, si dhe mënyrën e përfitimit (burimi i krijimit), është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit⁷⁰ edhe në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015).

Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

52.2 Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Kavajë.

52.3 Subjekti ka deklaruar zotërim 75% të kësaj pasurie, por dokumentacioni i paraqitur prej tij dhe përgjigjja e ZVRPP-së Durrës konfirmojnë zotërim 100% të tij.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

53. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, konstatohet se në datën 10.12.2007 subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë këmbyer⁷¹ me familjen T pasurinë e llojit vresht me sipërfaqe 1,100 m², ndodhur në z. k. ***, volum ***, faqe ***, me nr. pasurie ***, me pasurinë e llojit pemishte me sipërfaqe 2,007 m², ndodhur në z. k. ***, volum ***, faqe ***, me nr. pasurie ***.

53.1 Bazuar në kontratën e këmbimit të nënshkruar mes palëve, në datën 13.12.2007, pasuria e llojit pemishte me sipërfaqe 2,007 m² është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, si përfaqësues i familjes (lëshuar certifikata për vërtetim pronësie me nr. serie ***).

53.2 Nga ana tjetër, konfirmohet se pasuria e llojit vresht me sipërfaqe 1,100 m² ishte përfituar më parë nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij bazuar në AMTP-në me nr. regjistri ***, datë 20.1.1997. Duket se pas lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë ligjore të babait dhe autorizimit të dhënë nga nëna e tij, kjo pasuri ishte regjistruar në emër të subjektit si përfaqësues i familjes bujqësore.

54. Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

55. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore, ullishtë, me sipërfaqe totale 1,750 m², ndodhur fshatin Sh , Durrës⁷².

55.1 Burimi i krijimit: Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është përfituar nga ligji nr. 7501, “Për tokën”, si dhe nga trashëgimia ligjore.

⁶⁹ Në atë periudhë me funksion ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI.

⁷⁰ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁷¹ Kontratë këmbimi pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.12.2007, redaktuar nga noteri publik, znj. G.B .

⁷² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 6.12.2012.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

55.2 Në deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.6.2005), subjekti ka deklaruar⁷³ se zotëron 25% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 12,000 m², përfituar me ligjin nr. 7501.

55.3 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit⁷⁴, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% të pasurisë së llojit tokë bujqësore dhe ullishtë me sipërfaqe 3,500 m², ndodhur në fshatin Sh , Komuna Rr, Durrës, përfituar nga ligji nr. 7501, “Për tokën”.

55.4 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit⁷⁵, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore, ullishtë me sipërfaqe 1,750 m², ndodhur në fshatin Sh , Durrës.

55.5 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Mosdeklarim nga subjekti i lejes së ndërtimit të vitit 2010, marrë për “mur rrethues” në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, truall me sipërfaqe 1,750 m², në Sh , Durrës, regjistruar në pronësi të z. Gëzim Çopa, po ashtu edhe vlera e investuar.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

56. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:

56.1 Në datën 20.1.1997, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, të ndjerit Sh.Ç , figuron të jetë lëshuar AMTP-ja me nr. regjistri ***, në referim të të cilit në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, familjes së shtetasit Sh.T.Ç i jepet në pronësi tokë gjithsej 12,900 m², nga të cilat 4,300 m² arë, 3,500 m² pemëtoare, 1,100 m² vreshtë dhe 500 m² truall. Bazuar në këtë AMTP, ndër të tjera, evidentohet pasuria nr. ***, në vendndodhjen “S”, e llojit ullishtë, me sipërfaqe 3,500 m².

56.2 Bazuar në AMTP-në nr. ***, në datën 26.1.1999 është regjistruar në emër të babait të subjektit, z. Sh.Ç , pasuria nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit ullishtë⁷⁶. Te kartela e pasurisë, në seksionin “Përshkrim i veçantë” referohet se: “*Kjo pasuri në aktin *** ndodhet me nr. ****”.

56.3 Pas padisë së ngritur nga subjekti i rivlerësimit, në datën 14.3.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur⁷⁷ lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të trashëgimlënësit, z. Sh.Ç , në favor të trashëgimtarëve të radhës së parë F.Ç e Gëzim Çopa, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta nga ½ pjesë secili në pasurinë e trashëgimlënësit.

56.4 Bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore, në datën 16.9.2003, kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa.

⁷³ Me funksion oficer i policisë gjyqësore.

⁷⁴ Në atë periudhë me funksion ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI.

⁷⁵ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁷⁶ Referojuni dokumentit kartelë e pasurisë së paluajtshme.

⁷⁷ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 14.3.2002 (i cili ka marrë formë të prerë në datën 29.3.2002).

56.5 Në datën 23.9.2003, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. F.Ç , ka nënshkruar një deklaratë noteriale⁷⁸, me anë të së cilës ka deklaruar së është dakord që si kryetar i familjes bujqësore të caktohet i biri i saj Gëzim Çopa.

56.6 Në datën 24.10.2003, nëna dhe bashkëshortja e subjektit kanë nënshkruar një deklaratë noteriale, me anë të së cilës deklarojnë se janë dakord që si kryetar i familjes bujqësore të caktohet z. Gëzim Çopa.

56.7 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 17.1.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur⁷⁹ lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Sh.Ç , duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të tij bashkëshorten F.Ç dhe të birin Gëzim Çopa.

56.8 Në kartelën e rifreskuar të kësaj pasurie, në seksion “Përshkrim i veçantë” referohet se: *“Me leje ndërtimi nr. ***, datë 26.5.2010, regjistrim muri rrethues”*.

56.8.1 I pyetur nga Komisioni⁸⁰ mbi këtë rrethanë, subjekti deklaron se nuk ka kryer investime mbi këtë pasuri, duke referuar se nuk disponon leje ndërtimi dhe se i është drejtuar njësisë administrative për të marrë informacion në formë zyrtare⁸¹.

56.9 Në datën 26.11.2012, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie me nr. serial ***, për pasurinë e llojit truall me nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, me sipërfaqe totale 3,500 m².

56.10 Në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka bërë kërkesë për ndarjen e pasurisë nr. ***, të llojit ullishtë me sipërfaqe totale 3,500 m², regjistruar në volum ***, faqe ***, z. k. ***. Më konkretisht, referuar kësaj kërkesë, sipas planit të rilevimit të paraqitur, subjekti do që ta ndajë në: (i) pasurinë nr. ***, me sipërfaqe 1,750 m²; (ii) pasurinë nr. ***, me sipërfaqe 1,750 m².

56.11 Bazuar në kërkesën e subjektit, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës ka bërë ndarjen e pasurisë nr. *** në dy pasuri: (i) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit truall me sipërfaqe 1,750 m²; (ii) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit truall me sipërfaqe 1,750 m².

56.12 Në datën 6.12.2012, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, janë lëshuar certifikatat për vërtetim pronësie për dy pasuritë e sipërcituara, ku evidentohet se për pasurinë objekt vlerësimi të llojit truall me nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, me sipërfaqe 1,750 m², është lëshuar certifikata me nr. serial ***.

56.13 Në datën 4.1.2013, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij i kanë shitur⁸² shoqërisë “****” sh.p.k. pasurinë nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit truall me sipërfaqe 1,750 m², kundrejt çmimit 210,000 euro.

56.14 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, subjekti ka deklaruar shitjen e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m² (përfutur me ligjin nr. 7501, “Për tokën”), në vlerën 210,000 euro.

57. Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

⁷⁸ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. **** kol., datë 23.9.2003, redaktuar nga noteri publik, znj. M.N .

⁷⁹ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. *** (***) , datë 17.1.2008.

⁸⁰ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ***.

⁸¹ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit ka depozituar shkresën e datës 7.11.2023, protokolluar pranë Njesisë Administrative Rr me nr. *** prot.

⁸² Kontratë blerjeje trualli nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2013, redaktuar nga noteri publik, z. A.G.

58. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore, me sipërfaqe totale 2,000 m², ndodhur në fshatin Sh , e ndarë në tri parcela⁸³.

58.1 Burimi i krijimit: Subjekti i rivlerësimit deklaron se e ka përfiturar këtë pasuri nga ligji nr. 7501, “Për tokën” dhe trashëgimia ligjore, sipas dëshmimeve të trashëgimisë ligjore të referuara si më sipër.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

58.2 Në deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.6.2005), subjekti ka deklaruar⁸⁴ se zotëron 25% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 12,000 m², përfiturar me ligjin nr. 7501.

58.3 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit⁸⁵, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% të pasurisë së llojit tokë arë me sipërfaqe 2,000 m², ndodhur në fshatin Sh , Komuna Rr, Durrës, përfiturar me ligjin nr. 7501, “Për tokën”.

58.4 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit⁸⁶, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 2,000 m², ndodhur në fshatin Sh , Durrës, përfiturar me ligjin nr. 7501, “Për tokën” dhe trashëguar pjesa e prindërve.

58.5 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Durrës. (Nga dokumentacioni i ZVRPP-së Durrës evidentohet se këtë pasuri subjekti e ka shitur në vitin 2004, por në vitin 2005 blerësi ia kthen/shet me të njëjtin çmim).

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

59. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:

59.1 Në datën 20.1.1997, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, të ndjerit Sh.Ç , figuron të jetë lëshuar AMTP-ja me nr. regjistri ***, në referim të të cilit në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, familjes së shtetasit Sh.T.Ç i jepet në pronësi tokë gjithsej 12,900 m², nga të cilat 4,300 m² arë, 3,500 m² pemëtoje, 1,100 m² vreshtë dhe 500 m² truall. Bazuar në këtë AMTP, ndër të tjera, evidentohet pasuria nr. ***, në vendndodhjen “R”, e llojit arë me sipërfaqe 2,000 m².

59.2 Bazuar në AMTP-në nr. ***, në datën 26.1.1999 është regjistruar në emër të babait të subjektit, z. Sh.Ç , pasuria nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit arë⁸⁷. Te kartela e pasurisë, në seksionin “Përshkrim i veçantë” referohet se: “*Kjo pasuri në aktin *** ndodhet me nr. ****”.

59.3 Pas padisë së ngritur nga subjekti i rivlerësimit, në datën 14.3.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur⁸⁸ lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së trashëgimlënësit, Sh.Ç

⁸³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) tri certifikata për vërtetim pronësie, të datës 13.12.2007, si dhe hartat treguese të pasurive.

⁸⁴ Me funksion oficer i policisë gjyqësore.

⁸⁵ Në atë periudhë me funksion ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI.

⁸⁶ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁸⁷ Referojuni dokumentit kartelë e pasurisë së paluajtshme.

⁸⁸ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 14.3.2002 (i cili ka marrë formë të prerë në datën 29.3.2002).

, në favor të trashëgimtarëve të radhës së parë F.Ç e Gëzim Çopa, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta nga ½ pjesë secili në pasurinë e trashëgimlënësit.

59.4 Bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore, në datën 16.9.2003, kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa.

59.5 Në datën 23.9.2003, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. F.Ç, ka nënshkruar një deklaratë noteriale⁸⁹, me anë të së cilës ka deklaruar se është dakord që si kryetar i familjes bujqësore të caktohet i biri i saj Gëzim Çopa.

59.6 Në datën 24.10.2003, nëna dhe bashkëshortja e subjektit kanë nënshkruar një deklaratë noteriale, me anë të së cilës deklarojnë se janë dakord që si kryetar i familjes bujqësore të caktohet z. Gëzim Çopa.

59.7 Në datën 26.10.2004, subjekti dhe familjarët e tij ia shesin⁹⁰ pasurinë objekt vlerësimi, të llojit tokë arë me sipërfaqe 2,000 m², shtetasit S.B, për vlerën 1,950,000 lekë.

59.8 Në datën 16.9.2005, subjekti ia blen⁹¹ pasurinë objekt vlerësimi, të llojit tokë arë me sipërfaqe 2,000 m², shtetasit S.B, për vlerën 1,950,000 lekë.

59.9 Në datën 10.12.2007, subjekti i rivlerësimit ka bërë kërkesë për ndarjen e pasurisë nr. ***, të llojit tokë arë me sipërfaqe totale 2,000 m², regjistruar në volum ***, faqe ***, z. k. ***. Më konkretisht, referuar kësaj kërkesë, sipas planit të rilevimit të paraqitur, subjekti do që ta ndajë në pasuritë: (i) nr. ***, me sipërfaqe 600 m²; (ii) nr. ***, me sipërfaqe 600 m²; (iii) nr. ***, me sipërfaqe 800 m².

59.10 Bazuar në kërkesën e subjektit, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës ka bërë ndarjen e pasurisë nr. ***, në tri pasuri: (i) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit tokë arë me sipërfaqe 600 m²; (ii) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit tokë arë me sipërfaqe 600 m²; (iii) nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit tokë arë me sipërfaqe 800 m².

59.11 Në datën 13.12.2007, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, janë lëshuar certifikatat për vërtetim pronësie për tri pasuritë e sipërcituara⁹².

60. Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

61. Zotëron 100% të pasurisë së llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 2,717 m², ndodhur në fshatin Sh, Durrës, blerë në vitet 2003 dhe 2005, në vlerën 1,300,000 lekë (kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2003 dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2005)⁹³. **Si burim krijimi** të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e përfituara prej qirasë nga shoqëria “****”, në vitet 1998 – 2003.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

61.1 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit⁹⁴, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 2,717 m², ndodhur në fshatin Sh, Komuna Rr, Durrës, në shumën prej ... euro (referon kontratën).

⁸⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2003, redaktuar nga noteri publik, znj. M.N.

⁹⁰ Kontratë shitjeje tokë arë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.10.2004, redaktuar nga noteri publik, z. F.H.

⁹¹ Kontratë shitjeje tokë arë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.9.2005, redaktuar nga noteri publik, z. F.H.

⁹² Referojuni shënimeve të bëra në dokumentin kartelë pasurie e paluajtshme.

⁹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 5.4.2005; (ii) kontratë shitjeje nr. ***, datë 27.10.2003; (iii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 3.3.2005.

⁹⁴ Në atë periudhë me funksion ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI.

61.2 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit⁹⁵, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 2,717 m², ndodhur në fshatin Sh , Komuna Rr, Durrës, në vlerën 1,300,000 lekë (kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2003 dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2005). **Si burim krijimi** të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e përfituara prej qirasë nga shoqëria “****”, në vitet 1998 – 2003.

61.3 Komisioni konstaton se kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.6.2005)⁹⁶.

61.4 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Konfirmohet nga ZVRPP Durrës pasuria e deklaruar, tokë bujqësore me sipërfaqe 2,717 m², në Sh , krijuar nga bashkimi i dy pasurive.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

62. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:

62.1 Në datën 27.10.2003, subjekti i rivlerësimit ka blerë⁹⁷ nga shtetasi I.Z pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 1,002 m², ndodhur në Sh , Durrës, z. k. ***, volum ***, faqe ***, për çmimin 500,000 lekë.

62.2 Në datën 3.3.2005, subjekti i rivlerësimit ka blerë⁹⁸ nga familja K pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 1,715 m², ndodhur në Sh , Durrës, z. k. ***, volum ***, faqe ***, për çmimin 800,000 lekë.

62.3 Në datën 8.3.2005, nëpërmjet një deklaratë të nënshkruar para noterit publik⁹⁹, ka kërkuar bashkimin e dy pasurive të sipërcituara të blera prej tij në tetor të vitit 2003 dhe në mars të vitit 2005, në një pasuri të vetme me sipërfaqe totale 2,717 m².

62.4 Bazuar në kërkesën e bërë nga subjekti, në datën 16.3.2005, nga zyra hipotekore është kryer bashkimi i këtyre pasurive¹⁰⁰, duke u regjistruar në emër të subjektit pasuria nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit tokë arë me sipërfaqe 2,717 m².

62.5 Në datën 5.4.2005, në emër të subjektit është lëshuar dokumenti certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë objekt vlerësimi, të llojit tokë arë me sipërfaqe 2,717 m² (pasuria nr. ***) .

63. Sa më sipër, rezulton së subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi. Gjithashtu, bazuar në analizën e kryer mbi të ardhurat e përfituara prej subjektit dhe familjarëve të tij nga marrëdhënia me shoqërinë “****”, trupi gjykues konkludon se subjekti ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht pagesën e çmimit për blerjen e kësaj pasurie.

64. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë truall, me sipërfaqe totale 3,128 m², ndodhur fshatin Sh , Durrës¹⁰¹.

⁹⁵ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁹⁶ Në atë periudhë me funksion oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹⁷ Kontratë shitjeje tokë arë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2003, redaktuar nga noteri publik, z. F.H .

⁹⁸ Kontratë shitblerjeje për pasuri të paluajtshme tokë bujqësore arë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2005, redaktuar nga noteri publik, znj. A.H .

⁹⁹ Dokumenti deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.3.2005, redaktuar nga noteri publik, znj. A.H .

¹⁰⁰ Referojuni dokumentit kartelë pasurie.

¹⁰¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 8.7.2015; (ii) vërtetim pronësie datë 6.6.1994; (iii) vendim i KKP-së Durrës nr.

64.1 Burimi i krijimit: Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka trashëguar këtë pasuri nga nëna e tij, duke cituar dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015. Gjithashtu, në deklarin e bërë duket se subjekti ka referuar se kjo pasuri është fituar më parë nga nëna e tij sipas një vendimi të KKKP-së Durrës.

64.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit¹⁰², ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë truall me sipërfaqe 3,128 m², ndodhur në fshatin Sh , Durrës, përfituar me vendimin e KKKP-së Durrës të vitit 1994, trashëguar prej nënës së tij F.Ç (dëshmi trashëgimie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015).

64.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Durrës. (Nga dokumentacioni i ZVRPP-së Durrës evidentohen transaksione me pronën, të kryera pas deklaratës së rivlerësimit. Kjo pasuri rezulton trashëgimi e nënës së subjektit nga babai i saj).

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

65. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:

65.1 Pas kërkesës së bërë nga shtetasja F.Ç (nëna e subjektit), si trashëgimtare e ish-pronarit B.D, me vendimin nr. ***, datë 24.3.1994, Komisioni i Kthimit të Pronave Ish-Pronarëve Rrethi Durrës ka vendosur: (i) të njohë të drejtën e kthimit të tokës truall prej 5,000 m² të trashëgimtares F.Ç , në fshatin Sh , duke specifikuar kufizimet përkatëse të kësaj pasurie; (ii) kompensimin e 400 m² tokë sipas ligjit.

65.2 Referuar dokumentit vërtetim pronësie datë 6.6.1994, Zyra e Hipotekës Durrës konfirmon se në emër të shtetasës F.B.Ç, si trashëgimtare e ish-pronarit B.D, në bazë të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. ***, datë 24.3.1994, figuron e regjistruar pasuria e llojit tokë truall me sipërfaqe 5,000 m², e ndodhur në fshatin Sh . E drejta e pronësisë mbi këtë pronë vërtetohet në bazë të regjistrimit në regjistrin nr. ***, datë 6.6.1994.

65.3 Në datën 26.1.1995, nëna e subjektit, znj. F.Ç , i shet¹⁰³ shtetasit I.I pasurinë e llojit truall me sipërfaqe 1,200 m², pjesë e truallit prej 5,000 m² në pronësi të saj, të ndodhur në Sh , Durrës (të evidentuar si më sipër), për vlerën 5,175,000 lekë.

65.3.1 Pas realizimit të kësaj shitjeje, në emër të nënës së subjektit, znj. F.Ç , mbetet në pronësi pasuria e llojit truall me sipërfaqe 3,800 m², ndodhur në Sh , Durrës.

65.4 Në datën 16.1.1997, nëna e subjektit, znj. F.Ç (përfaqësuar me prokurë nga subjekti i rivlerësimit)¹⁰⁴, i shet¹⁰⁵ shtetasit L.H pasurinë e llojit truall me sipërfaqe 672 m², pjesë e truallit prej 3,800 m² të mbetur në pronësi të saj, ndodhur në Sh , Durrës, për vlerën 1,000,000 lekë.

***, datë 24.3.1994; (iv) kontratë shitjeje trualli nr. ***, datë 26.1.1995; (v) dëshmi trashëgimie ligjore nr. ***, datë 13.5.2015.

¹⁰² Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

¹⁰³ Kontratë shitjeje trualli nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.1995, redaktuar nga noteri publik, z. A.T .

¹⁰⁴ Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.1.1997, redaktuar nga noteri publik, z. A.T .

¹⁰⁵ Kontratë shitjeje trualli nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.1997, redaktuar nga noteri publik, z. A.T .

65.4.1 Pas realizimit të kësaj shitjeje, në emër të nënës së subjektit, znj. F.Ç , mbetet në pronësi pasuria e llojit truall me sipërfaqe 3,128 m², ndodhur në Sh , Durrës.

65.5 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 13.5.2015, noteri publik, znj. G.B, ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore¹⁰⁶ për shtetasen F.Ç , duke përcaktuar trashëgimtar të vetëm të saj të radhës së parë djalin Gëzim Çopa.

65.6 Bazuar në dëshminë e sipërcituar, në emër të subjektit figuron të jetë e regjistruar pasuria e llojit truall me sipërfaqe 3,128 m², nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, ndodhur në Sh , Durrës, për të cilën në datën 8.7.2015 është lëshuar dokumenti certifikatë për vërtetim pronësie, me nr. serial ***.

66. Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

67. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit apartament banimi më sipërfaqe 150.9 m², ndarë në dy apartamente, si dhe tre garazhe, dy prej të cilëve me sipërfaqe 21 m² dhe njëri me sipërfaqe 20 m², pasuri këto të ndodhura në rrugën “**” (ish-Rruga “****”), Tiranë, me vlerë totale 142,000 euro. Ka referuar kontratën e shitjes datë 4.3.2013. Gjithashtu, në deklarinë e tij, në dukje duke iu referuar apartamentit, ka sqaruar se kjo pasuri është prenotuar që në janar të vitit 2008, deklaruar më parë bashkë me ambientet e përbashkëta me sipërfaqe 174 m², saktësuar çmimi dhe sipërfaqet me kontratat e shitblerjes¹⁰⁷.**

67.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga kredia e marrë në E Bank, në shumën 40,000 euro; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e kalçetos me sipërfaqe 648 m², në fshatin Sh , Rr, Durrës, në shumën 95,000 euro; (iii) shumën prej 7,000 euro nga shitja e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m², në vlerën 210,000 euro (kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2013).

67.2 Gjithashtu, në deklarinë e bërë subjekti ka referuar kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.11.2005, në vlerën 3,000,000 lekë. Por, nga ana tjetër, sqaron se kjo shumë është vlera fillestare kur për kalçeton sapo ishte nisur ndërtimi dhe nuk kishin ardhur pjesët kompletuese të saj, të cilat janë sjellë dhe montuar nga kompania “****” në 6-mujorin e parë të vitit 2006. Shitur blerësve 95,000 euro, shuma e likuiduar nga blerësit gjatë vitit 2006. Në vijim, subjekti ka deklaruar se është investuar prej tij oferta e kompanisë prej 47,000 euro dhe se fitimi i tij është diferenca e shumës prej 95,000 euro me vlerën prej 47,000 euro. Si burim të investimit të deklaruar prej 47,000 euro, subjekti ka referuar të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e shtëpisë në favor të shoqërisë “**** ” dhe puna e kryer prej tij për këtë shoqëri për periudhën nëntor 1998 – tetor 2003.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

67.3 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit¹⁰⁸, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit apartament banimi me sipërfaqe 174 m² dhe dy garazhe,

¹⁰⁶ Dokumenti noterial dëshmi trashëgimie ligjore nr. *** rep., *** kol., datë 13.5.2015.

¹⁰⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 19.2.2015; (ii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.3.2013; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 19.2.2015; (iv) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.3.2013; (v) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 19.2.2015; (vi) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.3.2013; (vii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 19.2.2015; (viii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.3.2013; (ix) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 19.2.2015; (x) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.3.2013; (xi) kontratë huaje nr. ***, datë 6.10.2008, me E Bank; (xii) kontratë shitjeje tokë arë nr. ***, datë 5.11.2005; (xiii) deklaratë të datës 10.10.2016 nga shoqëria “****” sh.p.k., shoqëruar me dokumentin fletë ofertë; (xiv) deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2017.

¹⁰⁸ Në atë periudhë me funksion ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI.

ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, blerë në vitin 2008 në shumën 133,000 euro, me kontratë sipërmarrjeje të përfunduar, por e pahipotekuar, paguar 130,000 euro.

67.3.1 Duket se në rubrikën ku shënohet vlera e kësaj pasurie me numra është shënuar shuma 130,000 euro (të cilën duket se subjekti e referon si vlerë të paguar deri në momentin e deklarimit), ndërsa me fjalë referohet shuma 148,000 euro.

67.3.2 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) kredinë e marrë në E Bank në shumën 35,000 euro; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së llojit tokë arë me sipërfaqe 2,717 m², në të cilën është edhe fusha e minifutbollit dhe lokali me sipërfaqe 1,400 m², në shumën 95,000 euro.

67.3.3 Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: (i) shumën 5,000 euro si detyrim të papaguar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit të banimit në rrugën “****”, Tiranë, shumë për të cilën referon se do të paguhet në momentin e hipotekimit; (ii) kredinë e marrë në E Bank në datën 6.10.2008, në shumën 40,000 euro.

67.4 Në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e deklarimit të pasurive, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se nga deklarimi i një viti më parë shtohet kontrata paraprake me shoqërinë “****” sh.p.k., e bërë në tetor të vitit 2009, për blerjen e një garazhi në pallatin ku ka edhe apartamentin me sipërfaqe 21.2 m², me vlerë 18,000 euro. Deklaron se ka paguar 8,000 euro, me burim 3,000 euro nga paga dhe 5,000 euro nga mbyllja e llogarisë në Raiffeisen Bank.

67.4.1 Ndërsa, në seksionin e detyrimeve financiare të kësaj deklarate, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: (i) detyrim financiar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., për blerjen e garazhit, në shumën 10,000 euro; (ii) shlyerje tek shoqëria “****” sh.p.k., në shumën 3,000 euro.

67.5 Në DIPP-në e vitit 2010, në lidhje me kredinë e marrë në E Bank në dhjetor të vitit 2008, subjekti ka deklaruar se me kërkesën e tij banka shtoi në kredi shumën 5,000 euro. Pra, kjo kredi në total është 45,000 euro.

67.5.1 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje, Komisioni konstaton se ABI Bank (ish-E Bank) nuk konfirmon disbursimin në favor të subjekti dhe/apo personit të lidhur të shumës prej 5,000 euro si kredi.

67.6 Në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin e detyrimeve financiare, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se ka shlyer detyrimin ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., për garazhin e deklaruar më parë në rrugën “****”, ***, në shumën 10,000 euro.

67.7 Nga verifikimi i deklaratës së interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), duket se subjekti i rivlerësimit¹⁰⁹ ka të njëjtin deklarim mbi pasurinë objekt vlerësimi, sikurse deklarimi i bërë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, evidentuar si më sipër.

Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

67.8 Mospërputhje të të dhënave të pasurive në rrugën “****” (***) Tiranë, sa i përket sipërfaqes së apartamenteve, numrit të garazheve, vlerës, kohës së pagimit dhe shumës së kredisë së marrë, deklaruar nga subjekti në deklaratimet deri në vitin 2014 në ILDKPKI, krahasuar me deklarimin *Vetting*, për të cilat subjekti shprehet se janë saktësuar në kontratat e blerjes.

67.9 Nuk është e qartë nëse blerësit e pasurisë tokë arë të kthyer truall me sipërfaqe 2,173 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 1,400 m² në Rr , Durrës, në periudhën 2005 – 2006, kanë likuiduar detyrimet tatimore për diferencën e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, e cila sipas kontratës rezulton 3,000,000 lekë, ndërsa referuar deklaratës noteriale është në total 95,000 euro, ose me një shtesë prej 70,000 euro.

¹⁰⁹ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

67.10 Mungesë e një kontrate shtesë për çmimin 70,000 euro si diferencë, apo e një kontrate përfundimtare shitjeje gjithëpërfshirëse, me çmim 95,000 euro, për pasurinë e sipërcituar. Në deklaratën para fillimit të detyrës 2005, subjekti ka deklaruar tokë me sipërfaqe 12,000 m², të përfituar nga ligji nr. 7501 dhe nuk është shprehur për fushë minifutbolli apo lokal.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

68. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Tiranë, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri¹¹⁰, Komisioni konstaton se:

68.1 Në datën 1.8.2008, mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës porositëse, dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e palës sipërmarrëse, nënshkruhet kontrata e sipërmarrjes¹¹¹, me objekt porositjen e 2 apartamenteve dhe 2 garazheve, të ndodhura në objektin që po ndërtonte kjo shoqëri në rrugën “****”, Tiranë, e më konkretisht për pasuritë: (i) apartament nr. ***, me përbërje 2+1, me sipërfaqe 88.2 m², ndodhur në katin e *** teknik në seksionin ***; (ii) apartament nr. ***, me përbërje 2+1, me sipërfaqe 88 m², ndodhur në katin e dytë teknik në seksionin ***; (iii) garazh nr. ***; (iv) garazh nr. ***, ku të dy garazhet ndodhen ngjitur me njëri-tjetrin.

68.1.2 Në këtë kontratë palët kanë dakordësuar që dy apartamentet do të shiten/blihen kundrejt çmimit 670 euro/m². Pra, referuar çmimit të dakordësuar, apartamenti nr. *** me sipërfaqe 88.2 m², në vlerën 59,094 euro, ndërsa apartamenti nr.*** me sipërfaqe 88 m², kundrejt vlerës 58,960 euro, në total të dy apartamentet për shumën 118,054 euro. Ndërsa për garazhet është dakordësuar çmimi prej 15,500 euro për secilin, në total vlera e dy garazheve në shumën 31,000 euro.

68.1.3 Referuar kontratës së sipërmarrjes, çmimi total i këtyre pasurive (2 apartamenteve dhe 2 garazheve) është në shumën 149,054 euro.

68.1.4 Ndërsa, plani i pagesave është përcaktuar si vijon: (i) kësti i parë në shumën 74,319 euro është paguar nga pala porositëse kundrejt palës sipërmarrëse jashtë zyrës noteriale; (ii) kësti i dytë në shumën 30,000 euro do të paguhet në fund të muajit korrik 2008; (iii) kësti i tretë dhe i fundit në shumën 44,735 euro do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit me çelësa në dorë.

68.1.5 Komisioni konstaton se në DIPPF-në e vitit 2009, subjekti nuk ka deklaruar saktë vlerën totale të dy pasurive të llojit apartament dhe dy pasurive të llojit garazh. Gjithashtu, duket se nuk ka deklaruar saktë detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë “**** ” sh.p.k.

68.1.6 I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja¹¹², subjekti ka konfirmuar se vlera e këtyre pasurive në total është 149,054 euro, duke sqaruar se në DIPPF-në e vitit 2009 ka deklaruar se ka shlyer vlerën 130,000 euro dhe se pjesa tjetër ka qenë detyrim i mbetur ndaj shoqërisë “**** ” sh.p.k.

68.2 Në datën 4.3.2013, mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse, dhe shoqërisë “**** ” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse, është nënshkruar kontrata e shitblerjes¹¹³, me objekt pasurinë e llojit apartament banimi nr. ***, me sipërfaqe 75.5 m², të ndodhur në katin e dytë të godinës 6-7-katëshe, shkalla ***, ***, Tiranë (pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***), për çmimin 8,260,000 lekë, vlerë e cila deklarohet nga palët se është likuiduar në vitin 2008, kur është bërë prenotimi i kësaj pasurie.

¹¹⁰ Shkresë e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri me nr. *** prot., datë 8.3.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.3.2021).

¹¹¹ Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2008, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Ll.

¹¹² Referojuni dokumentit procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, i datës 11.2.2015, në shkresën kthim përgjigjeje dërguar nga ILDKPKI-ja me nr. *** prot., datë 26.7.2023.

¹¹³ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.3.2013, redaktuar nga noteri publik, z. Y.Ç .

68.3 Në datën 4.3.2013, mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse, dhe shoqërisë “**** ” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse, është nënshkruar kontrata e shitblerjes¹¹⁴, me objekt pasurinë e llojit apartament banimi nr. ***, me sipërfaqe 75.4 m², të ndodhur në katin e dytë të godinës 6-7-katëshe, shkalla ***, ***, Tiranë (pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***), për çmimin 8,260,000 lekë, vlerë e cila deklarohet nga palët se është likuiduar në vitin 2008, kur është bërë prenotimi i kësaj pasurie.

68.4 Në datën 4.3.2013, mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse, dhe shoqërisë “**** ” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse, është nënshkruar kontrata e shitblerjes¹¹⁵, me objekt pasurinë e llojit garazh nr. ***, me sipërfaqe 21 m², të ndodhur në katin -1 nëntokë të godinës 6-7-katëshe, në ***, Tiranë (pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***), për çmimin 1,080,000 lekë, vlerë e cila deklarohet nga palët se është likuiduar në vitin 2008, kur është bërë prenotimi i kësaj pasurie.

68.5 Në datën 4.3.2013, mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse, dhe shoqërisë “**** ” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse, është nënshkruar kontrata e shitblerjes¹¹⁶, me objekt pasurinë e llojit garazh nr. ***, me sipërfaqe 20 m², të ndodhur në katin -1 nëntokë të godinës 6-7-katëshe, në ***, Tiranë (pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***), për çmimin 1,080,000 lekë, vlerë e cila deklarohet nga palët se është likuiduar në vitin 2008, kur është bërë prenotimi i kësaj pasurie.

68.6 Në datën 4.3.2013, mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse, dhe shoqërisë “**** ” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse, është nënshkruar kontrata e shitblerjes¹¹⁷, me objekt pasurinë e llojit garazh nr. ***, me sipërfaqe 21 m², të ndodhur në katin -1 nëntokë të godinës 6-7-katëshe, në ***, Tiranë (pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***), për çmimin 1,260,000 lekë, vlerë e cila deklarohet nga palët se është likuiduar në vitin 2008, kur është bërë prenotimi i kësaj pasurie.

69. Referuar vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti, duket se garazhi nr. *** përfaqëson pasurinë e prenotuar prej tij në vitin 2009, deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 me vlerë 18,000 euro.

70. Pasi Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë kontratën e sipërmarrjes për pasurinë e llojit garazh të deklaruar në DIPP-në e vitit 2009¹¹⁸ (garazhi i tretë i referuar si i porositur te shoqëria “**** ” sh.p.k.), subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se *ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2008, për dy apartamente banimi, ap. ***, në shumën 59,094 euro dhe ap. ***, në shumën 58,960 euro, si dhe për dy garazhe, secili nga 15,500 euro, pra të dy bashkë 31,000 euro. Vlera totale e dy apartamenteve dhe dy garazheve ishte 149,054 euro... Kujton që në atë kohë kur është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes, pallati që po ndërtohte shoqëria “**** ” sh.p.k. ishte në fazën e karabinasë, ishin ndërtuar muret e jashtme dhe po punohej brenda objektit. Për kushtet familjare që kishte në atë periudhë (bashkëjetonte me bashkëshorten, tre djemtë dhe nënën, për të krijuar kushte më të përshtatshme të banimit (nënës i përgatiti dhomë me banjë më vete), i kërkoi shoqërisë “**** ” sh.p.k., që dy muret e brendshme të ndarjes së kuzhinës me aneksin të mos bëheshin, të mos bëhej mbyllja me vetratë e ballkoneve dhe që ai privatisht të shtronte pllakat dhe të vendoste pajisjet e banjës tek dhoma që kishin planifikuar të qëndronte nëna ime. Pasi ranë dakord për punimet që ai do të kryente privatisht dhe për ato që nuk do t’i kryente shoqëria, në zbatim të projektit fillestar, u dakordësuan që vlerën totale që ai do të paguante për dy apartamentet dhe dy garazhet të ishte 142,000 euro... Garazhet e ndërtuara nga shoqëria “**** ” janë të hapura, pra pa mure rrethues e pa qepena mbyllës. Në kohën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, në ambientet e garazhit kishte materiale ndërtimi të apartamentit që po ndërtohej dhe nuk mund*

¹¹⁴ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.3.2013, redaktuar nga noteri publik, z. Y.Ç .

¹¹⁵ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.3.2013, redaktuar nga noteri publik, z. Y.Ç .

¹¹⁶ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.3.2013, redaktuar nga noteri publik, z. Y.Ç .

¹¹⁷ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.3.2013, redaktuar nga noteri publik, z. Y.Ç .

¹¹⁸ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ****, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

të shikoheshin saktësisht pozicioni dhe përmasat e garazheve që ai kishte porositur. Në fillim të vitit 2019 (duket se kemi të bëjmë me lapsus, duke supozuar se ka dashur t'i referohet vitit 2009), pasi merr edhe projektin e garazheve, vë re se në njërin garazh i kufizuar nga katër kolonat e betonit, për të cilin me shoqërinë kishte nënshkruar kontratën e sipërmarrjes, ishin skicuar në projekt, dy garazhe. Për pozicionin e gjendur të këtij garazhi ishte e pamundur që në të të parkoheshin dy automjete, të çfarëdo madhësie qofshin. Këtë fakt ia bën prezent administratorit të shoqërisë, me të cilin ranë dakord që, për efekt të projektit të ndërtimit, do të shënohej që kishte porositur dy apartamente dhe tre garazhe, por vlera e blerjes nuk do të ndryshonte. Pra, do të ishte 142,000 euro. Këtë fakt do ta pasqyrojnë në një aktmarrëveshje të mëvonshme, të cilën e kanë përgatitur në 21 tetor 2009. Në aktmarrëveshjen në fjalë, përveç atyre të lartshënuara, rakorduan edhe faktin se deri në atë datë i kishte likuiduar shoqërisë shumën prej 124,000 euro dhe se kishte për t'i likuiduar edhe shumën prej 18,000 euro, shumë të cilën duhet ta likuidonte deri para momentit të nënshkrimit të kontratës së shitblerjes me këtë shoqëri¹¹⁹.

71. ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri¹²⁰ konfirmon se të gjitha këto pasuri (2 apartamentet dhe 3 garazhet) figurojnë të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa.

72. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur specifikisht nga Komisioni¹²¹ në lidhje çmimin e paguar për blerjen e këtyre pasurive, shlyerjen e kësteve dhe mënyrën e kryerjes së pagesave në favor të shoqërisë “*** ” sh.p.k., duke i kërkuar të evidentojë çdo pagesë më vete, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se deri në datën 21.10.2009 ka paguar shumën 124,000 euro, ndërsa për shumën 18,000 euro dakordësuan që do të paguhej para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Ka specifikuar se në datën 5.6.2008, shoqërisë “****” sh.p.k. i ka shlyer me transfertë bankare shumën 9,000,000 lekë, që me kursin e kohës ishin 74,000 euro, dhe se në datën 3.11.2008 i ka likuiduar shumën 30,000 euro, këto nga kredia e marrë në E Bank, sot ABI Bank. Për pjesën tjetër të shumës totale prej 142,000 euro, deklaroi se e ka likuiduar *cash*, duke mos evidentuar datën/datat e kryerjes së pagesës/pagesave.

73. Komisioni konstaton se subjekti ka bërë deklarime kontradiktore në lidhje me çmimin total të paguar dhe momentin e kryerjes së pagesave për blerjen e dy apartamenteve dhe tre garazheve. Gjithashtu, duket se nuk përputhet deklarimi i bërë mbi vlerën totale të këtyre pasurive me vlerën e shënuar në kontratën e sipërmarrjes për 4 pasuri dhe në DIPP-në e vitit 2009 për një pasuri, si dhe me vlerën e tyre të përcaktuar në kontratat e shitblerjes.

74. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vetëdeklarimet e bëra ndër vite në ILDKPKI, duket se çmimi total për blerjen e këtyre pasurive është në shumën 167,054 euro, e përbërë nga shuma 149,054 euro sipas përcaktimit në kontratën e porositjes së 4 pasurive (2 apartamente + 2 garazhe) të datës 1.8.2008 dhe shuma 18,000 euro sipas deklarimit të bërë në DIPP-në e vitit 2009, e cila referon çmimin e blerjes së një pasurie të llojit garazh. Në lidhje me likuidimin e çmimit të blerjes së 5 pasurive të sipërcituara në favor të shoqërisë “*** ” sh.p.k., duket se: (i) deri në datën 19.1.2009 subjekti ka paguar shumën 144,054 euro¹²²; (ii) për

¹¹⁹ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, subjekti ka depozituar dokumentin aktmarrëveshje (shkresë e thjeshtë), që mban datën 21.10.2009, në dukje nënshkruar mes tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori, z. D.R.

¹²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.3.2021).

¹²¹ Pyetësori nr. ***.

¹²² Referuar kontratës së sipërmarrjes datë 1.8.2008, çmimi total për blerjen e 4 pasurive (2 apartamente + 2 garazhe) është 149,054 euro. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit pasi ka deklaruar në seksionin e pasurive kontratën e sipërmarrjes të datës 1.8.2008, në seksionin e detyrimeve financiare ka deklaruar si detyrim të mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 5,000 euro. Për rrjedhojë, duket se deri në datën 19.1.2008 subjekti ka paguar shumën 144,054 euro.

periudhën 20.1.2009 – 31.12.2009, subjekti ka paguar shumën 13,000 euro¹²³; (iii) për periudhën 1.1.2013 – 4.3.2013 ka paguar shumën 10,000 euro¹²⁴.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas rezultateve të hetimit

75. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka parashtuar se në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht vlerën e plotë të çmimit të apartamentit të banimit së bashku me vlerën e garazheve. Në vijim, deklaroi se fillimisht me shoqërinë “*** ” sh.p.k. ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2008, për dy apartamente banimi dhe dy garazhe, dhe se vlera totale e këtyre pasurive ishte 149,054 euro. Kujton se në atë kohë, kur është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes, pallati që po ndërtohej shoqëria “*** ” sh.p.k. ishte në fazën e karabinasë, ishin ndërtuar muret e jashtme dhe po punohej brenda objektit. Deklaroi se ka rënë dakord me shoqërinë ndërtuese që disa punime do t’i kryente privatisht dhe për ato që nuk do t’i kryente as shoqëria, në zbatim të projektit fillestar, u dakordësuan që vlerën totale që do të paguante për dy apartamentet dhe dy garazhet të ishte 142,000 euro.

75.1 Në vijim të prapësimeve të tij, referon se në fillim të vitit 2009, pasi ka marrë projektin e garazheve, vë re se në njërin prej tyre, i kufizuar nga katër kolonat e betonit, për të cilin me shoqërinë kishin nënshkruar kontratën e sipërmarrjes, ishin skicuar në projekt dy garazhe. Për pozicionin e gjendur të këtij garazhi, ishte e pamundur që në të të parkoheshin dy automjete, të çfarëdo madhësie qofshin. Këtë fakt ia bën prezent administratorit të shoqërisë, me të cilin ranë dakord që, për efekt të projektit të ndërtimit, do të shënohej që kishte porositur dy apartamente dhe tre garazhe, por vlera e blerjes nuk do të ndryshonte. Pra, do të ishte 142,000 euro. Këtë fakt do ta pasqyronin në aktmarrëveshjen e mëvonshme, të cilën e kanë përgatitur në datën 21.10.2009. Në aktmarrëveshjen në fjalë, përveç atyre të sipërshënuara, rakorduan edhe faktin se deri në atë datë i kishte likuiduar shoqërisë shumën 124,000 euro dhe se kishte për t’i likuiduar edhe shumën e mbetur prej 18,000 euro, të cilën duhet ta likuidonte deri para momentit të nënshkrimit të kontratës së shitblerjes me këtë shoqëri.

75.2 Subjekti ka evidentuar faktin se shoqërisë “*** ” sh.p.k. i ka shlyer me transfertë bankare, në datën 5.6.2008, shumën 9,000,000 lekë, që me kursin e kohës ishin 74,000 euro dhe në datën 3.11.2008 i ka likuiduar shumën 30,000 euro, nga kredia e marrë në E Bank (sot ABI Bank). Pjesën tjetër të shumës totale prej 142,000 euro ia ka likuiduar *cash* kësaj shoqërie.

75.3 Lidhur me katin e konstatuar se vlera fillestare e pasurisë e përcaktuar me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2008, për dy apartamente banimi dhe dy garazhe, në shumën 149,054 euro, dhe ajo e dakordësuar me shoqërinë ndërtuese për vlerën 142,000 euro, nuk përbën deklaram jo të saktë, por është deklarimi i saktë i një aktmarrëveshjeje të lidhur mes palëve. Subjekti ka referuar se vlera totale e këtyre 5 pasurive (kjo sipas edhe kontratës së shitblerjes përkatëse për çdo pasuri, të datës 4 mars), të likuiduara prej tij në cilësinë e blerësit, është 19,940,000 lekë, që përkon me vlerën 142,000 euro, që është vlera përfundimtare e dakordësuar mes palëve, fakt i cili është deklaruar saktësisht në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), e cila është

¹²³ Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti deklaroi prenotimin e një garazhi nga shoqëria “***” sh.p.k., në shumën 18,000 euro, duke referuar se ka paguar shumën 8,000 euro dhe i ka mbetur si detyrim pa shlyer shuma 10,000 euro. Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar shlyerje detyrimi ndaj shoqërisë “***” sh.p.k. shumën prej 3,000 euro, në dukje lidhur me pasuritë e prenotuara në vitin 2008 – duke mos evidentuar detyrim të mbetur ndaj kësaj shoqërie. Për rrjedhojë, Komisioni paraprakisht vlerëson se gjatë vitit 2009 është shlyer tërësisht shuma 5,000 euro, e deklaruar si detyrim financiar në DIPPFD-në e vitit 2009. Pra, duket se për periudhën 20.1.2009 – 31.12.2009 subjekti ka paguar shumën 13,000 euro.

¹²⁴ Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar shlyerjen e çmimit prej 10,000 euro në favor të shoqërisë “***” sh.p.k. Nga ana tjetër, rezulton se kontratat e shitjes me këtë shoqëri janë nënshkruar në datën 4.3.2013. Për rrjedhojë, në kushtet kur edhe vetë subjekti ka referuar shlyerjen totale të çmimit para nënshkrimit të kontratave të shitblerjes së këtyre pasurive, duket se për periudhën 1.1.2013 – 4.3.2013 subjekti ka paguar shumën 10,000 euro.

deklarata e parë që përfshin periudhën e tij të rivlerësimit, pasi deklaramet e mëparshme lidhen me një funksion tjetër të tij, i njëjtë ky me deklaramin e tij mbi këtë pasuri në deklaratën *Vetting*.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

76. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti lidhur me pasaktësitë dhe/apo mospërputhjet e konstatuara në deklaramet e tij, si dhe mbi rezultatin e Komisionit në lidhje me planin e pagesave dhe periudhën e kryerjes së tyre në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., në funksion të shlyerjes së çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, trupi gjykues nuk i gjen bindëse ato, duke çmuar se qëndrojnë gjetjet mbi pasaktësitë dhe mospërputhjet në deklaramet e subjektit, pesha e të cilave për efekt të këtij procesi do të vlerësohet në raport me analizën përfundimtare financiare të kryer për mundësinë e shlyerjes së çmimit të plotë të pasurisë objekt vlerësimi. Për rrjedhojë, vlen të evidentohet këtu se analiza financiare përfundimtare do të kryhet referuar planit të pagesave të paraqitura nga Komisioni me rezultatet e hetimit administrativ – të referuar si më sipër.

Analiza dhe verifikimi i të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe/apo personit të lidhur, të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie

77. Sikurse u evidentua edhe më sipër, duket se subjekti ka deklaruar se si burim krijimi të kësaj pasurie kanë shërbyer: (i) të ardhurat e përfituara nga kredia në E Bank, në shumën 40,000 euro; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e kalçetos dhe e tokës me sipërfaqe 648 m², në fshatin Sh, Rr, Durrës, në shumën 95,000 euro; (iii) shuma 7,000 euro nga shitja e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m², në janar të vitit 2013.

Shuma 40,000 euro, përfitur nga kredia bankare

78. Nga verifikimi i informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga ABI Bank (ish-E Bank)¹²⁵ dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti bashkëlidhur në deklaratën e rivlerësimit kalimtar¹²⁶, konfirmohet se në datën 6.10.2008 subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e huamarrësit, dhe personi i lidhur, znj. F.Ç , në cilësinë e dorëzanëses, kanë lidhur kontratën e huas¹²⁷, në të cilën përcaktohet se banka i jep kredimarrësve një kredi në shumën 40,000 euro, për një periudhë prej 240 muajsh (20 vite), me objekt shlyerjen e çmimit të apartamenteve nr. *** me sipërfaqe 88.2 m² dhe nr. *** me sipërfaqe 88 m², si dhe garazheve nr. *** dhe nr. **, të ndodhura në **, në përputhje me kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. ** kol., datë 1.8.2008, lidhur prej huamarrësit me shoqërinë “***” sh.p.k.

78.1 Për garantimin e shlyerjes së kësaj kredie është vendosur si kolateral pasuria e llojit tokë pemëtoare + truall me nr. pasurie **, me sipërfaqe totale 3,682 m², nga të cilat 300 m² truall dhe 56 m² ndërtesë, volum **, faqe **, z. k. **, ndodhur në Sh , Durrës, e blerë nga subjekti në datën 14.11.2002, në shumën 480,000 lekë, vlerësuar nga banka në vlerën 154,200 euro. Në kontratën e hipotekës¹²⁸ të lidhur midis subjektit dhe E Bank (sot ABI Bank) referohet se kredia e cila sigurohet është shuma totale prej 45,000 euro, që banka i ka dhënë kredimarrësit në formën e huas me afat¹²⁹ dhe të shumës që do t’i japë kredimarrësit në formën e kredisë konsumatore me afat 4-vjeçar, me normë interesi 12 muaj euribor + marzhi prej 6%, të cilat garantohen me këtë kontratë.

78.2 Rezulton se, në datën 31.10.2008, në llogarinë bankare të subjektit pranë ABI Bank (ish-E Bank) janë disbursuar fondet e kredisë në shumën 40,000 euro, të përfituara sipas kontratës së huas bankare datë 6.8.2008, me objekt për blerje pasurie. Në vijim të verifikimit të kësaj

¹²⁵ Shkresë e ABI Bank (ish-E Bank) nr. **, datë 27.1.2021 (protokolluar në Komision me nr. ** prot., datë 2.2.2021).

¹²⁶ Shihni aneksin nr. ** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹²⁷ Kontratë huaje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 6.10.2008, redaktuar nga noteri publik, znj. L.K .

¹²⁸ Kontratë hipoteke nr. ** rep., nr. ** kol., datë 6.10.2008, redaktuar nga noteri publik, znj. L.K .

¹²⁹ I referohet kontratës së kredisë në shumën 40,000 euro, të lidhur midis palëve brenda së njëjtës datë, me objekt blerjen 4 pasurive të paluajtshme, 2 apartamente dhe 2 garazhe.

llogarie, konstatohet se në datën 3.11.2008 është transferuar shuma 30,000 euro, në dukje në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Transfertë për “****” sh.p.k.”. Komisioni konstaton se në datën 6.11.2008 subjekti ka tërhequr *cash* shumën 9,000 euro nga kjo llogari, pjesë e fondeve të kredisë. Ndërsa, vlera prej rreth 1,000 euro duket se është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të disbursimit të kredisë.

Të ardhura nga shitja e ambienteve të fushës së minifutbollit dhe tokës që lidhet me të

79. Nga verifikimi i dokumentacionit shkresor të administruar në dosje, Komisioni konstaton se në nëntor të vitit 2005 subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë shitur¹³⁰ pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 2,173 m², i kthyer në truall, brenda së cilës ndodhet një ndërtesë me sipërfaqe 1,400 m² (pasuria nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***), për shumën 3,000,000 lekë.

79.1 Referuar dokumentit kartelë e pasurisë së paluajtshme, duket se toka bujqësore e shndërruar më vonë në truall ka qenë fillimisht e regjistruar si pronë shtet (regjistruar në datën 20.3.1998). Po në referim të kartelës, rezulton se në datën 16.9.2003 kjo tokë është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin “R.Fill D.Trash”, pra në dukje “regjistrim fillestar, dëshmi trashëgimie”.

80. I pyetur nga Komisioni¹³¹ mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se është përfituara nga familja e tij në bazë të ligjit “Për tokën”.

81. Pas verifikimit të AMPT-së nr. ***, datë 20.1.1997, duket se pasuria nr. *** nuk referohet në këtë akt. Nga ana tjetër, pasi u ballafaquan të gjitha pasuritë e referuara në AMTP-në nr. *** me ato të deklaruara nga subjekti dhe të tjetërsuara ndër vite me burim nga ligji nr. 7501, “Për tokën”, duket se pasuria nr. ***, me vendndodhje te “S”, e llojit tokë arë me sipërfaqe 1,900 m², kufizuar: veri: kanal; lindje: M.Gj; jug: S. D dhe perëndim: rrugë fshati, nuk gjen vend në deklaratimet e subjektit dhe as në pasuritë e tjetërsuara prej tij.

82. Komisioni konstaton se, i pyetur më parë nga ILDKPKI-ja¹³², subjekti ka referuar se kjo tokë është pjesë e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi me ligjin nr. 7501, përkatësisht me emërtimin “serat”, me sipërfaqe 1,900 m². Pas azhornimit në ZVRPP-në Durrës, sipërfaqja e kësaj parcele rezultoi 2,173 m².

83. Bazuar në deklaratimet e subjektit, por edhe pas verifikimit të bërë nga Komisioni, mbi vendndodhjen e kësaj pasurie dhe kufizimet e saj në geoportalin “ASIG”, duket se kemi të bëjmë me pasurinë me emërtimin “Serat”, të referuar në AMTP-në nr. ***, datë 20.1.1997, fillimisht e llojit tokë arë me sipërfaqe 1,900 m².

84. Rezulton se, në datën 6.8.2004, subjekti i rivlerësimit është pajisur me leje ndërtimi nga KRRT-ja e Komunës Rr , për ndërtimin e një objekti banesë 3-kate + fushë minifutbolli. Referuar kësaj lejeje, planimetria e sheshit të ndërtimit ndahet në: (i) ambiente shërbimi me sipërfaqe 210 m²; (ii) fushë minifutbolli me sipërfaqe 720 m²; (iii) fushë tenisi me sipërfaqe 230 m²; (iv) parking dhe rrugë me sipërfaqe 240 m².

84.1 Në deklaratimet e dhëna më parë në ILDKPKI, po ashtu edhe në deklaratimet e bëra gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti pretendon se vlera prej 3,000,000 lekësh, e shënuar në kontratën e shitjes të datës 5.11.2005, përfaqëson vlerën fillestare në momentin e nisjes së investimit, në dukje duke përfaqësuar kryesisht vlerën e truallit dhe referon se në total vlera e shitjes së truallit + investimit ka qenë 95,000 euro, duke pretenduar se prej tij ishte investuar më parë shuma 47,000 euro, për porositjen e pajisjeve të fushës së minifutbollit nga

¹³⁰ Kontratë shitjeje tokë arë nr. *** kol., datë 5.11.2005, redaktuar nga noteri publik, z. F.H .

¹³¹ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

¹³² Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive, mbajtur në datën 11.2.2015, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2023, të ILDKPKI-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.7.2023).

kompania “****” sh.p.k. Subjekti deklaron se pagesa totale nga pala blerëse është përmbyllur brenda vitit 2006¹³³.

84.2 Nga verifikimi i bërë në burimet e hapura, në fotografimet e “Google Earth Pro” të datës 4.6.2005, duket se mbi këtë pasuri kishte nisur investimi në fushën e minifutbollit dhe ambienteve në funksion të saj.

85. Komisioni konstaton se në deklarinimin e bërë në ILDKPKI në datën 30.6.2005, në funksionin e oficerit të policisë gjyqësore, subjekti nuk ka referuar lejen e ndërtimit dhe as ndonjë investim të kryer që lidhet me këtë pasuri.

86. Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin shkresor të administruar në dosje dhe deklarinimet e bëra nga subjekti, në analizën financiare paraprake Komisioni reflektoi si vlerë të shpenzuar nga subjekti shumën 47,000 euro dhe si vlerë të përfituar nga shitja e kësaj pasurie shumën 3,000,000 lekë, sipas përcaktimit të bërë në kontratën e shitblerjes. Duket se deri në këtë fazë të hetimit pretendimet e subjektit për përfitimin në total të shumës 95,000 euro nga shitja e kësaj pasurie mbeten kryesisht të karakterit deklarativ. Për më tepër, nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën shtesë të pretenduar si të përfituar nga subjekti në shumën prej rreth 70,000 euro, e cila përfaqëson diferencën e vlerës prej 95,000 euro (si vlerë totale shitjeje të pretenduar) me shumën prej 3,000,000 lekësh (të përcaktuar si çmim në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie).

87. Pasi iu kalua barra e provës mbi këtë konstatim, Komisioni vëren se subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna më parë gjatë hetimit administrativ, pra pretendimit se ka përfituar në total shumën prej rreth 95,000 euro nga transaksioni i kryer për shitjen e tokës dhe pajisjeve të kalçetos, duke evidentuar këtu se më parë ka pas investuar shumën 47,000 euro, me burim të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e tij dhe familjarëve me shoqërinë “****”. Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka referuar të njëjtat prova të cilat i ka paraqitur edhe më parë gjatë hetimit administrativ.

88. Pasi vlerësoi prapësimet e depozituara nga subjekti, trupi gjykues konkludon se ai nuk arriti të provojë bindshëm dhe me dokumentacion justifikues ligjor përfitimin në total të shumës 95,000 euro nga transaksioni i shitjes së truallit dhe pajisjeve të fushës së minifutbollit dhe as pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat shtesë të pretenduara si të përfituara nga ky transaksion. Gjithsesi, në një qasje proporcionale dhe objektive vlerësohet se për efekt analize, për sa kohë është reflektuar si shpenzim shuma e deklaruar si e investuar në vlerën 47,000 euro, minimilaisht do të reflektohet e njëjta shumë si e ardhur e përfituar pas shitjes së investimit të kryer në këtë pasuri, në kushtet kur në këtë rast nuk do t’i nënshtrohej pagesës së tatimit, pasi nuk pranohen të ardhura shtesë të përfituara nga ky transaksion.

Shuma 7,000 euro nga shitja e tokës bujqësore

89. Rezulton se, në datën 4.1.2013, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij i kanë shitur¹³⁴ shoqërisë “****” sh.p.k. pasurinë nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit truall me sipërfaqe 1,750 m², kundrejt çmimit 210,000 euro.

¹³³ Në mbështetje të deklarinimeve të tij, subjekti ka depozituar: (i) deklaratë (shkresë e thjeshtë) të shoqërisë “****” sh.p.k., datë 10.10.2016, në dukje nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, z. A. C; (ii) dokument, me titull “Ofertë”, në dukje i paraqitur nga shoqëria “****” sh.p.k., për artikuj dhe zëra punimesh për ndërtimin e fushës së minifutbollit, me vlerë totale 50,428 euro, oferta e mbyllur në shumën 47,000 euro; (iii) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2017, e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe pala blerëse e pasurisë (truallit, fushës së minifutbollit dhe ambienteve ndihmëse), redaktuar nga noteri publik, z. I.H.

¹³⁴ Kontratë blerjeje trualli nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2013, redaktuar nga noteri publik, z. A.G.

89.1 Nga shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) në DIPP-në e vitit 2012, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, subjekti ka deklaruar llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank në vlerën 21,000 euro, me burim shitjeje tokë truall, kontratë kapari nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2012; (ii) në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, subjekti ka deklaruar shitjen e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m² (përfituar me ligjin nr. 7501, “Për tokën”), në vlerën 210,000 euro.

89.2 Pas verifikimit të dokumentacionit bankar të dërguar nga Intesa Sanpaolo Bank¹³⁵, rezulton se, në datën 26.11.2012, në llogarinë e subjektit në monedhën euro (nr. llogarisë ***) kreditohet shuma 21,000 euro, me përshkrimin “****” sh.p.k., për Gëzim Sh.Çopa për blerje toke”. Në datën 7.12.2012, subjekti tërheq shumën 1,000 euro nga kjo llogari dhe, për rrjedhojë, gjendja e saj në datën 31.12.2012 është në shumën 20,000 euro. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie, rezulton se në datën 4.1.2013 kreditohet shuma 189,000 euro, me përshkrimin “****” sh.p.k., për Gëzim Sh.Çopa blerje toke”.

89.3 Komisioni konstaton se, përpara nënshkrimit të kontratave të shitblerjes të pasurive objekt vlerësimi (datë 4.3.2013), subjekti ka kryer disa tërheqje në vlera të konsiderueshme nga kjo llogari, në total shumën 51,000 euro.

90. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe dokumentacionin e administruar në dosje në këtë kuadër, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesave: (i) në shumën 144,054 euro deri në datën 19.1.2009; (ii) në shumën 13,000 euro, për periudhën 20.1.2009 – 31.12.2009; (iii) në shumën 10,000 euro, për periudhën 1.1.2013 – 4.3.2013, për shlyerjen e çmimit të blerjes së dy apartamenteve dhe tre garazheve, të ndodhura në ***, Tiranë, të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

¹³⁵ Shkresë e Intesa Sanpaolo Bank nr. *** prot., datë 11.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.2.2021).

Tabela nr. 3

Analiza financiare për evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesave për likuidimin e çmimit të blerjes së 2 apartamenteve dhe 3 garazheve, në Tiranë (vlerat në lekë)	1.7.2005 – 19.1.2009	20.1.2009 – 31.12.2009	1.1.2013 – 4.3.2013
A) Pasuri	29 394 340	1 243 626	26 891 286
Pasuria e llojit tokë pemëtoare + truall me sipërfaqe totale 3,682 m ² (investim i kryer)	180 000		
Pasuri e llojit tokë arë me sip. 2,000 m ²	1 950 000		
Pasuri e llojit tokë arë me sip. 2,173 m ² (investim i kryer)	6 042 233		
2 apartamente + 2 garazhe, Tiranë	17 744 932	615 913	294 000
Garazh me sip. 21 m ²	0	1 097 360	1 402 100
Automjet i llojit “****”, tip “****”	500 000		
Automjet i llojit “****”, tip “****”	0		2 804 200
Ndryshim likuiditeti	2 977 175	-469 646	22 390 986
B) Detyrime	5 646 213	1 371 700	0
Detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë “**** ”	615 913	1 371 700	
Kredi pranë Raiffeisen Bank (***)	103 000		
Kredi pranë ABI Bank (Emporiki Bank)	4 927 300		
C) Pasuri neto (A-B)	23 748 127	-128 074	26 891 286
D) Të ardhura	35 060 512	3 225 482	28 244 029
Të ardhura nga paga e subjektit	2 110 534	1 180 044	313 832
Të ardhura nga paga e bashkëshortes së subjektit	3 678 019	1 150 537	124 236
Të ardhura të mundshme të kursyera nga familja Çopa, deri në datën 1.7.2005.	8 590 717		
Të ardhura nga shitja e pasurisë së llojit tokë truall me sip. 2,173 m ² dhe godinë me sip. 1,400 m ² , me nr. ***, në Sh , Durrës, datë 5.11.2005.	3 000 000		
Të ardhura nga shitja e investimit (pajisjeve të fushës së minifutbollit)	6,042,233		
Të ardhura nga shitja e pasurisë së llojit tokë arë me sip. 1,462 m ² , me nr. ***	10 000 000		
Të ardhura nga shitja e pasurisë së llojit tokë truall me sip. 1,750 m ²	0		26 460 000
Të ardhura nga shitja e automjetit të llojit “****”, tip “****”	200 000		
Të ardhura nga interesat e bonove të thesarit në BOA	465 941	583 312	1 345 961
Të ardhura nga interesat e depozitës në Raiffeisen Bank	0	122 720	
Të ardhura nga interesat e depozitës në Credins Bank	0	188 869	
Të ardhura nga interesat e depozitës në ISP Bank	973 068		
E) Shpenzime	6 041 180	1 962 062	562 604
Shpenzime jetike subjekti + familja e tij, ku përfshihet edhe nëna e subjektit	2 668 123	777 050	143 729
Shpenzime për kreditë pranë Emporiki Bank (ABI Bank)		475 843	118 477
Shpenzime për kreditë pranë Raiffeisen Bank	125 813		
Shpenzime shkollimi për djalë e subjektit E.Ç	513 610		
Shpenzime shkollimi/jetese për djalë e subjektit R.Ç	575 832	274 340	
Shpenzime shkollimi/jetese për djalë e subjektit B. Ç	304 830		
Shpenzime mobilimi/arredimi	731 500		
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	1 121 472	434 829	300 398
Balanca e fondeve (D-C-E)	5 271 205	1 391 495	790 138

91. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer deri në datën 19.1.2009, për likuidimin e shumës 144,054 euro nga çmimi total i përcaktuar për blerjen e dy apartamenteve dhe dy garazheve nga shoqëria “**** ” sh.p.k., si dhe për kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe/apo të evidentuara deri në këtë datë.

92. Nisur nga ky rezultat i analizës financiare, si dhe bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet e bëra mbi këto pasuri (deklaratimet periodike), të pashoqëruara me mungesë të burimeve financiare, nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të subjektit për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar¹³⁶.

93. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë ullishtë, me sipërfaqe totale 15,166 m², ndodhur në fshatin Sh , Durrës¹³⁷. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka trashëguar këtë pasuri nga nëna e tij, duke cituar dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015. Gjithashtu, në deklaratimin e bërë duket se ka referuar se kjo pasuri është fituar më parë nga nëna e tij sipas vendimit të KKKP-së Durrës.

93.1 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Komisioni konstaton se, në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit¹³⁸, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit tokë ullishtë me sipërfaqe 15,166 m², ndodhur në fshatin Sh , Durrës, përfituar me vendimin e KKKP-së Durrës, trashëguar prej nënës së tij F.Ç (dëshmi trashëgimie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015).

93.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Konfirmohet nga ZVRPP Durrës pasuria e deklaruar tokë ullishtë me sipërfaqe 15,166 m², në Sh , pronë për të cilën nëna e subjektit e ka përfituar me trashëgimi.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

94. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:

94.1 Pas kërkesës së bërë nga nëna e subjektit, znj. F.Ç , në datën 5.2.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur¹³⁹ lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin G.D (ish-bashkëshorti), duke përcaktuar si trashëgimtare ligjore të tij bashkëshorten F.Ç (D), e cila trashëgon të gjithë pasurinë e tij.

94.2 Në datën 20.5.2008, Zyra Rajonale për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Qarku Durrës ka vendosur¹⁴⁰: (a) Njohjen e të drejtës së pronësisë trashëgimtares së subjektit të shpronësuar G.D, për pronën me sipërfaqe 28,000 m², që ndodhet në fshatin Sh , Komuna Rr, Durrës, z. k. ***, me indeks harte ***, me kufij: veri - rrugë; lindje - pasuritë nr. *** dhe ***; jug - pasuria nr. *** (rrugë) dhe pasuria nr. ***; perëndim - pasuritë nr. *** dhe ***; (b) T'i kthejë trashëgimtares së subjektit të shpronësuar G.D, për pronën me sipërfaqe 15,166 m², që

¹³⁶ Referojuni vendimit të Kolegjit të Apelimit nr. 37/2021 (JR).

¹³⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) certifikatë për vërtetimin pronësie nr. ***, datë 8.7.2015; (ii) vendim nr. ***, datë 20.5.2008, të AKKP-së Durrës; (iii) procesverbal i mbajtur në datën 15.9.2008 mes përfaqësuesve të AKKP-së dhe znj. F.Ç (nëna e subjektit); (iv) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 5.2.2003, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të shtetasit G.D (ish-bashkëshort i F.Ç); (v) dëshmi trashëgimie ligjore nr. ***, datë 13.5.2015, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësës F.Ç .

¹³⁸ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

¹³⁹ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 5.2.2003.

¹⁴⁰ Vendim i ZRKKP-së Qarku Durrës nr. ***, datë 20.5.2008 (protokolluar me nr. ***).

ndodhet në fshatin Sh , Komuna Rr , z. k. ****, me indeks harte *** me kufij: veri - rrugë; lindje - pasuritë nr. *** dhe ***; jug - pasuria nr. ***; perëndim-pasuritë nr. ***; (c) Të kompensojë trashëgimtare e subjektit të shpronësuar G.D në një nga format e parashikuara në nenin 11/1 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, i ndryshuar, sipërfaqen prej 10,334 m², që në bazë të nenit 7 të ligjit nr. 9235, i ndryshuar, konsiderohet e zënë; (ç) Të mos i njohë të drejtën e kompensimit trashëgimtares së subjektit të shpronësuar për sipërfaqen prej 2,500 m², e cila është sipërfaqja që trashëgimtarja ka përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

94.3 Në datën 15.9.2008, mes përfaqësuesve të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Durrës dhe nënës së subjektit, znj. F. Ç, u mbajt procesverbali për dorëzimin e pronës me sipërfaqe 15,166 m², në përputhje me vendimin e AKKP-së nr. **, datë 20.5.2008.

94.4 Pas kërkesës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, në datën 13.5.2015, noteri publik, znj. G.B, ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore¹⁴¹ për znj. F.Ç , duke përcaktuar trashëgimtar të vetëm të saj të radhës së parë djalin Gëzim Çopa.

94.5 Bazuar në dëshminë e sipërcituar, në emër të subjektit figuron të jetë e regjistruar pasuria e llojit ullishtë me sipërfaqe 15,166 m², nr. **, volum **, faqe **, zona kadastrale **, për të cilën në datën 8.7.2015 është lëshuar dokumenti certifikatë për vërtetim pronësie me nr. serial **.

95. Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

96. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit automjet tip “**” (vit prodhimi 2002), blerë në datën 15.4.2014, në vlerën 7,500 euro (kontratë blerjeje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 15.4.2014)¹⁴².**

96.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “****”, në vlerën 990,000 lekë, pas dëmtimit në një aksident (kontratë shitjeje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.9.2013) dhe siguracioni i shoqërisë së sigurimit “S”, në shumën 1,500,000 lekë (vërtetim i shoqërisë nr. **, datë 21.10.2016).

96.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite¹⁴³: Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit¹⁴⁴, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit automjet tip “****” (vit prodhimi 2002), blerë në vitin 2014 (kontratë shitjeje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 15.4.2014, në vlerën 7,500 euro.

96.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

97. DPSHTRR-ja¹⁴⁵ informon se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targë AA **, i cili rezulton të jetë pasuria objekt vlerësimi. Nga verifikimi i dosjes së dërguar

¹⁴¹ Dokumenti noterial dëshmi trashëgimie ligjore nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.5.2015.

¹⁴² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. ** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) kontratë nr. **, datë 15.4.2014; (ii) kontratë shitblerjeje nr. **, datë 13.9.2013; (iii) kontratë shitblerjeje nr. **, datë 7.1.2013; (iv) vërtetim i shoqërisë “****” nr. ** prot., datë 21.10.2016.

¹⁴³ Rezulton se, në datën 25.11.2014, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e interesave privatë pas largimit nga funksioni, duke mos evidentuar ndryshime në pasurinë e tij por, nga ana tjetër, duket se data e largimit nga funksioni i cili e bënte subjekt deklarues të pasurive është 24.2.2014, pra para blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

¹⁴⁴ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

¹⁴⁵ Shkresë e DPSHTRR-së nr. ** prot., datë 9.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. ** prot., datë 10.2.2021).

nga DPSHTRR-ja, konfirmohet se, në datën 15.4.2014, subjekti i rivlerësimit ka blerë¹⁴⁶ nga shoqëria “****” pasurinë e llojit automjet, tip “****”, targuar AA ***, vit prodhimi 2002, për çmimin 7,500 euro. Rezulton se, në datën 3.8.2017, subjekti i rivlerësimit e shet këtë automjet po në vlerën 7,500 euro.

98. Sa i përket burimit të krijimit të deklaruar për pasurinë objekt vlerësimi, Komisioni konstaton se, në datën 7.1.2013, subjekti i rivlerësimit ka blerë¹⁴⁷ automjetin tip “****”, targuar AA ***, për shumën 20,000 euro, për të cilën palët kanë deklaruar se janë likuiduar plotësisht me njëri-tjetrin jashtë zyrës noteriale. Ndërsa, në datën 13.9.2013, subjekti e shet¹⁴⁸ këtë pasuri për vlerën 990,000 lekë, për të cilën referuar kontratës palët deklarojnë se janë likuiduar jashtë zyrës noteriale. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje duket se nuk ka transaksion bankar në lidhje me këtë shitje e, për rrjedhojë, vlerësohet se vlera e shitblerjes së kësaj pasurie është marrë *cash* nga subjekti.

99. Nga verifikimi i DIPP-së së vitit 2013, rezulton që në seksionin e pasurive subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “****” me targë AA ***, me vlerë 20,000 euro, me burim shitjen e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m², për vlerën 210,000 euro.

100. Sikurse u evidentua më sipër, në datën 4.1.2013, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij i kanë shitur¹⁴⁹ shoqërisë “****” sh.p.k. pasurinë e llojit truall me sipërfaqe 1,750 m², kundrejt çmimit 210,000 euro. Pas verifikimit të dokumentacionit bankar të dërguar nga ISP Bank¹⁵⁰ rezultoi se, në datën 26.11.2012, në llogarinë e subjektit në monedhën euro kreditohet shuma 21,000 euro, me përshkrimin “****” sh.p.k., për Gëzim Sh. Çopa për blerje toke”. Në datën 7.12.2012, subjekti tërheq shumën 1,000 euro nga kjo llogari dhe, për rrjedhojë, gjendja e saj në datën 31.12.2012 është në shumën 20,000 euro. Në vijim të verifikimit të kësaj llogari rezulton se në datën 4.1.2013 kreditohet shuma 189,000 euro, me përshkrimin “ ****” sh.p.k., për Gëzim Sh. Çopa për blerje toke”.

101. Komisioni konstaton se deri në datën 7.1.2013 nuk ka pasur tërheqje të tjera nga kjo llogari. Rezulton se, në datën 8.1.2013, subjekti ka tërhequr nga kjo llogari shumën 20,000 euro. Pra, duket se të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës bujqësore në janar të vitit 2013, nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “****”, në datën 7.1.2013.

102. Por, në vlerësim përfundimtar të shpjegimeve të dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe nisur nga fakti se subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij bankare shumën 20,000 euro vetëm një ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, vlerë e cila përkon me çmimin e përcaktuar në kontratë për blerjen e automjetit, trupi gjykues krijoi bindjen se pasuria objekt vlerësimi është blerë me fondet e përfituara nga subjekti si rezultat i shitjes së tokës truall, në datën 4.1.2013, shoqërisë “ ****” sh.p.k.

103. Në vijim të verifikimit të DIPP-së së vitit 2013, rezulton se subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “****” në shtator të vitit 2013, në shumën 990,000 lekë. Por, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar specifikisht shtesë likuiditetesh *cash*, me burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****”. Gjithashtu, nuk ka deklaruar krijim llogarie bankare apo shtesë llogarie bankare me burim të ardhurat nga shitja e këtij automjeti.

104. Pra, duket se të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****” në shtator të vitit 2013, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i pasurisë së llojit automjet tip “****”, blerë në datën 15.4.2014.

¹⁴⁶ Kontratë shitjeje (pasuri e luajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.4.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. E.H.

¹⁴⁷ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.1.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. G.B.

¹⁴⁸ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.9.2013, redaktuar nga noteri publik, z. I.H.

¹⁴⁹ Kontratë blerjeje trualli nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2013, redaktuar nga noteri publik, z. A.G .

¹⁵⁰ Shkresë e Intesa Sanpaolo Bank nr. *** prot., datë 11.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.2.2021).

105. Nga ana tjetër, referuar vërtetimit të shoqërisë “****” sh.p.k.¹⁵¹ (trajtuës dëmsh i autorizuar nga shoqëria “****” sh.a.), z. Gëzim Çopa, përdoruesi i mjetit me targë AA ***, ka përfitur vlerën prej 1,500,000 lekësh, si pasojë e përfshirjes në ngjarjen aksidentale të datës 30.7.2013.

106. Pas verifikimit të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në BKT¹⁵² rezultoi se, në datën 31.3.2014, ajo kreditohet me shumën 1,100,000 lekë, me përshkrimin “I. A.V sh.a. për Gëzim Sh. Çopa pagesë dëm TPL, dosja ***”. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie rezulton se, në datën 1.4.2014, subjekti e transferon shumën prej 1,100,000 lekësh fillimisht në një llogari tjetër personale brenda BKT-së e më pas, në datën 24.4.2014, e transferon këtë shumë në llogarinë 1,051,500 lekë, me përshkrimin “Transfertë Gëzim Çopa për H.H Tirana sh.a., pagesë për blerje automjeti (kundërvlera e 7,500 euro)”.

107. Pavarësisht se referuar kontratës së shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi të datës 15.4.2014, referohet se çmimi është likuiduar prej palës blerëse (subjektit) më parë jashtë zyrës noteriale, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe nisur nga fakti se ky automjet është blerë nga një shoqëri tregtare e regjistruar në organin tatimor shqiptar dhe për sa kohë konfirmohet kryerja e transaksionit të shitblerjes së pasurisë nëpërmjet sistemit bankar vetëm disa ditë pas nënshkrimit të kontratës, trupi gjykues krijoi bindjen se kjo pasuri është blerë nga subjekti me fondet e përfituara nga siguracioni i shoqërisë “S”.

108. Zotëron 100% të pasurisë së llojit obligacione në Bankën e Shqipërisë, me afat 5-vjeçar, krijuar në datën 8.5.2014, në vlerën 15,000,000 lekë¹⁵³

108.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m², në vlerën 210,000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2013.

108.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite¹⁵⁴: Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës e vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit¹⁵⁵, ndër të tjera, ka deklaruar obligacione në Bankën e Shqipërisë, me afat 5-vjeçar, krijuar në datën 8.5.2014, me vlerë 15,000,000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) bonot e thesarit; (ii) të ardhurat nga shitja e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m², në vlerën 210,000 euro (kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2013).

108.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së mbi këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur. DPPP-ja konfirmon kalimin në rrugë bankare të 90% të të ardhurave nga shitja e tokës në vitin 2013, deklaruar si burim i depozitës në Credins Bank.

Hetimi/verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

109. Sikurse u evidentua më sipër, rezulton e provuar se, në datën 4.1.2013, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij i kanë shitur¹⁵⁶ shoqërisë “****” sh.p.k. pasurinë nr. ***, volum ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit truall me sipërfaqe 1,750 m², kundrejt çmimit 210,000 euro.

110. Nga shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstatoi se: (i) në DIPP-në e vitit 2012, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, subjekti ka deklaruar llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank,

¹⁵¹ Vërtetim i “****” nr. *** prot., datë 21.10.2016.

¹⁵² Shkresë e BKT-së nr. *** prot., datë 10.11.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.11.2023).

¹⁵³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) vërtetim transaksioni për obligacion nga Credins Bank, i datës 8.5.2014; (ii) kontratë shitblerjeje trualli nr. ***, datë 4.1.2013.

¹⁵⁴ Rezulton se, në datën 25.11.2014, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e interesave privatë pas largimit nga funksioni, duke mos evidentuar ndryshime në pasurinë e tij por, nga ana tjetër, duket se data e largimit nga funksioni i cili e bënte subjekt deklarues të pasurive është 24.2.2014, pra para blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

¹⁵⁵ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

¹⁵⁶ Kontratë blerjeje trualli nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2013, redaktuar nga noteri publik, z. A.G .

në vlerën 21,000 euro, me burim shitjeje tokë truall, kontratë kapari nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2012; (ii) në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, subjekti ka deklaruar shitjen e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m² (përfutur me ligjin nr. 7501, “Për tokën”), në vlerën 210,000 euro.

111. Pas verifikimit të dokumentacionit bankar të dërguar nga Intesa Sanpaolo Bank¹⁵⁷ rezultoi se, në datën 26.11.2012, në llogarinë e subjektit në monedhën euro (nr. llogarie ***) kreditohet shuma 21,000 euro, me përshkrimin “****” sh.p.k., për Gëzim Sh.Çopa për blerje toke”. Në datën 7.12.2012, subjekti tërheq shumën 1,000 euro nga kjo llogari dhe, për rrjedhojë, gjendja e saj në datën 31.12.2012 është në shumën 20,000 euro. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie rezulton se në datën 4.1.2013 kreditohet shuma 189,000 euro, me përshkrimin “****” sh.p.k., për Gëzim Sh Çopa për blerje toke”.

111.1 Nga gjendja e kësaj llogarie, në datën 10.1.2013, vlera 158,000 euro konvertohet në lekë brenda llogarive të subjektit pranë së njëjtës bankë dhe ekuivalenti prej 22,000,000 lekësh transferohet në datën 14.1.2013 llogarinë e subjektit pranë Bankës së Shqipërisë¹⁵⁸, duke u investuar në bono thesari 12-mujore prej datës 29.1.2013.

112. Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin e pasurive ka deklaruar si shtesë pasurie bono thesari në shumën 22,000,000 lekë, me burim të ardhurat nga shitja e tokës bujqësore.

113. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë së kartelës së subjektit të rivlerësimit pranë Bankës së Shqipërisë duket se pas maturimit të bonove të thesarit 1-vjeçare, në datën 30.1.2014, vlera 22,000,000 lekë është riinvestuar në bono thesari 3-mujore dhe pas maturimit, në datën 2.5.2014, këto fonde janë transferuar pranë Credins Bank¹⁵⁹, nga ku rezulton se shuma prej 15,000,000 lekësh është investuar nga subjekti në obligacione 5-vjeçare pranë Bankës së Shqipërisë, duke filluar prej datës 8.5.2014 e në vijim. Rezulton se gjendja e këtij investimi në fund të viteve 2014, 2015 dhe 2016 ka qenë në vlerën 15,000,000 lekë. Referuar informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Credins Bank konfirmohet se gjatë viteve 2014 – 2016 në llogari të subjektit është kredituar periodikisht vlera e kuponit (fitimi nga investimi në obligacione), në total shuma 2,144,625 lekë¹⁶⁰.

113.1 Komisioni konstaton se në DIPP-në para fillimit të detyrës të vitit 2015, si dhe në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016 subjekti ka deklaruar të ardhura me burim nga obligacionet.

114. Për sa më sipër, Komisioni konkludon se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi, obligacionet pranë Bankës së Shqipërisë, si dhe se nuk ka dyshime për burimin e krijimit të kësaj pasurie.

¹⁵⁷ Shkresë e Intesa Sanpaolo Bank nr. *** prot., datë 11.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.2.2021).

¹⁵⁸ Shkresë e Bankës së Shqipërisë nr. *** prot., datë 31.10.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.11.2023.

¹⁵⁹ Shkresë e Credins Bank nr. *** prot., datë 16.3.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.3.2021.

¹⁶⁰ (i) Gjatë vitit 2014, shuma 448,875 lekë; (ii) gjatë vitit 2015, shuma 847,875 lekë; (iii) gjatë vitit 2016, shuma 847,875 lekë.

115. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit depozitë në Raiffeisen Bank, krijuar në vitin 2014, me vlerë 13,000,000 lekë¹⁶¹

115.1 Si burim krijimi të kësaj depozite ka deklaruar të ardhurat në vlerën 10,000,000 lekë, të krijuara nga shitja e tokës bujqësore më 3.10.2007 (kontratë shitjeje nr. ***, datë 3.10.2007), të cilat ishin të investuara më parë në bono thesari, si dhe të ardhurat në vlerën 210,000 euro, të krijuara nga shitja e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m² (kontratë shitjeje nr. ***, datë 4.1.2013).

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

115.2 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit¹⁶², ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit depozitë bankare në Raiffeisen Bank, në shumën 7,000,000 lekë, me afat vjetor, krijuar në vitin 2007, me burim të ardhurat nga shitja e tokës bujqësore në vlerën 10,000,000 lekë.

115.3 Në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e deklaramit të pasurive subjekti ka deklaruar bono thesari me maturim njëvjeçar, në shumën 7,000,000 lekë, me burim fondet e gjendje në Raiffeisen Bank, po në vlerën 7,000,000 lekë (duke referuar pakësimin e tyre).

115.4 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar shtesë të pasurisë në bono thesari, shumën prej 3,000,000 lekësh, me burim: (i) fondet në vlerën 1,000,000 lekë nga llogaria e bashkëshortes në Credins Bank; (ii) shuma prej 750,000 lekësh nga gjendja *cash*; (iii) pjesa tjetër nga interesat e bonove të thesarit dhe të ardhurat e tjera familjare.

115.5 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit¹⁶³, ndër të tjera, ka deklaruar pasurinë e llojit depozitë në Raiffeisen Bank (fondi Invest AI), në vlerën 14,355,000 lekë, krijuar në qershor të vitit 2014. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga shitja e tokës bujqësore me sipërfaqe 1,750 m², në vlerën 210,000 euro (kontratë shitjeje nr. ***, datë 4.1.2013).

115.6 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar se ka pakësuar llogarinë në Raiffeisen Bank Invest AI, në shumën 1,000,000 lekë, tërhequr për shpenzime familjare dhe pagesë për shkollimin e dy djemve, R dhe B.

Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

115.7 Raiffeisen Invest konfirmon investimin në fondin Raiffeisen Prestigj, ndërsa dokumentacioni i paraqitur nga subjekti konfirmon interesat e përfituar nga investimi në bono thesari në vite.

115.8 Është i dyshimtë transaksioni blerje/shitje i tokës arë me sipërfaqe 1,462 m², z, k. ***, me nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, në Sh , Durrës, blerë nga z. Gëzim Çopa në datën 27.6.2005, me kontratën nr. ***, me çmimin 760,000 lekë dhe shitur me kontratën nr. ***, datë 3.10.2007, kundrejt çmimit 10,000,000 lekë.

¹⁶¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. ***në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) pasqyrë llogarie e datës 18.10.2016, nga Raiffeisen Invest; (ii) kontratë nr. ***, datë 3.10.2007, për shitjen e pasurisë së llojit tokë arë me sipërfaqe 1,462 m²; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie datë 1.7.2005, për pasurinë e llojit arë me sipërfaqe 1,462 m²; (iv) kontratë shitblerjeje tokë arë nr. ***, datë 27.6.2005; (v) kartelë e klientit Gëzim Çopa, për periudhën 1.4.2009 – 7.5.2009, shoqëruar me 8 vërtetime pagese nga Banka e Shqipërisë, të datave të ndryshme, si vijon: vërtetim pagese datë 20.4.2011; vërtetim pagese datë 20.5.2011; vërtetim pagese datë 21.5.2012; vërtetim pagese datë 13.4.2013; vërtetim pagese datë 17.5.2013; vërtetim pagese datë 15.11.2013; vërtetim pagese datë 12.4.2013; vërtetim pagese datë 31.1.2014.

¹⁶² Në atë periudhë me funksion ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI.

¹⁶³ Në atë periudhë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Hetimi/verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, si dhe evidentimi e analizimi i burimeve të deklaruara për krijimin e saj

116. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se, në datën 3.10.2007, subjekti i rivlerësimit i ka shitur shtetasit E.C pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 1,462 m², ndodhur në Sh , Durrës, në shumën 10,000,000 lekë. Rezulton se këtë pasuri subjekti e kishte blerë në datën 27.6.2005, në shumën 760,000 lekë.

117. Në kushtet kur rezulton se subjekti e ka shitur pasurinë e mësipërme për një çmim rreth 13 herë më të lartë nga çmimi i blerjes vetëm pas rreth 2 vjet e 3 muaj pasi e kishte blerë, si dhe faktit se kemi të bëjmë me një pasuri të llojit tokë arë, Komisioni ngre dyshime mbi vërtetësinë e këtij transaksioni.

117.1 Në këtë kuadër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë dhe argumentojë të gjitha veprimet/transaksionet e kryera prej tij lidhur me këtë pasuri, përfshirë edhe marrëdhënien e tij me palën shitëse dhe blerëse, duke deklaruar dhe shpjeguar se si u krye/realizua kontakti fillestar me ta dhe mbi marrëveshjet/dakordësitë e bëra për përcaktimin e çmimit të blerjes dhe shitjes së kësaj pasurie. Gjithashtu, iu kërkua të japë sqarimet e tij mbi faktin e shitjes së kësaj pasurie me një çmim disa herë më të lartë se ai i blerjes, duke evidentuar se çfarë ndryshoi në këtë pasuri që solli rritjen e vlerës së saj për një kohë kaq të shkurtër dhe cilët ishin faktorët që sollën këtë ndryshim në vlerësimin e saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

118. Me anë të prapësimeve pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:

118.1 *Së pari*, lidhur me natyrën e marrëdhënies që ka ekzistuar mes tij dhe shitësve të parë të kësaj pasurie, deklaroi se kjo pasuri në vetvete origjinën e ka pasur nga familja e tij dhe se kontrata e shitjes ka qenë finalizimi i në marrëveshjeje të bërë më parë mes prindërve të tij dhe shtetasve V.D, I.D dhe Xh.D , të cilët ishin pronarë të kësaj sipërfaqeje toke dhe e kishin fituar këtë pronë me ligjin nr. 7501, “Për tokën”.

118.1.1 Në vijim, referon se shtetasit e identifikuar si shitës të kësaj pasurie, pjesëtarë në certifikatën për vërtetim pronësie (7 persona), janë të gjithë të fisit D, të afërm të nënës së tij dhe se sipërfaqja prej 1,462 m², që ata kishin marrë nga ligji nr. 7501, “Për tokën”, ishte tokë e vjetër e nënës së tij F.Ç (D), ku në total kishte 64 dynym¹⁶⁴. Për këtë sipërfaqe deklaroi se ka vepruar ligji nr. 7501, “Për tokën”, dhe se ai vetë, me këtë ligj, nga kjo sipërfaqe ka përfituar vetëm 2,173 m².

118.2 *Së dyti*, deklaroi se për kohën që është kryer ky transaksion konflikti mes ish-pronarëve të vjetër dhe atyre që kishin përfituar në tokat e këtyre ish-pronarëve nga ligji nr. 7501, “Për tokën”, ishte evident. Ndërkohë që ish-pronarët edhe me ligjin nr. 7501 donin të pajiseshin me tokë në ish-tokat e tyre të vjetra. Pala shitëse ishte trashëgimtare pronash në zonën e bregdetit dhe se kanë përfituar sipërfaqe në këtë zonë sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”. Me sa i ka thënë babai, kujton se, meqë kjo sipërfaqe toke ishte pronë e vjetër e nënës së tij, shtetasit V.D, I.D dhe Xh.D donin ta dorëzonin pa shpërblim këtë sipërfaqe. Që në fillim të vitit 2001, kjo familje kishte marrë certifikatën për vërtetim pronësie për një sipërfaqe prej 10,971 m² në K, G, Kavajë, dhe se në listën e bashkëpronarëve në këtë pronë janë të njëjtët persona të cilët kanë nënshkruar në kontratën e shitjes së datës 27.6.2005 për shitjen e sipërfaqes¹⁶⁵ prej 1,465 m².

118.2.1 Pra, subjekti argumenton se çmimi i përcaktuar në blerjen e kësaj pasurie vjen si rrjedhojë e kësaj marrëdhënieje të posaçme, në kushtet kur shitësit (familja D) duhet t’ia kthenin

¹⁶⁴ Ka referuar si provë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 26.12.2007 (i cili ka marrë formë të prerë), depozituar bashkëlidhur prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit.

¹⁶⁵ Subjekti ka depozituar dokumentacion mbi pronat e familjes D, në K, G, Kavajë.

nënës së tij, pasi kishin përfituar një sipërfaqe tjetër toke dhe kjo pasuri nuk mund të ishte pasuri e përfituar prej tyre, fakt të cilin referon se e konfirmon edhe një prej palëve shitëse të kësaj sipërfaqeje, sipas deklaratës noteriale të vënë në dispozicion Komisionit¹⁶⁶.

118.3 Së treti, shpjegon se për nevojat e tij familjare vendosi ta shiste këtë sipërfaqe toke dhe se ka rënë dakord me blerësin E.C, të cilin deklaroi se nuk e njihje më parë, për çmimin e shitblerjes së kësaj prone.

118.3.1 Sa i përket çmimit të shitblerjes së kësaj pasurie, referon se ai përpunet plotësisht me vlerën e tregut të vitit 2007. Në mbështetje të deklaratimit të tij ka vënë në dispozicion aktin e ekspertimit për këtë pasuri, datë 9.2.2024, përpiluar nga eksperti vlerësues, pajisur me licencat nr. ***, *** dhe ***, me NIPT ***, inxhinier B.K.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

119. Si konkluzion, trupi gjykues i gjen bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion ligjor provues shpjegimet dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi transaksionet e kryera lidhur me këtë pasuri. Kështu, në kushtet kur provohet marrëdhënia e posaçme e subjektit me shitësit e kësaj pasurie, si dhe nisur nga konkluzionet e aktit të ekspertimit mbi vlerën e kësaj pasurie në vitin 2007 – të cilit Komisioni i jep fuqi provuese për sa kohë duket se ai gjen mbështetje në informacionet e agjencive imobilare të kohës dhe afishimet e bëra në gazetën “****” të çmimeve të shitjes së tokave në të njëjtën zonë – trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika në kryerjen e këtyre transaksioneve nga ana e subjektit të rivlerësimit.

120. Referuar informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Raiffeisen Bank¹⁶⁷, Komisioni konstaton se, në datën 4.10.2007, në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit në lekë (llogaria nr. ***) është depozituar *cash* fillimisht shuma 7,500,000 lekë, me përshkrimin “Likuidim E.C” e më pas, në datën 9.10.2007, depozitohet *cash* shuma 1,100,000 lekë. Shuma e krijuar gjendje në këtë llogari prej 8,600,000 lekësh, prej datës 17.10.2007 rezulton të jetë investuar në depozitë pranë shoqërisë së kursim kreditit “****”. Nga shuma totale e investuar në këtë shoqëri rezulton se: (i) vlera prej 5,000,000 lekësh ka qenë e investuar deri në prill të vitit 2008 e më pas është transferuar në llogari bankare të subjektit në Raiffeisen Bank, përdorur në qershor të vitit 2008 për likuidim detyrimi në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., për blerje pasurie të paluajtshme; (ii) vlera prej 3,600,000 lekësh ka qenë e investuar deri në korrik të vitit 2008, pas maturimit është transferuar në llogarinë e subjektit në Credins Bank dhe se prej muajit gusht 2008 deri në shkurt 2009 ka qenë e investuar në llogari depozitë.

120.1 Komisioni konstaton se llogaria e subjektit në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet dy depozitimeve të kryera nga shtetasi E.C , përkatësisht: (i) në datën 3.12.2007 depozituar shuma 900,000 lekë; (ii) në datën 4.12.2007 depozituar shuma 100,000 lekë. Rezulton se shuma prej 1,000,000 lekësh gjendje në këtë llogari është tërhequr nga subjekti brenda një periudhe 7-ditore. Në datën 21.12.2007 evidentohet se subjekti ka depozituar *cash* në këtë llogari shumën 2,900,000 lekë.

120.2 Në datën 19.1.2008, subjekti ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank shumën 4,100,000 lekë, e cila bashkohet me shumën që ishte gjendje në këtë llogari, prej 2,900,000 lekësh. Rezulton se vlera totale e kësaj llogarie prej 7,000,000 lekësh investohet nga subjekti në bono thesari, fillimisht nëpërmjet Raiffeisen Bank e më pas nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, në të njëjtën vlerë edhe për vitet 2009 e 2010.

121. Sa më sipër, duket se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së llojit tokë arë në tetor të vitit 2007, nuk mund të kenë shërbyer për të mundësuar plotësisht krijimin në vitin 2008 të

¹⁶⁶ Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të shtetasit Xh.D, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. G.B .

¹⁶⁷ Shkresë e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 9.2.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.2.2021.

depozitës në shumën 7,000,000 lekë në Raiffeisen Bank. Si rrjedhim, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie në vitin 2008. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës mbi këtë konstatim.

122. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka pranuar pasaktësinë në deklaram, duke referuar se kjo depozitë është krijuar edhe me të ardhurat që disponoheshin *cash* prej familjes së tij – me burim marrëdhënien financiare me shoqërinë “***”. Në shpjegimet e tij, subjekti evidenton faktin se në kohën e krijimit të kësaj depozite ai nuk ka qenë subjekt deklarues i pasurive, duke shtuar se pasqyrimi i këtyre të dhënave në deklaratat e tij të pasurive është kryer në vazhdimësi nga personi i lidhur (bashkëshortja), e cila është me profesion ekonomiste financiare dhe se ka qenë lapsus i saj ky deklaram.

123. Trupi gjykues çmoi të pranojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pasaktësi në deklaramin e bërë mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, sigurisht duke argumentuar se për efekt të këtij procesi peshë specifike merr verifikimi në tërësi i ligjshmërisë së burimeve financiare për krijimin e saj. Kështu, bazuar në analizën financiare të kryer – Komisioni arrin në konkluzionin se familja Çopa ka pasur të ardhura të disponueshme me burim marrëdhënien e krijuar me shoqërinë “***”, si edhe ka krijuar të ardhura të tjera përgjatë periudhës korrik 2005 – janar 2008, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e depozitës prej 7 milionë lekësh në Raiffeisen Bank. Në këtë kontekst, trupi gjykues përfundimisht vlerëson se pasaktësia në deklaram, e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, nuk mund të konsiderohet si shkak që mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

124. Në vijim të verifikimit të llogarive të subjektit të rivlerësimit dhe transaksionet e kryera prej tij, Komisioni konstaton se gjatë vitit 2011, shumës prej 7,000,000 lekësh, e cila ishte e mbartur nga investimi në bono thesari në datën 11.4.2011, i shtohet: (i) shuma prej 700,000 lekësh, transferuar nga llogaria e pagës së subjektit në Intesa Sanpaolo Bank; (ii) shuma prej 1,300,000 lekësh, e cila rezulton se ishte depozituar më parë në llogarinë e pagës së subjektit në Intesa Sanpaolo Bank (datë 8.4.2011), me përshkrimin “Të ardhura nga shitja e gjeneratorit”. Gjithashtu, rezulton se në datën 8.4.2011 transferohet nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në Credins Bank në llogarinë e subjektit në Bankën e Shqipërisë (bono thesari) shuma 1,000,000 lekë, e cila duket se ishte e mbartur nga investimet e mëparshme prej vitit 2007, fillimisht në shoqërinë e kursim kreditit “***” (trajtuar më lart)¹⁶⁸.

125. Për sa më sipër, rezulton se në fund të vitit 2011, vlera e investuar nga subjekti i rivlerësimit në bono thesari ka qenë në total në shumën 10,000,000 lekë.

126. I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja¹⁶⁹ në lidhje me të ardhurat e depozituara *cash* në Intesa Sanpaolo Bank në shumën 1,300,000 lekë, në datën 8.4.2011, me përshkrimin “Të ardhura nga shitje gjeneratori”, subjekti ka deklaruar se *ky është një gjenerator i përdorur nga shoqëria “***” dhe falur prindërve të tij pasi u larguan nga Shqipëria. Nuk ka dokument, por konfirmon përgjigjen e bankës. Sqaron se ia ka shitur firmës “***” me aktivitet shitje gomash, me administrator z. T.D. Nuk e ka deklaruar si të ardhur të tijën sepse veprimi i kryer ka qenë për llogari të nënës.*

127. Komisioni konstatoi se në DIPP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar shtesë të pasurisë në bono thesari shumën prej 3,000,000 lekësh, me burim: (i) fondet në vlerën 1,000,000 lekë nga

¹⁶⁸ Pas maturimit në SHKK Dyrrah, më pas kjo shumë ka qenë e investuar pranë Intesa Sanpaolo dhe Credins Bank, por duket se është me burim fillestar nga shitja e pasurisë së paluajtshme në vitin 2007 (tokë arë me sip. 1,462 m² kundrejt çmimit 10,000,000 lekë).

¹⁶⁹ Përgjigje e pyetjes nr. *** në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”, datë 11.2.2015, ndodhur në shkresën kthim përgjigjeje të ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 26.7.2023, protokolluar në ILDKPKI me nr. *** prot., në datën 27.7.2023.

llogaria e bashkëshortes në Credins Bank; (ii) shumën 750,000 lekë nga gjendja *cash*; (iii) pjesën tjetër nga interesat e bonove të thesarit dhe të ardhurat e tjera familjare.

128. Pra, duket se nuk përputhen deklaratimet e bëra mbi burimin e krijimit të shtesës së bonove të thesarit në vitin 2011. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegimet e tij mbi këtë konstatim.

128.1 Nëpërmjet prapësimeve të tij, në lidhje me shtesën e bonove të thesarit në Bankën e Shqipërisë në vitin 2011, në shumën 3,000,000 lekë, subjekti konfirmon se një pjesë e saj është e ardhur nga shitja e gjeneratorit që shoqëria “*** ” ka përdorur kur ishte me qira në shtëpinë e tij, në shumën 1,300,000 lekë, e cila është marrë *cash* dhe është vendosur në Intesa Sanpaolo Bank. Subjekti deklaroi se e ka shënuar në DIPP-në e vitit 2011 si të ardhur familjare, sepse nuk ishte as e ardhur e tij dhe as e bashkëshortes.

128.2 Sikurse u evidentua edhe më sipër, në referimin e burimeve të krijimit të shtesës prej 3,000,000 lekësh në bono thesari për vitin 2011, nga shqyrtimi i deklaratës së interesave private të këtij viti evidentohet se subjekti ka deklaruar se shuma 1,250,000 lekë ka si burim vetë interesat e bonove të thesarit dhe të ardhurat e tjera familjare. Pra, rezultoi se në DIPP-në e vitit 2011 subjekti ka referuar të ardhura të tjera familjare si burim për shtesën e bonove të thesarit, të cilat sipas shpjegimeve të dhëna janë përfituar nga nëna e tij pas shitjes së gjeneratorit të dhuruar nga shoqëria “*** ”.

129. Në vijim, rezultoi se në vitin 2013 shuma e investuar në bono thesari prej 10,000,000 lekësh bashkohet me shumën 22,000,000 lekë (me burim të ardhurat nga shitja e tokës në janar të vitit 2013). Në datën 31.12.2013, vlera totale e investuar nga subjekti në bono thesari ka qenë në shumën 30,000,000 lekë. Nga kjo shumë, gjatë vitit 2014, vlera 14,650,000 lekë investohet me pjesë nga subjekti në fondin Raiffeisen Prestigj¹⁷⁰, për periudhën 21.5.2014 – 13.11.2014. Vlera e investimit në fund të vitit 2014 ka qenë 14,962,215 lekë. Gjatë vitit 2015, subjekti ka kryer dy tërheqje nga shuma e investuar, nga ku rezultoi se vlera e mbetur në fund të vitit ka qenë 14,002,576 lekë. Gjatë vitit 2016, subjekti ka kryer disa transaksione tërheqjeje dhe investime në llogarinë e fondit të investimit dhe rezultoi se vlera e mbetur e investuar në fund të vitit 2016 ka qenë 13,004,692 lekë.

130. Për sa më sipër, gjithsesi Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi, fondit të investimit, pranë Raiffeisen Invest.

131. Zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit llogari bankare rrjedhëse (page) në Raiffeisen Bank, në shumën 280,000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar *overdraft*-in në shumën 250,000 lekë¹⁷¹.

132. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga Raiffeisen Bank, në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* (27.1.2017) konfirmohet se gjendja e llogarisë së pagës së subjektit në Raiffeisen Bank është në vlerën prej rreth 14,000 lekësh. Ndërsa, duket se disa ditë para dorëzimit të deklaratës gjendja e kësaj llogarie ka qenë në shumën prej rreth 33,000 lekësh (datë 23.1.2017). Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në dosje rezultoi se nga Raiffeisen Bank konfirmohet se në atë periudhë prej subjektit ishte i disponueshëm për t’u përdorur *overdraft*-i, me kufi në shumën 250,000 lekë (shumë e papërdorur).

133. Sa më sipër, duket se subjekti ka deklaruar shumën totale të disponueshme për t’u përdorur prej tij, gjendje në llogarinë e pagës në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

¹⁷⁰ Shkresë e Raiffeisen Invest nr. *** prot., datë 2.11.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.11.2023.

¹⁷¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin kontratë kredie me kufi (*overdraft*), datë 31.5.2016, lidhur ndërmjet z. Gëzim Çopa dhe Raiffeisen Bank.

134. Zotëron 100% të llojit automjet tip “**”, vit prodhimi 1998, blerë në vitin 2016, për shumën 500,000 lekë** (kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2006). Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kursimet familjare¹⁷².

135. Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit¹⁷³, ndër të tjera, ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në vitin 2006, me burim të ardhurat vjetore të viteve 2005 e 2006.

136. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri konfirmohet se, në datën 24.10.2006, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi I.Z pasurinë e llojit automjet tip “****”, për çmimin 500,000 lekë.

137. Pasuria e llojit tokë bujqësore (nr. *), me sipërfaqe 2,000 m²,** ndodhur në zonën kadastrale ***, fshati R, për të cilën referon se personi i lidhur (bashkëshortja) zotëron 75% pjesë takuese të saj. Kjo pasuri është deklaruar edhe nga personi i lidhur si pasuri e disponuar veçmas (në dukje duke referuar se zotëron 25% pjesë takuese të saj)¹⁷⁴.

137.1 Burimi i krijimit: Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është fituar prej bashkëshortes së tij si ish-punonjëse e Drejtorisë Bujqësore në vitet 1991 – 1992, në bazë të ligjit për ndarjen e tokave në ndërmarrjet bujqësore.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

137.2 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e personit të lidhur që mbart detyrimin për deklarim, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 2,000 m², me vendndodhje në fshatin R, ish-NB S, Durrës, përfituar nga ligji nr. 7501, “Për tokën”.

137.3 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e personit të lidhur që mbart detyrimin për deklarim, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të llojit tokë bujqësore me sipërfaqe 2,000 m², me burim ligjin nr. 7501, “Për tokën”.

137.4 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Durrës. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshortja me zotërim përkatësisht 75% dhe 25%, pasuri e cila është përftuar nga bashkëshortja dhe e regjistruar në ZVRPP në emër të saj.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

138. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP Durrës, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ të kryer lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:

138.1 Referuar AMTP-së nr.*** të Komisionit të Ndarjes së Tokës, fshati R, rrethi Durrës, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, personi i lidhur, znj. F.Ç , ka përfituar pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 2,000 m², ndodhur në K, Durrës (nr. pasurie ***).

138.2 Duket se, bazuar në AMTP-në e sipërcituar, në datën 26.6.2000, kjo pasuri (tokë arë me sipërfaqe 2,000 m²) figuron e regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të bashkëshortes së

¹⁷² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 24.10.2006.

¹⁷³ Në atë periudhë me funksion ndihmës inspektor i lartë në ILDKPKI.

¹⁷⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin certifikatë për vërtetim pronësie datë 18.10.2005, për pasurinë e llojit arë me sipërfaqe 2,000 m².

subjektit, znj. F.Ç , me nr. ***, volum ****, faqe ***, në seksionin “Përshkrim i veçantë”, me shënimin “Në akt ka numër ***”¹⁷⁵.

138.3 Në datën 18.10.2005, për këtë pasuri është lëshuar dokumenti certifikatë për vërtetim pronësie në emër të personit të lidhur, znj. F.Ç .

139. Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri¹⁷⁶.

140. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në seksionin e deklaramit të detyrimeve financiare, personi i lidhur, **djali i subjektit E.Ç ka deklaruar se disponon cash shumën 360,000 lekë**, me burim kredinë e marrë në Raiffeisen Bank, me kontratën e kredisë nr. ***, datë 15.5.2015 (shuma 1,000,000 lekë)¹⁷⁷.

141. Pas verifikimit të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, mbi deklaramin e likuiditeteve *cash*, Komisioni konstaton se:

141.1 Në deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.6.2005) rezulton se subjekti nuk ka deklaruar pasuri të llojit likuiditete *cash*.

141.2 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur nuk ka deklaruar pasuri të llojit likuiditete *cash*.

141.3 Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 600,000 lekë.

141.4 Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 150,000 lekë, me burim nga pakësimi i llogarisë me vlerë 1,000,000 lekë në emër të bashkëshortes në Credins Bank dhe interesat vjetorë në këtë llogari. Gjithashtu, rezulton se personi i lidhur, znj. F.Ç , ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 150,000 lekë, nga pakësimi i depozitës në Credins Bank me 1,000,000 lekë, një pjesë e të cilave janë përdorur për pushimet verore të familjes dhe pagesën e shkollës së fëmijëve.

141.4.1 Duket se vetë subjekti ka deklaruar disponimin e kësaj gjendjeje *cash* (shuma 150,000 lekë) nga ana e bashkëshortes, deklaruar edhe prej personit të lidhur (bashkëshortes) si pasuri veçmas e zotëruar 100% prej saj.

141.5 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar pakësimin e pasurisë së llojit likuiditete *cash* në shumën 750,000 lekë, duke referuar se disponon gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 200,000 lekë, me burim të ardhurat e vitit 2011.

141.6 Në DIPP-të e viteve 2012 dhe 2013, nga subjekti dhe/apo personat e lidhur nuk deklarohen shtesa/pakësime të pasurisë së llojit likuiditete *cash*.

141.7 Në vitin 2014, në deklaratën e interesave privatë pas largimit nga funksioni, dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 25.11.2014, nuk deklarohen shtesa/pakësime në likuiditetet *cash*.

141.8 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015), subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar gjendje likuiditetesh *cash*. Ndërsa, djali i subjektit të rivlerësimit, z. E.Ç, në cilësinë e personit të lidhur që mbart detyrimin për deklarim, në seksionin e pasurive ka deklaruar se disponon shumën prej 560,000 lekësh, gjendje likuiditetesh *cash*, me burim kredinë e marrë në Raiffeisen Bank, në datën 15.5.2015. Ndërsa, në seksionin e detyrimeve financiare, pasi ka

¹⁷⁵ Referojuni dokumentit kartelë e pasurisë së paluajtshme.

¹⁷⁶ Rezulton se, në datën 3.9.2020, personi i lidhur e shet këtë pasuri (tokë arë me sipërfaqe 2,000 m²) për vlerën 1,250,000 lekë.

¹⁷⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin kontratë kredie bankare me Raiffeisen Bank nr. ***, datë 15.5.2015.

referuar kredinë e marrë në shumën 1,000,000 lekë, qëllimin (pagesë studimesh dhe blerje makine) dhe një pjesë të përdorimit të saj, referon se ka gjendje *cash* shumën 560,000 euro. Më konkretisht, ka sqaruar se shumën prej 160,000 lekësh e ka përdorur për pagesë të studimeve master në universitetin “****” dhe se po ashtu i ka dhënë vëllezërve të tij për studime 160,000 lekë. Disponon gjendje *cash* shumën 560,000 lekë për blerje automjeti.

141.9 Në DIPP-në e vitit 2015, djali i subjektit, z. E.Ç, deklaroi se disponon *cash* shumën 560,000 lekë, me burim kredinë bankare të marrë në Raiffeisen Bank.

141.10 Në DIPP-në e vitit 2016, djali i subjektit, z. E.Ç, deklaroi se nga gjendja *cash* që ka pas disponuar një vit më parë ka shpenzuar shumën prej 200,000 lekësh për pushime dhe se disponon gjendjen e likuiditeteve *cash* shumën prej 360,000 lekësh.

142. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur në ILDKPKI mbi shtesat/pakësimet/gjendjet e likuiditeteve *cash* ndër vite, duket se ecuria e gjendjes së kursimeve në formë likuiditetesh *cash*, nga deklarata fillestare e pasurisë deri në DIPP-në e vitit 2016, paraqitet e pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4

Analizë e ecurisë së shtesave/pakësimeve dhe gjendjes së likuiditeteve <i>cash</i> sipas deklarimeve periodike të subjektit dhe personit të lidhur (vlerat në lekë)			
Viti	Shtesë	Pakësim	Gjendje
30.6.2005	0	0	0
DIPPF 19.1.2009	0	0	0
DIPP 2009	600,000	0	600,000
DIPP 2010	150,000	0	750,000
DIPP 2011	200,000	750,000	200,000
DIPP 2012	0	0	200,000
DIPP 2013	0	0	200,000
DIPLF 2014	0	0	200,000
DIPPF 27.11.2015	560,000	200,000	560,000
DIPP 2015	0	0	560,000
DIPP 2016	0	200,000	360,000
Deklaruar në Vetting 27.1.2017			360,000

Analiza financiare për vitet 1992 – 2016¹⁷⁸

143. Bazuar në: (i) dokumentacionin e administruar në dosje; (ii) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI; (iii) shpjegimet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – Komisioni kreu analizën përfundimtare¹⁷⁹ të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhat: (i) 1992 – 30.6.2005; (ii) 1.7.2005 – 19.1.2009; (iii) 20.1.2009 – 31.12.2009, si dhe për vitet 2010 – 2016, nga ku rezultoi se vitet 2011 dhe 2014 paraqiten me balancë negative të fondeve, konkretisht: (a) për vitin 2011,

¹⁷⁸ Referojuni tabelës së analizës përmblendhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, aneks nr. *** – pjesë e këtij vendimi.

¹⁷⁹ Krahas sa u argumentua si më sipër në këtë vendim mbi rezultatet e analizës financiare për periudha të ndryshme të marra në shqyrtim, si dhe në momentin e krijimit të pasurive, bazuar në shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti në analizën financiare përfundimtare u reduktuan shpenzimet për arsimim për djalin e subjektit, z. B.Ç, për vitet 2014 – 2016.

balanca negative e fondeve -393,160 lekë; (b) për vitin 2014, balanca negative e fondeve - 593,509 lekë. Evidentuar totali i balancës negative në shumën -986,669 lekë.

144. Në vlerësim përfundimtar të rezultatit të analizës financiare, trupi gjykues çmon se kjo balancë negative e shpërndarë në dy vite është në vlerë të tillë, e cila çmohet se nuk është e mjaftueshme për ta vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kjo edhe për shkak se duket se këto balanca negative nuk ndikojnë drejtpërdrejt në burimin e krijimit të pasurive të subjektit. Pra, arrihet në konkluzionin se edhe kjo rrethanë e konstatuar nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

145. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë kuadër rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

145.1 Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

145.2 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

145.3 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitet.

146. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

147. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Kualifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

147.1 Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin¹⁸⁰ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) *për*

¹⁸⁰ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, i AKSIK-së (ish-DSIK).

subjektin e rivlerësimit administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

147.2 Në raportin e AKSIK-së referohet se, nga autoritetet verifikuese informohet se: “...djali i subjektit rezultoi i regjistruar në SMIK Memex, referimi i dërguar në datën 28.2.2015, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal”.

148. Bazuar në informacionin e sipërcituar të përfituar nga institucionet e verifikimit, në vijim raportin e përpiluar, Grupi i Punës në AKSIK ka parashtruar se:

148.1 Personi i lidhur me subjektin, z. R.G.Ç (djali i subjektit të rivlerësimit), rezultoi të ketë materiale të referuara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”.

148.2 Në këndvështrimin e përgjithshëm të integritetit dhe pastërtisë së figurës së një punonjësi të sistemit të drejtësisë, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërmbyshje të rregullt të detyrës, dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jo materiale të padrejta për të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo personave të tjerë, cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë këtë individ të mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimit të shkronjës “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016¹⁸¹.

149. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Sh.Çopa .

150. Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së¹⁸² përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione reja të mundshme të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa. AKSIK-ja ka dërguar në Komision shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit, pas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës, për këtë subjekt. Nga verifikimi i tyre nuk rezultoi të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, në veprimtari të kundërligjshme.

150.1 Në këtë kontekst, AKSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, por se me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 7.7.2023, ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës¹⁸³.

151. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve/sinjalizimeve të agjencive ligjzbatuese.

152. Bazuar në informacionin e sipërcituar, Komisioni i kërkoi¹⁸⁴ nga Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të informojë mbi ecurinë e materialit kallëzues ndaj shtetasit R.Ç, si dhe të evidentojë specifikisht statusin e këtij shtetasi në këtë kallëzim/procedim penal. Në këtë kuadër, Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit

¹⁸¹ Në këtë raport, Grupi i Punës referon se janë në pritje të përgjigjes nga Prokuroria e Përgjithshme për ecurinë e materialit kallëzues të referuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për djalin e subjektit të rivlerësimit, z. R.Sh.Ç.

¹⁸² Shkresë e Komisionit nr. *** prot., datë 10.2.2023.

¹⁸³ Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet dhe argumentet e tij mbi përfundimet e raportit të kontrollit të figurës të mbajtur nga AKSIK-ja.

¹⁸⁴ Shkresë e Komisionit nr. *** prot., datë 13.7.2023.

Tiranë të konfirmojë nëse për shtetasin R.Ç ka pasur ndonjë tjetër procedim penal të mosfilluar, pushuar, pezulluar, transferuar apo të dërguar për gjykim.

152.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë informon se nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikat elektronike të procedimeve penale, për shtetasin R.Ç rezultoi të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. ***, viti 2015, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, për të cilin është marrë vendim për mosfillimin e hetimeve në datën 12.5.2015.

152.2 Nga verifikimi i akteve të kësaj dosjeje rezulton se, mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga policia gjyqësore e seksionit për narkotikët të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, në datën 8.4.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, referuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve, B. T., A. B., D. S., dhe R.Ç. Referuar materialit kallëzues, rezulton se, në datën 28.2.2015, rreth orës 01:45, nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë nr. ***, Tiranë, në vendin e quajtur “****”, në rrugën “****”, shtetasve B. T., A. B., D. S. dhe R. Ç u është gjetur një sasi lëndë e dyshuar si lëndë narkotike, e llojit *canabis sativa*, ku pas peshimit ka rezultuar 1.45 (një pikë dyzet e pesë) gram pa ambalazh. Pas shoqërimit të tyre në Komisarariat dhe marrjes së deklarimeve, të katër të dyshuarve u janë marrë mostrat e urinës dhe është vendosur kryerja e ekspertimit kimik për këto mostra. Referuar akteve toksikologjike ligjore, për të katër të ekzaminuarit është konstatuar se në mostrat e urinës janë gjetur të pranishme produkte të metabolizmit të kanabinoideve (*cannabis sativa*). Në këto kushte, duke u nisur nga sasia e vogël e lëndës narkotike (1.45 gram të gjithë bashkë), si edhe faktin se këta shtetas figurojnë të gjithë përdorues, është konkluduar se sasia e vogël që u është gjetur atyre është për përdorim vetjak dhe, për rrjedhojë, sipas përcaktimit të nenit 283/1 të Kodit Penal, ata përjashtohen nga përgjegjësia penale. Për këtë shkak, prokurori i çështjes I. J ka vlerësuar se procedimi penal nuk duhet të fillojë pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale (vendim mosfillimi datë 12.5.2015).

153. Referuar pikës 5 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: (a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; (b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet apo dënohet.

153.1 Në referim të dispozitës së sipërcituar, Komisioni vëren se vepra penale për të cilën është kallëzuar djali i subjektit, z. R.Ç, bën pjesë në veprat e parashikuara pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar. Por, nga verifikimi i dosjes penale Komisioni konstaton se nuk ka pasur procedim penal të filluar ndaj tij, pra djalit të subjektit nuk i është regjistruar emri si person nën hetim në regjistrat penalë përkatës, kusht i kërkuar nga ligji për t’u kategorizuar si “person i përfshirë në krimin e organizuar”. Në këtë kontekst, ai nuk mund të cilësohet si kontakt i papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit. Përpos faktit se dosja në vetvete tregon rrethana krejt të tjera në raport me veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, si dhe pa dashur t’i hyjmë analizës nëse raporti prind - fëmijë mund të përbëjë kontakt të papërshtatshëm, vetë fakti se ndaj shtetasit R.Ç nuk është regjistruar procedim penal, mjafton të hedhë poshtë këtë gjetje të bërë nga AKSIK-ja, mbi bazën e së cilës ka konstatuar papërshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

153.2 Si rezultat, Komisioni vlerëson se në këtë rast AKSIK-ja ka dalë në një konstatim të gabuar në cilësimin e djalit të subjektit, z. R.Ç, si kontakt të papërshtatshëm – në dukje pa disponuar dosjen e plotë penale e, për rrjedhojë, duke dalë në konkluzione negative në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës.

154. Në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuara nga institucionet e verifikimit, u administrua dokumentacion¹⁸⁵ për disa çështje penale, të hetuara/shqyrtuara nga ish-Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

154.1 Pas shqyrtimit dhe analizimit të këtyre dosjeve penale dhe akteve pjesë përbërëse të tyre, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë të dhëna/fakte dhe/apo dokumentacion për gjetje mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Gëzim Çopa, për aspekte që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës.

155. Komisioni ka kryer edhe verifikime të tjera në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, por se nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

156. Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të grumbulluara gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

157. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale¹⁸⁶

158. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë KLP-së, si organi ndihmës i vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor - me short; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore – ka përpiluar një raport me qëllim analizimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit z. Gëzim Çopa.

158.1 Referuar këtij raporti, duket se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Gjithashtu, nuk konstatohen *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

¹⁸⁵ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 1.12.2023 dhe shkresat kthim përgjigjeje të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës: (i) nr. *** prot., datë 1.12.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 5.1.20124); (ii) nr. *** prot., datë 16.1.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.1.2024).

¹⁸⁶ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 18.12.2018 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.1.2019).

158.2 Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, nga ku pas shqyrtimit të tyre nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional.

159. Në vlerësimin e prokurorit Gëzim Çopa u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe **4 denoncime të depozituara nga publiku**. Pas verifikimit dhe analizimit të tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit – Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe/apo të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbi veprimet e kryera prej tij në hetimin dhe shqyrtimin e çështjeve penale, që lidhen me 2 denoncime të depozituara nga publiku.

159.1 Më konkretisht, pas shqyrtimit të tyre dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni konstatoi se ngrihen pretendime, hidhen dyshime dhe/apo duket se evidentohen gjetje si më poshtë:

159.1.1 Në një rast duket se ka pasur mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore dhe/apo moskryerjen në kohë të tyre, madje duke mos u plotësuar as detyrat e lënë nga gjykata, rrethana të cilat kanë çuar edhe në zvarritje të procesit.

159.1.2 Në një rast tjetër rezultoi se prokurori Gëzim Çopa ka kërkuar pushimin e çështjes, penale megjithëse dukej se kishte mospërputhje në konkluzionet shkencore të ekspertëve. Gjithashtu, në këtë rast evidentohet se subjekti nuk ka verifikuar përmbushjen e kritereve ligjore të domosdoshme për kryerjen e ekspertimit autoteknik nga eksperti i caktuar, si dhe moskryerja e veprimeve të tjera hetimore në fazën e hetimeve paraprake.

160. Siç u referua edhe më sipër, në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuturara nga institucionet e verifikimit, **Komisioni administroi informacion dhe dokumentacion për disa çështje gjyqësore penale**, të referuara si të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

160.1 Pas verifikimit dhe analizimit të këtyre çështjeve penale dhe akteve pjesë përbërëse të tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar shpjegime dhe/apo të provojë me dokumentacion justifikues ligjor për konstatimet dhe gjetjet si më poshtë:

160.1.1 Në lidhje me çështjen penale për të cilën është regjistruar materiali kallëzues bazuar në kallëzimin e bërë nga shtetasi Xh. U., për “Shkatërrim prone”, duket se: (a) prokurori Gëzim Çopa ka vendosur mosfillimin e procedimit penal pas rreth 1 muaji nga regjistrimi i materialit kallëzues, në kundërshtim me parashikimet e bëra nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale; (b) ka dalë në konkluzione mbi pasojat e dëmit material – pa kërkuar kryerjen e një akti ekspertimi tekniko-inxhinierik, pra duke mos u bazuar në një mendim të specializuar nga ekspertët e fushës.

160.1.2 Në lidhje me çështjen për të cilën bazuar në kallëzimin e shtetasit Xh. U. është regjistruar procedimi penal për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, duket se: (a) prokurori Gëzim Çopa ka dalë në konkluzionin për pushimin e procedimit penal pa kryerjen e një akti ekspertimi – vlerësuar si i domosdoshëm nga Gjykata; (b) nuk i ka dhënë mundësi viktimës të shfaqë qëndrimin e tij në lidhje me pushimin e procedimit penal; (c) nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore; (ç) ka pasur zvarritje të procesit hetimor pa shkaqe të justifikuara.

160.1.3 Në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasin F. D., dënuar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, Komisioni konstatoi se në materialin “Konkluzione përfundimtare” (i përbërë pothuajse vetëm prej një faqeje), ndër të tjera, prokurori Gëzim Çopa ka parashtruar se në caktimin e masës së dënimit për të pandehurin duhet mbajtur parasysh mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, fakti se i pandehuri është i padënuar më parë, si dhe gjendja shëndetësore e tij. Por, nga verifikimi i dosjes nuk rezultoi të ketë materiale mbi të dhëna

shëndetësore për të pandehurin F. D. Në këtë kontekst, Komisioni i kërkoi subjektit të evidentojë rrethanat/faktet/provat, të cilat e çuan në kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burg për të pandehurin F. D., në përmbushje të kërkesave të nenit 59 të Kodit Penal.

160.1.4 Sa i përket çështjes penale me të pandehur shtetasin M. A. etj., që lidhet me ngjarjen e ndodhur në qytetin e Kavajës në korrik të vitit 2019 (procedimi penal nr. ***/2019), ku si pasojë e të shtënave/shkëmbimit të zjarrit gjeti vdekjen shtetasi R. H., si dhe janë plagosur (me dëmtime të lehta trupore) disa shtetas së tjerë, Komisioni i kërkoi subjektit: (a) të paraqesë në mënyrë të përmbledhur shpjegimet/argumentet e tij mbi arsyet/rrethanat/faktet/provat, të cilat e çuan në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për dy të pandehur dhe kërkesën për pushimin e hetimeve për dy nga personat nën hetim; (b) të konfirmojë nëse ka ushtruar ankim/apelime ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë e, nëse po, të depozitojë kopje të njësuar të kërkesës ankimore. Në këtë kontekst, të deklarojë nëse në përputhje me nenin 15/4 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 8, datë 4.12.2019, ka informuar drejtuesin e prokurorisë brenda 2 ditëve mbi vendimin e gjykatës dhe faktin nëse do të ushtronte apelime.

160.1.5 Në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasin M. D., akuzuar për veprën penale “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, parashikuar nga neni 197/1 i Kodit Penal, Komisioni i kërkoi subjektit të konfirmojë nëse ka ndonjë lidhje me këtë procedim penal për shkak të funksionit të tij si prokuror/apo tjetër që nga faza paraprake e hetimit e deri në gjykimin e çështjes e, në këtë kontekst, të deklarojë nëse është caktuar si prokuror për përfaqësimin e organit të akuzës në gjykimin e saj. Nëse po, të japë detaje mbi fazën aktuale në të cilën ndodhet gjykimi i kësaj çështjeje – nëse janë bërë kërkesa prej tij apo janë paraqitur konkluzionet përfundimtare.

161. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet/argumentet e tij, si dhe ka depozituar dokumentacion provues në mbështetje të tyre, për kërkesat e bëra dhe problematikat e ngritura nga Komisioni në trajtimin e denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shqyrtimin e disa çështjeve penale të administruara bazuar në informacionet/sinjalizimet e përfutuara nga institucionet e verifikimit.

162. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se përgjithësisht subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e evidentuara në trajtimin e denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shqyrtimi i çështjeve të tjera penale, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që, mund të të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale. Kështu, megjithëse duket se qëndrojnë gjetjet për mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore në dy raste të trajtuara (njëri nga denoncimet dhe tjetri nga dosjet e marra pas sinjalizimeve të institucionit të verifikimit), trupi gjykues çmon se kjo nuk është një qasje e vazhdueshme e subjektit, pra se këto dy raste nuk tregojnë në tërësi modelin e tij të punës dhe, si rrjedhim, nuk mund të ndikojnë në procesin e vlerësimit të kriterit profesional për prokurorin Gëzim Çopa.

Konkluzioni i Komisionit për kriterin e vlerësimit profesional

163. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, dosjeve penale të administruara bazuar në *indiciet*/informacionet e përfituara nga institucionet e verifikimit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze, apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

164. Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

165. Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, dosja e procedimit penal nr. ***/***, duhet të transferohet për inspektim pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD-së).

165.1 Kështu, nga verifikimi i materialeve të kësaj dosje penale¹⁸⁷ rezulton se, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në qytetin e Kavajës në datë 04.07.2019, ku si pasojë e të shtënave / shkëmbimit të zjarrit gjeti vdekjen shtetasi R.H, si edhe janë plagosur (me dëmtime të lehta trupore) disa shtetas së tjerë, po në datë 04.07.2019, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 04.07.2019, për veprën penale “Vrasje në rrethana cilësuese”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” dhe “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga nent 79/ë, 25, 22, 278/1 e 300, të Kodit Penal.

165.2 Rezulton se, bazuar në materialet paraprake të referuara nga policia e Kavajës për këtë ngjarje dhe veprimeve të kryera me iniciativë prej saj në kushtet e flagrancës, një ditë pas regjistrimit të procedimit penal, në datë 05.07.2019, prokurori Çopa ka vendosur të regjistroj në regjistrin e çështjeve penale në prokurori emrat e shtetasve M.A, A.D, Q.M, E.H dhe D.A, të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 79/ë, 22, 25 dhe 278/1, i Kodit Penal, si edhe të shtetasit A.K, i dyshuar për veprën penale të “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300, i Kodit Penal. Më datë 03.10.2019, prokurori Çopa ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimit.

165.3 Rezulton se pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, në datë 15.12.2019, prokurori Çopa ka urdhëruar ndryshimin e të dhënave në regjistrin e veprave penale, që në kolonën përkatëse të procedimit penal nr. ***/***, të bëhet ndryshimi për veprën penale për të cilën dyshohet personi nën hetim, sa vijon: (1) për personin nën hetim Q.M, tashmë vepra penale që dyshohet është “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1, i Kodit Penal; (2) për personin nën hetim A.D, tashmë vepra penale që dyshohet është “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1, i Kodit Penal; dhe (3) për personin nën hetim M.A, tashmë veprat penale që dyshohet janë “Vrasje nga pakujdesia” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 85 dhe 278/1, i Kodit Penal.

165.4 Në datë 26.12.2019, prokurori Çopa, ka vendosur marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për: (i) personin nën hetim M.A, për veprën penale të “Vrasje nga pakujdesia” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 85 dhe 278/1, i Kodit Penal; (ii) personat nën hetim Q.M dhe A.D, për veprën penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1, i Kodit Penal; dhe (iii) për personin nën hetim A. K, për veprën penale të “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300, i Kodit Penal.

165.5 Pas përfundimit të hetimeve lidhur me këtë procedim penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë (prokurori Çopa) ka përpiluar kërkesën për: (1) dërgimin në gjyq të çështjes, në ngarkim të shtetasve M.A, A.D, Q.M dhe A. K, të dyshuar për kryerjen e veprave penale të sipërcituara; dhe (2) pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasve D.A, E.H.

¹⁸⁷ Dosje e përcjellë nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me shkresën nr. **** prot., datë _12.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 05.01.2024).

165.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë në datë 28.01.2020, ka vendosur¹⁸⁸: (1) Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë; (2) Dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M.A, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasje nga pakujdesia” dhe “Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 85 dhe 278/1, i Kodit Penal; (3) Dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurëve A.D dhe Q.M, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1, i Kodit Penal; (4) Dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.K, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimi i krimi”, parashikuar nga neni 300, i Kodit Penal; (5) Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurëve D.A dhe E.H, si edhe shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg” ndaj tyre.

165.7 Konstatohet se, në përfundim të gjykimit të kësaj çështje prokurori Çopa ka kërkuar: (1) Deklarimin fajtor të të pandehurit M.A , i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit M.A , i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55, të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit M.A , me 7 vjet e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406, të K.Pr.Penale, uljen e këtij dënimi me 1/3 dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim; (2) Deklarimin fajtor të të pandehurit A.D , i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406, të K.Pr.Penale, uljen e këtij dënimi me 1/3 dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim; (3) Deklarimin fajtor të të pandehurit A.K , i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimi i krimi”, parashikuar nga neni 300, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 15 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406, të K.Pr.Penale, uljen e këtij dënimi me 1/3 dhe dënimin e tij me 10 muaj burgim.

165.8 Rezulton se, pas kërkesës së bërë nga avokati i të pandehurit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 05.03.2020, Gjykata ka vendosur ndarjen e çështjes, veçimin e materialeve, për të pandehurin Q.M ¹⁸⁹, nga të pandehurit e tjerë, duke vazhduar gjykimin për të pandehurit A.D , M.A dhe A.K , dhe dërgimin e akteve të sekretarisë së Gjykatës për hedhjen e shortit për të pandehurin Q.M, që ka kërkuar gjykim të zakonshëm. Të pandehurit e tjerë kanë kërkuar gjykim të shkurtuar.

165.9 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë në datë 30.03.2020, ka vendosur¹⁹⁰: (1) Deklarimin fajtor të të pandehurit M.A , për kryerjen e veprës penale të “Vrasje nga pakujdesia”, dhe në bazë të nenit 85, 48/ç, 49, të Kodit Penal, e dënon atë me 4 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit M.A , për kryerjen e veprës penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, dhe në bazë të nenit 278/1, 48/ç, 49, të Kodit Penal, e dënon atë me 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55, të Kodit Penal, në bashkimin e dënimeve në një të vetëm e dënon përfundimisht të pandehurin M.A , me 7 vjet e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406, të K.Pr.Penale, uljen e këtij dënimi me 1/3 dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në bazë të nenit 59, të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, për pjesën e mbetur të vuajtjes së dënimit, për të pandehurin M.A , për një afat 5 vjet kohë. Gjatë kësaj periudhe detyrohet që i dënuari: i) të mos kryej vepër tjetër penale; ii) të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë; iii) të mbajë lidhje të vazhdueshme me Z.Vendore të Shërbimit të Provës; iv) të njoftojë Organet e Shërbimit të Provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo largimin e tij jashtë shtetit. Shuarjen e masës së sigurimit për të pandehurin M.A ; (2) Deklarimin fajtor të të pandehurit A.D , për kryerjen e veprës penale

¹⁸⁸ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr. *** (***) , datë 28.01.2020.

¹⁸⁹ Duket se, prokurori Çopa e ka lënë në vlerësim të gjykatës nëse duhet ndarë çështja.

¹⁹⁰ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr. **** , datë 30.03.2020.

të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, dhe në bazë të nenit 278/1, 48/ç, 49, të Kodit Penal, e dënon atë me 3 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406, të K.Pr.Penale, uljen e këtij dënimi me 1/3 dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në bazë të nenit 59, të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, për pjesën e mbetur të vuajtjes së dënimit, për të pandehurin A.D , për një afat 4 vjet kohë. Gjatë kësaj periudhe detyrohet që i dënuari: i) të mos kryej vepër tjetër penale; ii) të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë; iii) të mbajë lidhje të vazhdueshme me Z.Vendore të Shërbimit të Provës; iv) të njoftojë Organet e Shërbimit të Provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo largimin e tij jashtë shtetit. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit A.D nga vuajtja e mëtejshme e dënimit, nëse ndaj tij nuk zbatohet masa e sigurimit personal “arrest me burg” ose ndonjë dënim tjetër penal me burgim për vepra të tjera penale. Shuarjen e masës së sigurimit për të pandehurin A.D ; (3) Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A.K , për veprën penale të “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, bazuar në nenin 388/b, pasi *“fakti nuk përbën vepër penale”*.

166. Për sa më sipër, për shkak të rrethanave të ngjarjes dhe rrezikshmërisë së lartë shoqërore që paraqesin veprat penale për të cilat është regjistruar ky procedim, trupi gjykues çmon se duhet bërë verifikim i detajuar mbi arsyet/rrethanat/faktet/provat të cilat çuan prokurorin Çopa në ndryshimin e cilësimit të veprës penale për dy të pandehur dhe kërkesën për pushimin e hetimeve për dy nga personat nën hetim. Për këto arsye, vendosi ta transferojë këtë çështje penale pranë organit kompetent (ILD-së) për inspektim, me qëllim verifikimin dhe evidentimin e shkaqeve të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e prokurorëve, ose evidentimin e shkaqeve të cilat mund të merren parasysh në vlerësimin periodik të prokurorit Gëzim Çopa.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej tij, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 dhe 4 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Transferimin e dosjes së procedimit penal me nr. ***, të vitit 2019, pranë organit kompetent (ILD-së) për inspektim.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim, përveç pikës 2, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 22.2.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese – në pakicë/kundër

Pamela QIRKO
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

